



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 12 DHE 13 KORRIK 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 12. I 13. JULA 2012. GODINE**

**KORRIK - JULI
2012**

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
6. Interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35 % për importimin e çimentos nga Shqipëria,
7. Shqyrtimi i raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011,
10. Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona br.04/L-079 o budžetu Republike Kosova za 2012. godinu,
5. Drugo razmatranje Nacrt Poslovnika Skupštine Republike Kosova,
6. Interpelacija ministarke Mimoza Kusari-Lila, na zahtev grupe poslanika potpisnika u vezi odluke MTI o uspostavljanju tarife od 35% za uvoz betona iz Albanije,
7. Razmatranje drugog izveštaja o planu delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije za 2012. godinu,
8. Razmatranje godišnjeg izveštaja o radu Regulativnog Autoriteta za Telekomunikaciju za 2011. godinu,
9. Razmatranje godišnjeg izveštaja i revidiranih pregleda Trusta za Penzijsku Stednju Kosova za 2011. godinu,
10. Parlamentarna rasprava u vezi upotrebe tri (3) strana telefonska koda na Kosovu, na zahtev poslanika potpisnika,
11. Prvo razmatranje Nacrt zakona o korišćenju, administriranje i održavanju zgradu u suvlasnistvu,
12. Razmatranje preporuke Komisije ad hoc za izbor kandidata za članove Odbora Nezavisne Komisije za Medije.

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Të pranishëm janë 70 deputetë.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës - Deklarime jashtë rendit të ditës, fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit kryetar!

Është hera e parë që po ma jep fjalën kaq shpejt. Po më vjen shumë mirë, e po çuditë edhe vetë, por besoj se është një trajtim i veçantë.

Megjithatë, besoj se edhe ju, duke pasur parasysh për çka po e marr fjalën, për atë edhe ma dhatë. Pra, unë po e marr fjalën që të kërkoj prej anëtarëve të Kuvendit të hiqet prej rendit të ditës - Shqyrtimi i dytë i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse e ka një problem teknik. Problemi teknik është se komisionet kryesore nuk e kanë marrë në kohën e duhur dhe nuk kanë pasur kohë ta trajtojnë Rregulloren, prandaj kërkoj që të shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse nuk i plotëson kushtet teknike për të hyrë në rend të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Menjëherë po shkojmë në votim formal.

Kush është për kërkesën? Faleminderit!

Kundër, a ka? 3 vota kundër.

Abstenim?Jo.

Atëherë, me shumicë të votave, hiqet nga rendi i ditës - Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për Kabinetin,

Kolegë të nderuar,

Kërkojmë që sot si pikë e rendit të ditës hyjë edhe Projektligji për pasurimin e miellit. Materiali u është shpërndarë deputetëve dhe me këtë ligj u mundësojmë të përfitojnë sidomos fëmijët në Kosovë, për shkak të pasurimit të miellit me acidin folik dhe hekur, që është i nevojshëm për shëndetin e tyre, prandaj kërkoj, pasi i ka plotësuar, kushtet që të hyjë në rend dite për nesër.

KRYETARI: Edhe për këtë kërkohet një votim formal. Kush është për Projektligjin për pasurimin e miellit? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Edhe ky projektligj hyn në rend të

ditës, nëse nuk e kryejmë, e lëmë për nesër. Dhe, fjalën e ka kërkuar deputetja Xhevahire Izmaaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu, edhe unë e kam një kërkesë për futjen në rend të ditës edhe të një pike. Si kryesuese e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit, kërkoj që mundësisht të hyjë në rend të ditës, për sot apo për nesër, zgjedhja dhe votimi i anëtarëve të Bordit, për ta plotësuar bordin, pasi e kemi një afat deri më 15 shtator, disa obligime të cilat i dimë të gjithë. E kam fjalën për Bordin e RTK-së dhe të hyjë si pikë shtesë e rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Alma Lama e ka kërkuar fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, e kisha rezervuar për të folur gjatë kohës kur pritet të shqyrtohet për anëtarët e KPM-së, por unë do ta ngre shqetësimin tim këtu.

Komisioni, i cili përbëhet nga 9 anëtarë, ka votuar për zgjedhjen e emrave të anëtarëve të Bordit të RTK-së dhe të KPM-së. Unë nuk e konsideroj që kjo është një gjë e drejtë për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të pavarura, siç do të duhej të ishin RTK-ja dhe KPM-ja.

Mendoj se emrat, të cilët i sillen seancës, është dashur të zgjidhen me konsensus, kështu që nuk mund të pretendojmë ne, në rast se votojmë që këta emra janë njerëz, të cilët nuk kanë lidhje me subjektet politike, përkatësisht me pozitën, kështu që unë e konsideroj krejtësisht të papranueshme mënyrën se si është votuar në këtë komision.

Nuk dua t'i paragjykoj emrat konkretë, nuk dua të hyj fare tek emrat konkretë, por mendoj se nuk është e drejtë, është dashur vetëm me konsensus t'i kalojnë emrat. Bëhet fjalë për institucionet e pavarura. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë fjalën e ka kërkuar kryetarja e Komisionit për Bordin e RTK-së, deputetja Xhevahire Izmaaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Si kryesuese e Komisionit ad hoc, unë ia jap informacionin deputetes Lama, që me konsensus të plotë është bërë lista për propozimet e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Domethënë flas me kompetencë. Këtu janë përfaqësuesit - anëtarë të të gjitha subjekteve politike, dhe edhe Lëvizja "Vetëvendosje" e ka pasur edhe përfaqësuesin, kështu që le ta marrë informacionin prej kolegut të vet. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë tutje. Kush është për kërkesën që të hyjë votimi për anëtarët e Bordit? Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? "Vetëvendosje" kundër.

Konsideroj se shumica janë të pajtimit për t'i futur në rend dite rekomandimet e Komisionit për votimin e anëtarëve për Bordin e Radio-Televizionit të Kosovës. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Unë, në emër të Komisionit, kërkoj që në rend dite të futet plotësim-ndryshimi i Ligjit për letërnjoftim, për arsye se të gjitha procedurat kanë kaluar edhe në komision është amendamentuar projektligji, prandaj me procedurë të shpejtë do të ishte mirë për shkak se edhe prodhimi i letërnjoftimeve biometrike duhet të bëhet në afatin sa më të shpejtë, në mënyrë që edhe Raportin e Progresit dhe angazhimet tjera për liberalizmin e vizave t'i kemi sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: A jeni që edhe kjo të jetë pikë shtesë të hyjë në rendin e ditës? Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Janë disa kundër. Pra, me shumicë votash, edhe kjo radhitet si pikë e rendit të ditës. Dhe, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet, në emër të grupeve parlamentare, zgjasin 5 minuta, në emër të deputetit, 3 minuta.

Nuk ka replika dhe mos nxitni replika! Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Petar Miletic.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Ministri,

Koleginice i kolege poslanici,

Na prethodnoj sednici sam govorio o neefikasnosti Kosovske policije, kada su u pitanju samo neka od najtežih krivičnih dela počinjenih na Kosovu i efikasnosti iste te policije kada je prekoračila primenu fizičke sile nad delom građana na Vidovdan ove godine.

Rekao sam tada, da je moguće na Kosovu pokušati ubistvo poslanika, a da niko za to ne odgovara. U noći između subote i nedelje, u selo Talinovac kod Uroševca, ubijen je bračni par Jevtić - Liljana i Milorad. Neko je ušao u njihov kuću i hladnokrvno ih ubio.

Iskren da budem, danas me je sramota da kao čovek i kao poslanik ponovo izražavam saučešće, osuđujem ovaj zločin, tražim od istražnih organa da se ovaj zločin rasvetli. Naravno da policija neće rešiti ni ovaj zločin, kao ni prethodne, kada su žrtve bili Srbi.

Ako se to ipak kojim slučajem i desi, ja ću se sa ovog mesta javno izvinuti policije zbog ove moje tvrdnje, i daj bože da do toga dođe.

Govorimo ovde iz sednice u sednicu i o integraciji severa u kosovsko društvo. Kako ćemo motivisati građane severno Kosova da se integrišu u društvo u kojem je moguće da vam se neko ušeta u kuću i hladnokrvno i monstruozno vas ubije. Da li i vi, kolege poslanici, želite da živite u takvom društvu?

Gospodine ministre Unutrašnjih Poslova, ne ostavljate nam mnogo prostora kao predstavnicima Srba u ovoj Skupštini za razumevanje ne otkrivanja nijednog zločina koji je počinjen nad Srbima na Kosovu.

Učinite nešto, ili nam priznajte da ne možete.

I pored gorčine koju osećam, izražavam najiskrenije saučešće porodici Jevtić.

KRYETARI: Në emër të Grupit të LDK-së, fjalën e ka kërkuar Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhden e presioneve dhe tentimeve që kjo Qeveri çdo gjë të fusë në mbikëqyrje edhe atje ku nuk duhet bërë këtë, tek institucionet e ndryshme të pavarura, mekanizmat e ndryshëm të pavarur, bën pjesë edhe ajo që ndodhi ditë më parë, dërgimi i dy letrave ose dy kërcënimeve, më mirë të them, të dy ministrave të Qeverisë së Kosovës, në adresë të Odës Ekonomike të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se këto dy letra të këtyre dy ministrave, që janë përgjegjës për zhvillimin ekonomik, zotit Beqaj dhe zonjës Kusari, përbën një presion të llojit të veçantë ndaj komunitetit të biznesit nga Qeveria.

Nëpërmjet këtyre letrave, këta dy ministra ankohen se Oda Ekonomike e Kosovës, nëpërmjet kryetarit të tyre, zotit Gërxxhaliu, po i kritikon politikat e tyre ekonomike. Domethënë, nuk po i aplaudon, s'po i përkrah, s'po çohet në këmbë e të tjera. Ku ka më shumë, thënë sinqerisht, mjerim për një Qeveri dhe ministra përgjegjës për zhvillimin ekonomik që nuk mund të mbrohen nga kritikrat e komunitetit të biznesit, të bëra nëpër tryeza dhe debate të ndryshme?

Në vend që këta dy ministra t'i argumentojnë me racionalitet, ose për racionalitetin e vendimeve të tyre politike, ata e kanë zgjedhur presionin institucional ndaj Odës Ekonomike të Kosovës, duke e kushtëzuar mbështetjen e tyre për projekte të ndryshme të Odës Ekonomike të Kosovës, e cila mbështetje edhe ashtu është tepër simbolike.

Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështet Odën Ekonomike të Kosovës në kritikrat e saj, se politikat e ndjekura nga Qeveria Thaçi për privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit janë të dëmshme për vendin dhe zhvillimin e sektorit energjetik.

LDK-ja vlerëson dhe e mbështet Odën Ekonomike të Kosovës se vendimi i Qeverisë Thaçi për vendosjen e çmimeve referente për çimento po i dëmton bizneset dhe qytetarët e vendit, sepse taksën prej 35% në fund po e paguajnë qytetarët.

LDK-ja vlerëson se kësaj Qeverie dhe këtyre dy ministrave u mungon vizioni dhe kompetenca për ta çuar përpara agjendën zhvillimore të vendit. Kjo agjendë nuk çohet përpara me plane të tipit Banjsko dhe e duke mbytur zërin kritik që vjen nga komuniteti i biznesit.

Zoti Beqaj dhe zonja Kusari i kanë shërbyer mirë Qeverisë Thaçi gjatë kohës sa ishin në krye të organizatës biznesore. Si rezultat i servilitetit, sigurisht të tyre, ndaj pushtetit, ata janë shpërblyer me poste.

Tash kur Oda Ekonomike po konsolidohet si institucion që i mbron interesat e biznesit dhe po angazhohet për ta çuar përpara agjendën zhvillimore të vendit, këta dy ministra kanë zhvilluar, ose kanë filluar të zhvillojnë një presion ndaj Odës Ekonomike. Ky presion bazohet në mentalitetin e punës së tyre, të tipit të servilizmit, sa ishin përfaqësues të komunitetit të biznesit.

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se bashkëpunimi Qeveri - biznes duhet të thellohet, bazuar në kritika konstruktive të dyanshme.

LDK-ja e respekton lart angazhimin e Odës Ekonomike të Kosovës në mbrojtje të interesit të biznesit dhe vlerëson se kjo formë e presionit është e papranueshme. Faleminderit shumë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Më lejoni që sot këtu të ngre çështjen e EULEX-it. Në kohën që gjithë vëmendja ishte përqendruar te mbyllja e Zyrës Civile Ndërkombëtare, e cila pa të drejtë u quajt përmbyllje e mbikëqyrjes së pavarësisë, ndodhi një kërkesë më pak e vërejtur, që këtë mbikëqyrje të pavarësisë e forcon edhe më shumë.

Kërkesa ishte kjo, që EULEX-i të bëhet kategori kushtetuese në Republikën e Kosovës. Siç po duket, deri tash Qeveria dhe kryeministri, jo vetëm që e kanë pranuar një gjë të tillë, por madje e kanë pritur atë krahëhapur.

Unë mendoj që ekzistojnë katër probleme të mëdha për këtë çështje, të cilat duhet të trajtohen me kujdes, jo vetëm nga Kuvendi, por nga e gjithë shoqëria, në përgjithësi.

Së pari, dihet shumë mirë që EULEX-i po zhvillon hetime për 60 zyrtarë, disa prej të cilëve janë përfaqësues të lartë të Qeverisë. Dhe, është vetë EULEX-i që po kërkon të hyjë në Kushtetutë, kurse, në anën tjetër, Qeveria u pajtua menjëherë.

Kjo do të thotë që ka hapësirë të dyshohen vendimet e Qeverisë, se janë marrë nën kushtet e mungesës së lirisë. Populli nuk mund të përfaqësohet dhe Kushtetuta e tij nuk mund të mbrohet nga një Qeveri e shantazhuar. Ky vendim nuk mund të jetë kredibil, sepse i hetuari po ia plotëson kërkesat hetuesit. Kjo marrëdhënie është e korruptuar, prandaj vendimi nuk mund të jetë as objektiv, as reprezentativ.

Së dyti, po futet në Kushtetutë një mekanizëm që nuk e njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës, sepse, siç e dimë të gjithë, EULEX-i është neutral ndaj statusit të Kosovës. Në këtë mënyrë, ne edhe Kushtetutën po e bëjmë neutrale ndaj shtetësisë dhe pavarësisë.

Ky do të ishte një gabim trashanik nëse ndodh. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk duhet zërë vend asgjë që nuk e pranon shtetësinë e Republikës së Kosovës. Dhe, së fundi, po futet arbitrarisht në Kushtetutë një organizëm i cili nuk zgjidhet nga qytetarët e Kosovës, por as nga institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe një mekanizëm, i cili nuk do t'u japë llogari për punën e vet institucioneve të Republikës së Kosovës. Pra, një mekanizëm, të cilit do të duhej t'i përgjigjemi, por i cili nuk do të na përgjigjet neve.

Ky mekanizëm do të përbëhet nga disa njerëz, të cilët do të kenë legjitimitet kushtetues, në njërën anë, kurse në anën tjetër do të kenë imunitet nga ligjet që janë nën po këtë Kushtetutë. Kjo është në kundërshtim me demokracinë dhe unë çuditë se si një ide e tillë aspak demokratike vjen nga një mision i Bashkimit Evropian, në të cilin ndodhen vendet me demokracitë ndër më të zhvilluarat në botë.

Së fundi, është po ashtu me rëndësi të ceket se deri sot, nëse e ke kundërshtuar UNMIK-un, ke qenë demokratik, për shkak të mënyrës se si ka funksionuar ai, njerëzit të cilët na kanë qeverisur, por nuk kanë qenë të zgjedhur prej neve.

Por, nesër, nëse do ta kundërshtosh UNMIK-un, do të jesh antikushtetues. Ky do të ishte një kodifikim i antidemokracisë në Kosovë dhe shpresoj që EULEX-i të mos hyjë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ju ftoj, po ashtu juve si deputetë të Kuvendit të Kosovës, që të dilni në mbrojtje të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Meqë jemi në prag të pushimeve verore, dëshiroj ta ritheksoj problemin që u shtrua këtu për gjendjen e deponive në regjionin e Gjilanit dhe në Ferizaj, i cili ka qenë po ashtu edhe në Prizren, po atje është zgjidhur.

Ky problem po ndodh ka tri javë, domethënë tash jemi futur në javën e katërt dhe gjithmonë është frika që ne do të kemi pasoja nga ky problem për shkak se jemi në kushte të motit të nxehtë, është frika e përhapjes së një epidemie, e cila mund të shkaktojë edhe njëllor pasoje tjetër.

Shpeshherë ndodh që edhe vendimet më të mira, kur merren në kohë të keqe, lënë pasoja, të cilat pastaj duhet angazhim shtesë për t'i zgjidhur.

Siç jeni në dijeni, ka probleme të mëdha atje, kanë filluar të ngordhin edhe delet, është ndotur toka, është ndotur uji, kanë filluar të thahen edhe drunjtë dhe kështu ky problem ende nuk po gjen zgjidhje.

Dëshiroj t'i lus institucionet përkatëse që të merren me këtë problem dhe ta zgjidhin, për shkak se kemi të bëjmë me një problem vërtet të madh, i cili po lë pasoja andej. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar, në emër të Grupit, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Pas një maratone njëvjeçare, u bë zgjedhja e drejtorëve të Qendrës Klinike Universitare dhe shefave të reparteve. Hapja e konkursit, anulimi, miratimi i statutit të QKUK-së, prapë kthimi në plotësim-ndryshim për shkak të kundërshtimit me disa nene kontroverse dhe, në fund, miratimi u prit mirë nga të gjithë, duke menduar se më në fund po bëhen disa reforma pozitive në sektorin shëndetësor.

Mirëpo, pas analizës së bërë të konkursit të fundit, del se ky sektor prapë ka vazhduar me thyerjen e rregullave ligjore dhe vetë statutit të QKUK-së.

Konkursi është shpallur në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit civilë, përkatësisht me Ligjin e punës, nenet 5, 7, 8 të Ligjit numër 03/L-2012 të punës, nenit 3 pika 1 të Udhëzimit Administrativ numër 14/2011 dhe nenet 12, 22, 23 dhe 24 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Konkursi ka përfunduar më 29 maj, testi me shkrim mbahet gati një muaj me vonesë, kurse paneli gojor fillon më 2 korrik, e rezultatet e panelit shpallen më 9 korrik, vonesë më shumë se 10 ditë. Në shumë raste është shkelur Statuti i Qendrës Klinike Universitare, në nenin 23 pika 1, ku në vend të profesorëve janë përzgjedhur njerëz që nuk kanë tituj akademikë.

E kam këtu nenin 23 të Statutit, ku për zgjedhjen e pozitave udhëheqëse thuhet: "Drejtorët e klinikave, instituteve, shërbimeve të përbashkëta klinike dhe shefat e njësive të tjera organizative, shëndetësore të Qendrës Klinike Universitare, zgjidhen nga radhët e specialistëve të lëmenjve përkatës me thirrje akademike të profesorit, ose në raste të caktuara me thirrje shkencore". Ndërsa këtu, në Klinikën e Neurologjisë, është zgjedhur asistent Fahredin Veselaj, në Klinikën e Nefrologjisë, Ibrahim Rudhani, nuk është staf akademik. Në Klinikën e Kardiologjisë me Angiologji, profesor Bedri Zaiti, i graduar para 6 muajve, ndërsa janë refuzuar Gani Bajraktari, profesor, dhe Ejup Pllana, profesor. Në Klinikën e Endokronologjisë nuk ka thirrje shkencore, asistente Dritë Mekuli, në Klinikën e ORL-së Hajdin Thaçi, e ka pasur kundërkandidat profesorin Qazim Hyseni. Në Klinikën e Sëmundjeve Dermatovenerologjike, magjistër Fatime Kolukllari, është refuzuar profesor Mubera Ferizi. Në Klinikën e Pediatrisë, Muharrem Avdiu, është refuzuar profesor Mehmedali Azemi. Në Klinikën e Pulmologjisë, Gazmend Zhuri, është refuzuar profesor Behxhet Osmani. Në Klinikën e Radiologjisë zgjidhet asistent Arben Kutllavci, refuzohen profesor Halit Ymeri dhe profesor Serbeze Kabashi-Muçaj. Në Institutin e Onkologjisë zgjidhet profesor Behxhet Osmani, pulmolog, ndërsa refuzohet profesori i lëndës në Onkologji, doktor Xhavit Bicaj.

Gjatë intervistimit, në dy ditët e para ka munguar një anëtar i komisionit - përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë. Përfaqësuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil nuk ka qenë i pranishëm gjatë intervistimit, gjë që është shkelje e Ligjit për shërbyesit civilë. Të gjitha këto shkelje e bëjnë këtë konkurs jolegjitim.

Meqenëse ministri është i pranishëm, le të merret seriozisht me këtë çështje, le ta konsultojë ligjin dhe statutin që vet e ka aprovuar dhe le të veprojë sipas ligjit dhe akteve të tjera në fuqi.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të kthehesh prapa për t'i rishqyrtuar veprimet tuaja me qëllim të përmirësimit të tyre në të ardhmen, apo me qëllim të nxjerrjes së mësimave për veprimet e ngjashme në të ardhmen. Është edhe njerëzore, edhe cilësore, edhe e virtytshme, mirëpo të kthehesh prapa për ta prishur një punë të mirë që me shumë sakrifica është bërë, duke u thirrur në fakte të paqena, në vlerësime subjektive dhe kuturu, jo vetëm që nuk është njerëzore, as profesionale, as edhe afirmative, por është edhe egoizëm dhe shkurtpamësi intelektuale dhe politike.

Të gjithë jemi dëshmitarë të përpjekjeve që kanë qenë të domosdoshme për miratimin e pushimit të lehonisë në trajtën në të cilën është sot në fuqi. Deri sa në botën e civilizuar dhe vendet e komuniteteve evropiane, ku synojmë të gjejmë vend të drejtat e grave, avancohen në çdo aspekt dhe përditë duke e njohur dhe avancuar kështu rolin e gruas në shoqëri, ne me rekomandimin e ministres sonë duam ta forcojmë ekonominë dhe t'i reduktojmë humbjet e saj, duke e shkurtuar pushimin e lehonisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e ekonomisë sonë dhe analistët qeveritarë të ekonomisë, të zhveshur nga çdo sens për kohën dhe hapësirën dhe trendët bashkëkohorë dhe pa kurrfarë kreativiteti, nuk është për të dyshuar se rimëkëmbja e ekonomisë sonë varet pikërisht nga kohëzgjatja e pushimit të lehonisë.

Në anën tjetër, as ekspertët dhe avokuesit e barazisë gjinore nuk do të gjejmë vend për të dyshuar në motivin e ministres sonë të nderuar, meqë pikërisht ajo vetë nuk e kishte shfrytëzuar pushimin e saj të lehonisë fare. Përkundrazi, kishte pasur komoditetin për t'u bartur me vetura zyrtare dhe për të ushqyer në gji fëmijën e saj kurdo dhe kudo.

A thua, sa prej nënave të punësuarra kanë vetëm 10% të komoditetit të ministres sonë për të zbatuar të ushqyerit në gji të foshnjave të tyre derisa janë të punësuarra? A thua ka ndonjë analizë të besueshme të shkallës së zbatimit të Ligjit të punës në këtë aspekt, qoftë në sektorin publik, apo atë privat? Në çfarë parametrash apo indikatorësh ekonomikë mund të mbështetet qëndrimi se zgjatja e pushimit të lehonisë na paska shkaktuar ngecje në shtimin e ekonomisë së vendit?

Krejt në fund, a thua kjo periudhë e shkurtër e zbatimit, nëse ka ndopak zbatim të këtyre neneve të Ligjit të punës, mjafton për ta sjellë një konstatim kaq vulgar dhe të prerë? Jo. Si grua, si mjeke, si nënë dhe si njeri jam e bindur se nuk qëndron në asnjë shtyllë të shëndoshë një konstatim i tillë. Kjo, në fakt, është më tepër një frustrim i radhës, apo një ëndërr e keqe e ministres sonë të nderuar, pas asaj me çimenton, apo thënë më butë, një dëshmi e ndarjes së saj nga hallet e popullit dhe shikimi nga lartësia.

Por, dua t'ia rikujtoj ministres sonë se derisa nënat e lodhura nga amësia e pasigurt dhe me shërbime shëndetësore nën nivelin e duhur, që përpiqen vetë ta shkurtojnë pushimin e lehonisë, në mënyrë që ta fitojnë bukën për familjen, ajo mund ta shohë nga lartësia se ku është milingona...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Pre svega, želim da u ime Poslaničke Grupe Samostalne Liberalne Stranke izjavim najdublje saučešće porodici Jevtić, iz Talinovca, kojima su u petak u veče u porodičnoj kući ubijeno dva člana.

Prijatelji iz međunarodne zajednice,

Poštovani premijeru i članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Nasilje i zločini nad Srbima nikako da prestanu. Poslanici Samostalne Liberalne Stranke se pitaju kada će prestati zločin nad Srbima, šta još treba da se desi, na koji način da reagujemo, kome da se obratimo da bi nadležni organi uradili sve kako bi zločin nad Srbima prestao i da se ubice izvedu pred lice pravde?

Mnoga deklarisanja van dnevnog reda ove Skupštine su započeta sa osudom nasilja nad Srbima, građanima ovog društva, nažalost sva akcija i reakcija nadležnih se tu i završavala.

Da li želimo da se ova tema uvrsti u redovnu tačku ove Skupštine, ili je konačno došlo vreme da se sa ovog mesta koja ima najveću odgovornost, pokrenu inicijative za rešavanje svakog slučaja bez serviranja uobičajenih fraza?

Poslanici Samostalne Liberalne Stranke najoštrije osuđuju ovaj i ostale zločine nad Srbima, i zahtevaju od međunarodne zajednice i nadležnih organa da učine sve kako bi počinio ovih zločina bili uhvaćeni i adekvatno kažnjeni.

I na kraju, hteo bih sve vas da pitam: Zašto? Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Nga data 2 maj e deri me datën 10 qershor të vitit 1999 kam qenë i burgosur në Burgun e Lipjanit.

Në fakt, në Burgun e Lipjanit, më parë se i burgosur isha rob e peng lufte, kurse vetë Burgu i Lipjanit ishte më shumë kamp përqendrimi sesa burg.

Ishim 13 shqiptarë të burgosur në një dhomë burgu, ku nuk kishim as tualet, e as ujë. Në hapësirën 4 e 15 me 2 e 60, në katin e dytë të Pavijonit IV, kemi qëndruar 13 veta për 39 ditë.

Në vend të tualetit e kemi pasur një kovë plastike, ku të burgosurit kanë vjellë pas rrahjeve e torturave të përditshme. Ushqimin na e kanë sjellë një ose dy herë në ditë, për 13 veta dy bukë, dhe për dy veta 2 centimetra supë, në fundin e një gote të plastikës. E, megjithatë, as këtë ushqim nuk arrinim ta hanim për shkak të maltretimeve.

Secili nga ne i pati humbur nga 20 deri në 30 kilogramë gjatë atij muaji. Më së shumti na pihej uji, jo pse bënte vapë, por për shkak të gjakderdhjes nga të rënat.

Një mbrëmje, dy gardianë erdhën dhe e thirrën emrin tim. Dola duke e ditur që duan të më rrahin. Por, u gëzova kur më thanë që t'i marr dy bidonët nga dhoma. Pra, nuk do të më rrihnin dhe bidonët do t'i mbushja me ujë dhe do t'i sillja në dhomë, ku 12 të burgosur ishin tharë pa të. Mirëpo, jo, porsa e mbusha ujin, filluan të më rrihnin për orë të tëra. Uji në bidonë u shërbente atyre që të ma kthenin në fytyrë, atëherë kur e humbja vetëdijen.

Disa prej këtyre gardianëve ua mbaj mend edhe emrat: Dragisha Ristiq, Mile Iviq dhe Jugoslav Simiq, në Lipjan e Prishtinë, kurse më vonë, njësoj të tmerrshëm posi këta ishin Dragan Milanoviq, Dragan Shabiq, Kosigin Joliq dhe Igori që e quanin Gara, në "Zabela" të Pozharevcit.

Në Burgun e Lipjanit ishte edhe një gardian që të gjithë neve, e posaçërisht mua, më ka rrahur e torturuar. E mbaj mend mirë kur na thoshte: "Cili prej jush do të vdesë sot, meqenëse numri 13 është fatkeq, sa ishte edhe numri i të burgosurve në dhomën ku ishim. Ti Kurti, këshilltar i Demaçit, apo ti Selim Loku, ushtari i UÇK-së nga Hani i Elezit?" Emri i këtij gardiani është Zoran Koliq. Ai sot është në burg në Kosovë për krime lufte. Këtë e mësova nga letra që na ka ardhur në kuti secilit prej neve deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nga gruaja e tij që kërkon të lirohet Zoran Koliqi. Kushedi, ndoshta gruaja e Koliqit nuk e njeh mirë të kaluarën e burrit të vet. Kjo letër, që e keni secili prej jush, është arsyeja pse po flas sot këtu.

Janë bërë edhe protesta për lirimin e Zoran Koliqit. Është e çuditshme qysh asnjë fotografi e Zoran Koliqit nuk shihet në ato protesta, asisoj numri i të burgosurve shqiptarë që do ta njihnin atë do të ishte shumë i madh.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Privatizimi i ndërmarrjeve nga Gjakova është proces i jashtëligjshëm i AKP-së, që po e vazhdon avazin e ish AKM-së.

Këto ndërmarrje janë transformuar në vitet e '90-ta dhe deri te privatizimi në kuptimin e plotë të fjalës - patën mbetur vetëm disa procedura përfundimtare, që praktikisht një proces privatizimi tjetër është veç një tendencë për përvetësim të jashtëligjshëm të pasurisë së qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

Rasti i ndërmarrjeve të Gjakovës njihet si i veçantë edhe në legjislacionin e privatizimit tash e sa vjet, është edhe në Gjykatën Kushtetuese, por të njëjtës ende nuk i është kthyer përgjigje.

Aktualisht janë 49 ndërmarrje gjakovare, të cilat me ligjet të privatizimit, të ish-sistemit të kaluar, që janë ende të aplikueshme, kanë hyrë në procesin e transformimit dhe të drejtën e tyre janë duke e mbrojtur nëpër gjykata, për çka veç kanë angazhuar avokatë ndërkombëtarë.

Procesi i privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, pos që është i jashtëligjshëm, pasi ato janë të transformuara, dhe ndalohet me ligje të aplikueshme, është i jashtëligjshëm edhe me vetë legjislacionin mbi të cilin është krijuar ish-AKM-ja dhe tash AKP-ja. Kjo e fundit po i privatizon këto ndërmarrje, edhe pse ato janë në kontest gjyqësor, gjë që ua ndalon edhe legjislacioni mbi të cilin ajo vepron, duke mos i përfillur ligjet e aplikueshme. Si mund të shpjegohet fakti që kuadri i këtyre ndërmarrjeve, i përgatitur profesionalisht me vite dhe dekada me radhë, është hedhur padrejtësisht dhe brend rrugëve plot 13 vjet? Si do të kompensohet kjo, sa do t'i kushtojë kjo shoqërisë sonë?

Tregjet e krijuara me mund e sakrificë gjithandej Evropës, sot e kësaj dite, për të mos thënë përgjithmonë, kanë humbur. A duhet që dikush të përgjigjet për të gjitha këto fakte, ku janë institucionet e vendit, ku është Qeveria dhe çka është prioritet për të nëse nuk është rimëkëmbja e ekonomisë së vendit? Sa lirë po e shesin çdo ditë pasurinë e vendit tonë.

Për fat të keq, të gjitha privatizimet e pastudiuara mirë po na kushtojnë tepër shtrenjtë, tmerrësisht shtrenjtë.

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, i fundit për sot, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit kryetar për fjalën!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Sot dëshiroj shkurtimisht ta rishtroj një çështje, të cilën edhe vitin e kaluar e kam shtruar në të njëjtën kohë. Është fjala për disa prej preokupimeve që i kanë bashkatdhetarët tanë që kthehen në vendlindje në kohën e pushimeve. Këto ditë është sezoni, ose fillon sezoni i kthimit të tyre. Është e vërtetë se secilën herë dhe secilin vit më shumë po përmirësohen rrethanat dhe kushtet për t'i pritur ata, qoftë me rrugët, qoftë me infrastrukturën dhe, megjithatë, ka disa çështje të cilat ende janë pengesë. Fjalën e kam konkretisht për taksën kufitare të sigurimit, për të cilën, vitin e kaluar është thënë që është pengesë për t'u anëtarësuar shoqatat tona në këtë organizatë ndërkombëtare, janë çështje muajsh dhe është thënë që në Vitin e Ri, ose brenda vitit që shkoj, kjo do të realizohet, por ende nuk është realizuar.

Dhe, zoti kryetar i Kuvendit, dëshiroj të kërkoj që disa çështje që përsëriten në këtë pikë të rendit të ditës është mirë të trajtohen nga Kryesia, e në këtë rast është mirë që Banka Qendrore e Kosovës të thirret nga ju, të merren informata konkrete se çka është duke u bërë dhe rrjedhimisht kërkoj edhe nga Qeveria që të ndikojë të ulët kjo taksë.

Unë kam thënë edhe atëherë, nga informatat që i kam marrë, janë vetëm 10% e buxhetit që mblihet nga këto taksa dhe shpenzohen për dedikimin për ato që mund të quhen aksidente nga qarkullimi i bashkatdhetarëve që vijnë këtu, ndërsa pjesa tjetër nuk shfrytëzohet fare. Pra, është koha që të ulët në minimum kjo taksë, në mënyrë që bashkatdhetarët tanë ta kenë më lehtë qarkullimin.

Po ashtu, kërkoj që edhe në shërbimet tjera, meqenëse ata janë në numër të madh dhe meqenëse ata shpenzojnë shumë në Kosovë, t'u bëhen lehtësira, ashtu siç ka qenë edhe viteve tjera, të shtohen edhe më shumë masat e sigurisë në rrugë, po ashtu edhe shërbimet më të lehta, më të shpejta për të gjitha shërbimet që ata i kërkojnë në kohën sa qëndrojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetët e harxhuan kohën e tyre për deklarime jashtë rendit të ditës. Tani është radha e Qeverisë. Fjalën e ka zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Jo për replikë, por për sqarim për zotin Konjufca lidhur me raportet që kanë të bëjnë me EULEX-in për vazhdimin e mandatit të tyre.

Dua të them se që nga tetori i vitit të kaluar e kemi dërguar një projekt të transformimit apo transferimit të kompetencave nga EULEX-i te institucionet vendore. Atë projekt tanimë e kemi prezantuar në Bruksel bashkërisht edhe me disa deputetë të Kuvendit, përfshirë zotin Haziri, Gashi, Isufi e të tjerë. Deputetëve të Kuvendit të Kosovës të Komisionit për Integritet Evropian ua kam shpërndarë nga

një kopje të atij drafti dhe dua të them se Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ka pranuar që vazhdimi i mandatit të EULEX-it të hyjë në Kushtetutë.

Po e përsëris, asnjëherë nuk ka pranuar. Ka pasur kërkesa të tilla nga përfaqësuesit e EULEX-it në Bruksel dhe ne kemi negociuar me ata dhe kemi ardhur në përfundim për shkëmbimin e letrave ndërmjet presidentes së Republikës dhe zonjës Eshton dhe pastaj ajo letër duhet të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës me 2/3-at, çka do të thotë se nuk do të jetë kategori kushtetuese në Kosovë dhe përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës për ne nënkupton ndryshimin e bazës juridike të të gjitha misionëve ndërkombëtare që funksionojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konjufca e ka fjalën, për replikë,

GLAUK KONJUFCA: Zoti Kuçi,

Kjo nuk më duket përmbyllje e mbikëqyrjes së pavarësisë, sepse së pari po mbetet plani i Ahtisarit, që është projekt, domethënë për të cilin nuk është dhënë mendimi dhe vullneti i popullit të Kosovës nëpërmjet referendumit, por është projekt i imponuar dhe sa i përket mbylljes së Zyrës Civile Ndërkombëtare, tash kompetencat do t'i barten kryeministrit. Dhe, kjo nuk do të thotë se kemi institucione të pavarura, por do të kemi politikanë të dëgjueshëm, të cilët do ta zëvendësojnë Piter Fejtin. Pra, nuk ka nevojë që Piter Fejt më të qëndrojë në Kosovë, për sa kohë kemi politikanë, të cilët me përpikëri dhe pa kurrfarë kundërshtimi do ta implementojnë këtë projekt ndërkombëtar dhe të huaj, për të cilin nuk kemi vendosur ne, e që është plani i Ahtisarit.

Në anën tjetër, EULEX-it po i shtyhet mandati deri në vitin 2014. Këto të gjitha tregojnë që nuk kemi të bëjmë me përmbyllje të mbikëqyrjes së pavarësisë, por me forcim të kontrollit të mbikëqyrjes së pavarësisë.

KRYETARI: Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Konjufca,

Në kuptimin strategjik të zhvillimeve, do të thosha si shtet, nuk ka pika dalluese ndërmjet neve shumë, në kuptimin e obligimeve ndërkombëtare që i kemi marrë, besoj se e këtu kemi një seriozitet ne si Qeveri, por edhe si deputetë që e kemi votuar planin e Ahtisarit dhe tani këto obligime ndërkombëtare duhet t'i kryejmë.

Sa i përket asaj të kompetencave se kush do t'i bartë, ju e dini që është propozuar draftligji këtu për ndryshimin e projektligjeve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e pavarësisë. Mbetet në dorën e Kuvendit si do ta votojë, ta amendamentojë, për çka ju ftoj edhe ju dhe unë ju them të bëhet zgjidhja më e mirë funksionale për institucionet.

Kryeministri aty e ka funksionin, por nuk e ka emrin. Do të thotë, nuk ka të bëjë këtu me një emër të përveçëm, por ka të bëjë me një funksion që dikush e kryen në një moment të caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sabri Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,

Urime për punën që je kthyer pas pushimit!

Unë dola t'i flas dy fjalë lidhur me çështjen që e shqyrtuat në një bashkëkomunikim me zotin Konjufcën, sepse është temë që unë e kam shtruar herën tjetër, në një mbledhje kur është shtruar problemi i mbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur dhe, ju e dini, atje shënon që unë kam thënë në këtë foltore: Mirë është të hiqet pavarësia e mbikëqyrur, por përderisa dy funksionet vitale të një shteti i mban, sigurinë, KFOR-i dhe drejtësinë, EULEX-i, kjo nuk shkon, nuk ndodh.

Tash, meqë jemi te EULEX-i, se kjo edhe është tema, unë e dëgjova me vëmendje të madhe arsyetimin e zëvendëskryeministrit, i cili tha se ekziston një ekip që ka biseduar edhe me të zgjedhurit e Kuvendit, që nuk duhet të hyjë në Kushtetutë, e kjo është mirë, dhe s' duhet të hyjë dhe unë i përgëzoj, nëse kanë mbërri këtu.

Po ajo pjesa tjetër ende është e paqartë dhe duhet, zoti zëvendëskryeministër, shumë më qartë të thuhet në Kuvend, se ajo që e thatë ju me formulën, do të ndërrojnë letra Eshtoni me kryetaren e Kosovës, nuk mjafton. Sepse, ju e dini, siç e di edhe unë, që një mision i tillë, qysh ka ardhur herën e parë, mund të vijë herën e dytë. Dhe, ai nuk mund të vijë në Kosovë pa pasur thirrje, ftesë, që ju nuk e thatë në këtë formë, por ju thatë se me 2/3-at e Kuvendit do të votohet.

Pra, po them edhe një herë, një qëndrim i një misioni si EULEX-i, me ato detyra dhe detyrime kaq të mëdha që do t'i ketë në Kosovë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, zoti Kuçi!

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, profesor Hamiti!

Unë e kam vërejtur edhe në seancën e 22 qershorit, që ju e keni theksuar një veprim të një çështjeje të tillë, e keni shtruar në ditën që i kemi prezantuar projektliggjiet për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur dhe dua të them se ka qenë dhe mbetet një prej shqetësimeve të përbashkëta dhe natyrisht se kjo është një prej pjesëve që ne kemi negociuar deri më tani. Unë dua të them se i kemi vënë tri baza juridike. Baza e parë është Deklarata e 17 Shkurtit e vitit 2008; baza e dytë është vendimi i 8 shkurtit i vitit 2008, i Këshillit të Ministrave të BE-së, dhe baza e tretë do të jetë ftesa që bëhet nga Presidentja e Republikës së Kosovës për një mision. Dhe, do të jetë në formë të ftesës, me kompetenca të përcaktuara të qarta - cili do të jetë mandati dhe duke iu ofruar sikur misioneve diplomatike të drejta për privilegje dhe imunitete, sipas Konventës së Vjenës?

Unë e kam një draft-kopje, po e them që jemi duke e shkëmbyer, por në ndërkohë unë jam shumë i gatshëm, qoftë ndonjë komisioni të veçantë, qoftë Kryesisë së Kuvendit,

apo në një debat në Kuvend, që t'i detajojmë të gjitha çështjet e parapara. Por, insistimi ynë ka qenë që një veprim i tillë, të mos vazhdohet mandati pa e pasur pëlqimin e Kuvendit, dhe atë me 2/3-at. Dhe, unë mendoj se kjo është punë serioze, që ka të bëjë me sovranitetin e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për deklaramë, e ka fjalën ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Dua të ritheksoj edhe një herë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, e kjo po argumentohet për çdo ditë, me fakte, të cilat po i ndien qytetari i Republikës së Kosovës.

U shtrua çështja e një letre dhe letra në kushte normale duhet të ketë përgjigje profesionale dhe me shkrim, e të mos shërbejë si ushqim për debate politike, të cilat, në kushte normale, nëse ka çfarëdo lloj tendence, siç po e quani ju për disiplinim, duhet të kundërshtohet fuqishëm. Por, letra është e adresuar dhe letrat i janë adresuar Këshillit Drejtues të Odës Ekonomike, i cili duhet t'i analizojë në mënyrë profesionale dhe nëse ka çfarëdo argumenti, i cili nuk është i saktë, atëherë ata duhet të vijnë dhe të mos trajtohet kjo çështje në nivele politike, sepse nëse flasim për tendencë për instrumentalizim, po shihet qartë se në këto momente ka tendencë për ta instrumentalizuar dikush në aspektin politik.

Pra, atëherë dhe aty ku mungojnë argumentet dhe profesionalizmi, gjithmonë tentohet të gjendet zgjidhje politike.

Unë po ju them se në bazë të deklarimeve kuturu, të cilat janë bërë nëpër media për sabotimin e institucioneve të biznesit, në këtë rast të Odës Ekonomike nga Qeveria, ne vetëm i jemi drejtuar Këshillit Drejtues me argumente se çka ka bërë Qeveria deri më tani dhe që është kundër-argument i sabotimit, sepse është thënë që nuk po marrin pjesë, që nuk po përkrahemi. Dhe, po ju them edhe një herë, se Qeveria e Kosovës, për ta ndërtuar një dialog të mirëfilltë e ka formuar një këshill nacional për zhvillim ekonomik, ku janë ftuar të gjitha asociacionet e biznesit, por asociacioni në fjalë, e posaçërisht kryetari i saj nuk merr pjesë në asnjë takim, i cili është takimi më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në nivel shteti, sepse, po them, duhet të kemi qasje profesionale.

Prandaj, po e them edhe një herë, letrat janë për t'u përgjigjur me shkrim dhe kur ka argumente, ato mund dhe duhet të paraqiten, e kur mungojnë argumentet çështja tenton të bëhet politike për ta mbuluar joprofesionalizmin dhe tendencën për instrumentalizim të institucioneve. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën. Replikë, apo pyetje?

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Ministri edhe një herë veç sa e konfirmoi atë që ne besojmë fuqishëm, që po ndërhyr në punën e një institucioni, që ne e llogaritim të pavarur dhe ashtu do të duhej të ishte.

Së pari, po ju pyes, zoti ministër, a e keni zgjedhur ju kryetarin e Odës Ekonomike dhe a duhet të ju japë llogari juve, apo Këshillit të Odës Ekonomike?

Nëse duhet atyre, ata mund ta ngrenë këtë problem, e jo ju të kërkonit tash llogari tash prej Këshillit se çfarë po bën kryetari. Domethënë, i keni ngatërruar gjërat, në këtë mënyrë duhet njoftuar Këshillin. Kryetarin e Odës Ekonomike nuk e kemi zgjedhur ne, asnjë subjekt politik, e besoj kësioj, sikur që ju keni qenë paraprakisht.

Dhe, tash, sigurisht për punën e mirë që e paskeni bërë, keni marrë post. Sa keni qenë i ndikuar politikisht, ajo është çështje tjetër, unë nuk duhet të merrem me këtë. Por, po flisni fjalë të mëdha për përgjegjësi. Nuk janë ata njerëz analfabetë, janë njerëz që kanë rejting, kanë bekground, dinë çfarë bëjnë, e besoj thellë dhe nuk mendoj që u ka mbetur që ju t'i moralizoni e t'u jepni me letra këshilla se çka duhet bërë ose cilat përgjegjësi i kanë karshi Qeverisë, në këtë rast. Thjesht, tendencë për instrumentalizim, po e thoni, nuk mund të ketë tendencë për instrumentalizim nga dikush që s'e ka fuqinë qeverisëse, e në këtë rast e keni ju, dhe këtë ju po e bëni dhe deklaratimet kuturu. Duhet sqaruar nëse ka pasur të tilla nga kryetari, që unë nuk e besoj. Ai i ka thënë publikisht këto vërejtje dhe ky nuk është i vetmi segment i jetës, ose institucion i pavarur që doni edhe atë ta ngulfatni. Tjerat, pothuajse i keni rehatuar gati, ose mendoni që i keni rehatuar, ndoshta u kanë mbetur edhe disa të tjera, e në mesin e tyre është edhe Oda Ekonomike.

Lërimi njerëzit të punojnë dhe ne e kemi obligim, si deputetë, që kur shohim gjëra të tilla ose tendenca, kur ankohet i pari i tyre, ne besojmë se aty ka diçka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kundër-replikë, ministri Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Zoti deputet, më vjen mirë që po shtrohen çështje të tilla, por, po e them edhe një herë, letrat janë argumente, të shkruara, të drejtuara një institucioni që është legjitim, një institucioni të Republikës së Kosovës, nga një zyrtar i Qeverisë dhe në kushte normale në atë letër duhet të përgjigjet. Prandaj, nuk jam i gatshëm për të folur me hamendje për përmbajtjen e letrave, të cilat nuk i keni, apo nuk i keni lexuar. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Zoti ministër,

Nëse vërtet s'ke pështjellë shumë tash prej që je ministër, e të ka mbetur merak ta vazhdosh atje, është dashur të rrih atje. Sipas mendimit tënd, tash ata çdo gjë që e bëjnë nuk e bëjnë mirë prej që nuk jeni ju.

Nuk po flas kuturu. Unë i kam lexuar edhe ato çka keni deklaruar ju, edhe letrën, kam pasur mundësi, edhe për ato që po deklaron përsëri kryetari, që ai njeri po shantazhohet, po shantazhohet nga ju, nga Qeveria, po në këtë rast ju jeni ata protagonistët, prandaj nëse s'ka të vërtetë në këtë punë, merruni, janë organet që duhet të merren, por unë besoj se ka diçka të tillë nga përvoja që e shohim se çfarë po u bëni të tjerëve. Doni t'ua mbyllni gojën edhe atyre edhe nesër t'ua mbyllni edhe biznesin, sigurisht, sepse, si duket, nuk u kanë dalë mirë hesapet. Këtu ka probleme të thella, të cilat nuk besoj se një kryetar i Odës Ekonomike, një njeri përgjegjës që flet kuturu, prandaj, letra më shumë, edhe unë e marr ashtu, ka qenë kërcënim se sa ndonjë letër me të cilën keni kërkuar shpjegim, sqarim. Sepse,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Ferid Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E nderuar zonja deputete,

E ngrihte një çështje aktuale këto ditë. Pas dy vjetëve, Qendra Klinike Universitare është kah e përmbyll edhe procesin e emërimit të bartësve të njësive të saj organizative të klinikave dhe instituteve.

Siç e dini, ky proces është duke u zhvilluar në pajtim me Statutin e ri të Qendrës Klinike Universitare, për të cilin është arritur, siç thatë edhe ju, pajtim i plotë ndërmjet të gjithë faktorëve vendimmarrës.

Të ju informoj se në bazë të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, drejtorët e klinikave dhe instituteve zgjidhen në bazë të Ligjit të punës, e jo në bazë të Ligjit për shërbimin civil, në bazë të cilit zgjidhet drejtori i Qendrës Klinike Universitare dhe Administrata e Qendrës Klinike Universitare, e kjo është e cekur qartë në Statutin e Qendrës Klinike, në radhë të parë, sepse drejtorët e klinikave dhe instituteve nuk janë përgjegjësi administrative, të cilat i kanë drejtorët e spitaleve rajonale, për shembull, ose që i ka drejtori i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Sa u përket lëshimeve eventuale, të cilat i përmendët, unë do të kërkoj raport zyrtar nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë dhe me siguri se do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që i tërë ai proces të vihet brenda legjislacionit në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Time Kadrijaj, replikë.

TIME KADRIJAJ: Jo, ministër, veç për sqarim.

Në nenin 23 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare është precizuar shumë mirë se kush ka të drejtë të zgjidhet drejtor nëpër qendrat klinike universitare. Po e lexoj: "Drejtorët e klinikave, instituteve, shërbimeve të përbashkëta klinike dhe shefat e

njësive të tjera organizative shëndetësore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës zgjidhen nga radhët e specialistëve të fushave përkatëse me thirrje akademike të profesorit, ose në raste të caktuara me thirrje shkencore”. Në bazë të asaj që unë raportova me emër e mbiemër, shihet se janë refuzuar profesorët, të cilët kanë konkurruar për drejtorë të klinikave të ndryshme, ndërsa janë zgjedhur asistentë. Kjo bie ndesh me vetë Statutin e Qendrës Klinike Universitare. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, ministri, Ferid Agani.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuar zonja deputete, Ju e keni parë se prej 30 pozitave, mbi 20 pozita janë të udhëhequra nga profesorët e Fakultetit të Mjekësisë. Unë i kam parë emrat e atyre, të cilët janë zgjedhur dhe ata e plotësojnë atë dispozitë statusore se duhet të kenë thirrje akademike të profesorit, ose thirrje shkencore, ndërsa në rastet konkrete ku ka ankesa, ne do të shohim se pse është bërë përzgjedhja e një kandidati me thirrje shkencore, krahasuar me një kandidat që ka thirrje të profesorit. Pra, do të analizohet çdo rast veç e veç dhe do të nxirren përfundimet përkatëse në bazë të statutit.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën për deklaramë jashtë rendit të ditës e ka kërkuar zëvendëskryeministrja dhe ministrja Mimoza Kusari-Lila.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë dua ta falënderoj zonjën Breca për arsye se për herë të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës po e sjell çështjen e djalit tim të dytë dhe shfrytëzimit, apo mosshfrytëzimit të pushimit të lehonisë, përkatësisht një çështje shumë personale të vendimit tim, që të vazhdoj punën si ministre, po e ngre për debat.

Për korrektësi dhe për informim edhe të deputetëve, edhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës, konsideroj se nëse si mjeke dhe si nënë jeni e brengosur për shëndetin e djalit tim, mund të vini ta shihni, mund të merrni informata. Gjithashtu, dua të ju tregoj se pse është iniciuar, përkatësisht është diskutuar për amendamentimin e Ligjit të punës, që specifike, e ka diskutuar pushimin e lehonisë?

Që prej periudhës sime kur kam qenë kryesuese e Odës Ekonomike Amerikane, e kemi bërë një studim, në të cilin është vërtetuar se numri i grave në forcën e punës do të bjerë në rast se kërkohet ajo kohëzgjatje e pushimit të lehonisë mu për faktin se e kemi një papunësi të lartë.

Unë nuk i konsideroj gratë e Kosovës milingona, në të kundërtën, i konsideroj si shtylla të shoqërisë, besoj fuqishëm se janë të afta t'i bëjnë detyrat ashtu siç edhe po dëshmohet në të gjitha nivelet dhe gjithashtu në përkrahje të këtyre grave kemi deklaruar se ajo kosto, e cila po i faturohet sektorit privat, është sektori privat që e ka ngrehur si çështje. Zyrtarisht, vetëm 18% e forcës së punës janë femra. Ky numër është pas fillimit dhe aplikimit të Ligjit të punës.

Në të gjitha asociacionet e biznesit mund të pyetni dhe biznes-personat femra apo gra, do të ju tregojnë se femrave kanë filluar t'ua shkurtojnë kontratat e punës, sidomos atyre që kanë potencial të marthohen dhe të lindin fëmijë, për arsye se konsiderojnë që është një kosto shtesë, meqë në vend që ta punësojnë një grua ose një femër, e punësojnë një mashkull, ngase e dinë se mund të mos ballafaqohen me koston potenciale të pushimit të lehonisë.

Unë, jo që jam në favor të pushimit të lehonisë, por inkurajoj që ai edhe të zgjatet në momentin kur ta arrijmë një standard të duhur si shoqëri, në momentin kur në secilin instancë ne të kemi mundësi, edhe si kompani private, por edhe si institucione, t'i mbështetim gratë.

Për informimin tuaj, unë nuk vozitem lart e poshtë, ashtu siç po deklaroni. Unë shkoj vetë në punë dhe vij vetë në punë, vozitem vetë. Vozitësin e përdor vetëm gjatë orarit të punës, ndërsa gjithashtu jam shumë e afërt edhe me fëmijët e mi, por po them edhe një herë kjo çështje është shumë personale për t'u diskutuar në Kuvendin e Kosovës.

Në kuadër të Ministrisë që e drejtoj, e kemi bërë një program të veçantë për garantimin e kredive, në veçanti do të ketë kuota për biznese të grave, ndërsa gjithashtu e kemi ndërmarrë edhe një seri diskutimesh dhe konferencash në të cilat po diskutohen hapat bashkë me tri agjenci ndërkombëtare për t'i fuqizuar gratë në biznes dhe në vendimmarrje.

Nëse dëshironi të jeni pjesë, unë ju ftoj në mënyrën më të mirë kolegjiale, dyert e Ministrisë janë të hapura, por ju kisha lutur të më kurseni prej sjelljes së jetës time private në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!

Ministresh e nderuar, ju faleminderit për informatën që ma dhatë në lidhje me shëndetin e fëmijës tuaj. Jam e lumtur që e paskeni shëndosh e mirë, por dua të cek se ju e keni shfrytëzuar automjetin zyrtar që t'i kryeni obligimet tuaja. Një.

E dyta, deri tash asnjëherë nuk kam pas kurrfarë ftese nga ju, as unë, e as asnjë anëtare tjetër nga ky Kuvend, në lidhje me ftesën tash që e bëtë.

Është turp që pushimin e lehonisë ta lidhni me zhvillimin ekonomik. Është turp për këtë Qeveri që zhvillimin ekonomik ta lidhë me kohëzgjatjen e pushimit të lehonisë. Ligji i punës është ai i cili vlen për të gjitha institucionet, si ato publike, si ato private. Ne edhe ju duhet të jeni ata që duhet ta implementoni Ligjin e punës, e jo të kërkonin shkurtimin e pushimit të lehonisë në këto kushte shumë të vështira ekonomike, meqë edhe më shumë do ta keqësojë gjendjen e femrës.

KRYETARI: Kundër-replikë, ministrja Mimoza Kusari-Lila.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Zonja Breca, unë nuk kam kërkuar shkurtimin e lehonisë. Atë çfarë e kam bërë vetë nuk ia rekomandoj askujt, për shkak se është sakrificë dhe është e mundimshme.

Kanë kërkuar asociacionet e biznesit, përkatësisht sektori privat, për arsye se konsiderojnë që kostoja është e lartë dhe rrjedhimisht ka rezultuar me tërheqje të grave nga forca e punës.

Edhe një herë po ju them, a është më mirë të ketë një shkurtim të pushimit të lehonisë nga logjika e sektorit privat dhe të kemi femra në punë, apo më mirë të mos i kemi fare të angazhuara dhe të jenë në shtëpi gjithë ditën me fëmijët?

Po mendoj se kjo është një çështje, e cila është në debat, është e hapur ende. Unë nuk jam ajo që i sjell rregullat. Në këtë rast, nuk e kemi iniciuar ne. Ju mund ta merrni edhe transkriptin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Kjo si çështje është shtruar prej asociacioneve të biznesit. Nuk ka ardhur me iniciativën tonë. Është hera e dytë që po diskutohet dhe është kërkuar nga ministri i Punës. Ministri i Punës ka raportuar në Këshill, se kjo është shtruar në Komisionin Parlamentar, prandaj unë e kuptoj që ju dëshironi të më sulmoni mua për diçka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetë, edhe në seancën e kaluar kam thënë të mos bëni deklarime jashtë rendit të ditës që nxitin debat. Dhe, përsëri po kërkoj, ju lutem!

Kërkojeni debatin nëse e dëshironi, e dihen procedura lidhur me këtë. Secili grup parlamentar ka të drejtë të kërkojë debat, por dihen procedurat e kërkesës për debat.

Fjalën e ka kërkuar, jashtë rendit të ditës, ministri Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Desha dy-tri sqarime t'i bëj në lidhje me çështjet, shqetësimet që i ngriti deputeti Petar Miletiq.

Sa i përket atentatit të bërë ndaj deputetit në pjesën veriore, fillimisht janë bërë hetimet nga Policia e Kosovës, edhe pse në pjesën veriore kapacitetet nuk janë të mjaftueshme dhe këtë rast e ka marrë EULEX-i plotësisht në përgjegjësinë e vet. Ne kemi mundësuar që të vendosen kontaktet dhe të jepen të gjitha informatat.

Unë nuk mund ta akuzoj deputetin, që bashkëpunimi me hetuesit e Policisë dhe të EULEX-it nuk ka qenë më i miri, për shkak të kërcënimeve edhe fizike, që ka pasur tërë kohën. Dhe, një prej arsyeve që është larguar me banim nga pjesa veriore është se edhe më tutje e kanë kërcënuar strukturat kriminele.

Unë e kam një bindje që një numër i madh i tyre përafërsisht e dinë edhe kush i ka bërë këto gjëra, por për shkak të frikës nuk janë dhënë të gjitha të dhënat. Dhe, ky rast nuk është i mbyllur, por është në duart e hetuesisë së EULEX-it.

Sa i përket vrasjes, e mund të them ekzekutimit të familjes Jevtiq në Talinovc, shpreh ngushëllimet, por edhe Qeveria i ka shprehur ngushëllimet dhe në momentin e marrjes së informatës janë marrë të gjitha masat që mund të merren.

Aty janë dërguar njësitë elite hetuese të Policisë, duke përfshirë edhe K-9, që janë gjurmët që përcillen me anë të qenve. Është vizituar atë natë, nga zëvendësministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe kryetari i Komunës, kanë qenë po ashtu komandanti rajonal edhe i Policisë së Prishtinës, po ashtu edhe të Ferizajt. Të nesërmen kanë qenë zëvendëskryeministri dhe 3-4 ministra dhe zëvendësministri im dhe realisht, pas rezultateve të Forenzikës, të autopsisë që është bërë për këta njerëz, në fund duhet të vijmë te zbardhja e këtij rasti.

Ne dëshirojmë që kjo të bëhet sa më shpejt. Nuk kemi dashur të bëjmë paragjykime të etnicitetit, për arsye se hetimet duhet ta japin fjalën e fundit. Natyrisht që këso vrasjesh mizore ndodhin edhe në vendet tjera. Dhe, nuk dua të jetë ky justifikim, mirëpo edhe një herë ndiejmë keqardhje, aq më parë kur kemi dëgjuar se këta familjarë kanë qenë të integruar edhe në strukturat e shtetit të Kosovës, pra në komunën e Ferizajt. Dhe, nuk ka pasur ndonjë animozitet, ndërsa krime të tilla bëhen dhe ne jemi të bindur se këta do të zbulohen sa më parë.

Ndërsa, sa i përket Gazimestanit, edhe një herë them me përgjegjësinë e plotë se në Kushtetutë është shumë mirë e paraparë që çdokush, qoftë me fjalor, qoftë me veshje, ikonografi, nxit urrejtje ndëretnike, ato ndalohen.

Ato fanella të tyre kanë qenë me urrejtje ndëretnike dhe Policia e ka kryer punën në mënyrë shumë profesionale dhe e ka përdorur forcën minimale në rastet, kur është penguar në punën e vet. Pra, s'ka pasur tejkalim të forcës dhe iniciatorë të këtyre kanë qenë ata, që me gjithë paralajmërimet, kanë ardhur me ikonografi të nxitjes dhe urrejtjes nacionale, prandaj Policia këtu e ka kryer detyrën në mënyrë të shkëlqyeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe pika e deklarimit të Qeverisë përfundoi. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjen e deputetëve është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje.

Sot ne kemi gjithsej katër pyetje parlamentare. Deputeti Lutfi Haziri ka pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputet, e ke fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Ju keni nënshkruar marrëveshje me Republikën e Maqedonisë lidhur me vendkalimet e reja kufitare. Dhe, njëra nga këto marrëveshje parasheh që në vendkalimin Stançiq, në mes të Gjilanit dhe Kumanovës, të funksionalizohet vendkalimi kufitar për njerëzit, e më vonë edhe për mallra.

Duke pasur parasysh se ky projekt ka filluar në vitin 2004, e ne jemi në vitin 2012, kur konkretisht do të zbatohet marrëveshja dhe kur Qeveria planifikon që ta funksionalizojë në tërësi vendkalimin kufitar në Stançiq?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë e kam pasur në rend për seancën e kaluar, por po përgjigjem sot. Realisht, kjo ide ka lindur ndërmjet ministrive të pushtetit lokal në atë kohë, që janë marrë vesh, që e dini ju shumë mirë dhe ka qenë një ide e mirë, që më vonë është finalizuar me një marrëveshje, që financimi të jetë nga Komisioni Evropian, në pikëkalimin Stançiq - Debellde, që është i një rëndësie të veçantë.

Dhe, nga ana jonë, ne e kemi ndërtuar edhe rrugën deri te vendkalimi kufitar, mirëpo Maqedonisë, për arsye të ndryshme, i mbetet ta asfaltojë edhe një pjesë prej 12 kilometrave dhe i kanë disa probleme të natyrës teknike, se ku duhet të vendoset dhe çështje teknike.

Ne i kemi ftuar dy herë në komisione të përbashkëta, dy herë kanë munguar. Mbas ngritjes së pyetjes, e kam thirrur edhe ambasadorin e Maqedonisë dhe kemi kërkuar që kjo procedurë të përshpejtohet, për arsye se edhe fondi i ndarë nga Komisioni Evropian, që gjithsej është 1 milion e 200 mijë euro mund të shkojë, të mos realizohet nëse vonohen.

Ambasadori ka premtuar se sa më shpejt do t'i fillojnë procedurat e tenderimit, që të lidhet edhe ajo rrugë e gjatë 12 kilometra, të ulen komisionet, t'i caktojnë detajet teknike dhe të realizohet sa më shpejt.

Pra, nga ana jonë, ne nuk kemi vonesë, po Maqedonia në këtë rast ka qenë më e ngadalshme në këtë projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

LUTFI HAZIRI: Zoti kryetar,

E falënderoj ministrin për përgjigje. Rëndësia e përshpejtimit të dinamikës nga Qeveria, në këtë rast e ministrit të Punëve të Brendshme lidhet me qarkullimin e lirë të njerëzve në atë regjion.

Unë e përmenda, projekti është jashtëzakonisht në kohën e duhur, por tani duhet ta tregojmë një interesim më të madh, sepse prej Stançiqit në komunën e Likovës, ata kilometra mund të asfaltohen ose të rregullohen, në mënyrë që njerëzit të fillojnë ta shfrytëzojnë legalisht këtë vendkalim. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Mirë, Faleminderit! Deputeti Danush Ademi, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin Slobodan Petroviq. Deputet, e ke fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Pyetje për zëvendëskryeministrin Slobodan Petroviq. Më 25 prill është nënshkruar një vendim për ndërtimin e 40 shtëpive në fshatin Dubravë, komuna e Ferizajt dhe është premtuar që ndërtimi do të fillojë brenda 30 ditësh, prej nënshkrimit të vendimit.

Sipas informatave që kemi marrë - përgjigje, me rishikim të buxhetit do të ndahen mjetet, por një gjë e tillë deri më tani nuk ka ndodhur.

Pyetje për zëvendëskryeministrin, të na shpjegojë se për çfarë arsye deri më tani nuk janë ndarë këto mjete?

KRYETARI: Ministër Petroviq, e ke fjalën.

MINISTAR SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, poštovani predsjedniče.

Uvaženi narodni poslanici,

Poštovani ministri,

Uvaženi narodni poslaniče,

Danuš, ono što mogu da kažem da Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave nije nadležno, niti ima u svom programu izgradnju kuće za povratnike. Takođe, prema ovoj odluci kojoj se poziva poslanik, jasno piše na kojoj adresi je adresirana ova odluka. Ono što mogu da kažem sa ovog mesta, da smo mi kao Ministarstvo na raspolaganju za svako pitanje, što se tiče mandata i nadležnosti Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave.

A ako ste mi postavili pitanje vezano za poziciju zamenika premijera, moj stav i moja uloga u tome je jasno naglašena i u Odluci same Vlade.

Znači, svakako da je to nešto što je Odluka Vlade i samim tim to je nešto što treba da ko je i dao potpis na tu odluku, da ubrza.

Znači, još jednom koristim ovu priliku da i na ovaj način izrazim podršku za one projekte, koji će imati za potrebu bolji i kvalitetniji život naših građana. Ali još jednom se izvinjavam narodnom poslaniku, jer je pitanje za druga ministarstva i svakako ono što već imate i sami, kao odluku da je to na sednici vlade već donešeno kao zaključak i očekujem da će se veoma brzo i ta odluka sprovesti u delu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, ke pyetje shitesë? Fjalën e ka deputeti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Nuk jua kam parashtruar pyetjen si ministër, po si zëvendëskryeministër, sepse këtu në vendim shkruan shumë mirë, thotë: “Zyra e kryeministrit dhe Ministria për Kthim t’i ndajë nga 200 mijë euro për ndërtimin e shtëpive të reja të komunitetit ashkalinj, në fshatin Dubravë të komunës së Ferizajt.

Unë ju kam bërë pyetje si zëvendëskryeministër, jo si ministër, sepse ju jeni përgjegjës për Zyrën e Komuniteteve pranë kryeministrit.

KRYETARI: Zëvendëskryeministër Petroviq.

MINISTAR SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se gospodine predsjedniče!

Poštovani i uvaženi narodni poslanice,

Svakako da kancelarija premijera je nešto što je u Kabinetu premijera, i za nju je odgovoran lično premijer, ne zamenik premijera. Resor zamenika premijera, kada sam ja u pitanju jeste obrazovanje, kultura i sport. To je ono na šta je po resorima raspoređeno u samoj Vladi. Ali još jednom podvlačim da sam svakako dao svoj glas za odluku koja je donešena na Vladi i da absolutno nemate potrebu da proveravate moju volju, moju želju. Znači to moja bila slobodna volja i svakako da je mandat sada na realizaciju Vlade.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputeti Danush Ademi pyetje për ministrin Radojica Tomiq. Deputet, e ke fjalën.

DANUSH ADEMI: Po e njëjta pyetje është edhe për ministrin Radojica Tomiq, sepse kjo ministri është obligative t’i ndajë 200 mijë për ndërtimin e 40 shtëpive, vendim ky i marrë më 25.4.2012. Njëherësh është marrë më 2009 një marrëveshje e memorandumit, që është nënshkruar, nuk është zbatuar deri më tani. Prapë është marrë vendimi i ri, më 25.4.2012 dhe kërkoj përgjigje, për çfarë arsye deri më tani nuk janë ndarë këto mjete?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR RADOJICA TOMIĆ: Zahvaljujem gospodine predsedavajući!

Poštovani Vladin kabinete,

Poštovani narodni poslanici,

Poštovani poslanice Danuš Ademi,

Ako se sećate, vi i ja smo nekoliko puta imali ste sastanak na ovu temu i razgovarali smo kako ćemo pomoći izgradnjom 40 kuća u Dubravi.

Mislim i znam siguran sam i zahvalan sam na vašem trudu i na vašem zalaganju.

Onda sam vam govorio da je ovo jedan veliki projekat i da ovaj projekat mora da se radi u kontinuitetu i u dogovoru sa nosiocem projekta, to je Ministarstvo za Rad i

Socijalnu Politiku i kancelarija premijera, to jest Kancelarija za Zajednice i Ministarstvo za Povratak i Zajednice.

Ja sam hteo da svi zajedno održimo jedan sastanak i da vidimo kako ćemo rešiti ovaj problem. Još jednom hoću da vas podsedim da mandat Ministarstva za Povratak i Zajednice jesu zajednice, ali nisu socijalno ugrožene porodice.

Na Kosovu danas živi 2/3 socijalno ugroženih porodica. Što iz manjinskih zajednica, što iz većinske albanske zajednice. Svi oni žive jako teško. Ono što smo mi preduzeli, što je ministar za Rad i Socijalnu Politiku izneo na Vladu, jeste da se rividira taj memorandum, kako bi se uradio novi memorandum. Postoji odluka Vlade. Ja sam kao ministar za Povratak i Zajednice uputio zahtev na rebalans ovaj budžeta, Ministarstvu Financija i očekujem pozitivan ugovor. Ukoliko dobijem pozitivan odgovor, svakako je ovo naš prioritet i moj prioritet, gde ćemo adekvatno odgovoriti na odluku Vlade, što je i naša obaveza, i započeti izgradnju kuća. Hvala vam!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputet Ademi?

DANUSH ADEMI: Unë shumë mirë e kuptova ministrin, por këtu në vendim shkruan se ai hyn në fuqi dhe është premtuar nga kryeministri që brenda 30 ditësh do të fillojë rindërtimi i shtëpive.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Tomiq.

MINISTAR RADOJICA TOMIĆ: Ja sam vam ukratko objasnio da su u pitanje financije, da nijedno ministarstvo nije imalo da izdvoji toliko sredstava odjednom, i da smo zbog toga čekali i uputili svi zahtev na rebalans budžeta, kako bi dobili sredstva da jednom započnemo ovaj projekat.

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, pyetja e fundit, deputetja Teuta Haxhiu pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, e ke fjalën nëse do ta bësh pyetjen.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

I pashë tre zëvendëskryeministra, por më ikën edhe ata të tjerët. Prandaj, po e lë për seancën tjetër.

KRYETARI: Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 5 korrik 2012

A keni vërejtje në këtë procesverbal? Jo.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 5 korrik 2012.

Pika e radhës, pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, si dhe i ka shqyrtuar edhe të gjitha kërkesat, të cilat i janë drejtuar Komisionit dhe në fund e ka hartuar raportin me rekomandime, i cili është miratuar nga anëtarët e Komisionit më 5 korrik 2012 dhe u ka rekomanduar deputetëve të Kuvendit ta miratojnë Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe amendamentet e Komisionit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, sipas Rregullores Punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa i ka të themeluara tri grupe punuese, të përhershme, e secili grup punues është përgjegjës për një pjesë të projektbuxhetit të përcaktuar në mënyrë të qartë, kurse të gjitha grupet e mbulojnë plotësisht tërë projektbuxhetin.

Grupet punuese i kanë shqyrtuar plotësim-ndryshimet që janë bërë në buxhet, si dhe i kanë shqyrtuar 39 kërkesa buxhetore të parashtruara në Kuvend deri më datën 5 korrik 2012, kur e kanë miratuar raportin me rekomandime.

15 kërkesa buxhetore kanë qenë nga institucionet e pavarura, 8 kërkesa nga komunat, kurse 12 kërkesa nga ministritë, 4 kërkesa nga grupet parlamentare dhe komisionet. Janë mbajtur edhe 12 dëgjime publike buxhetore me organizatat buxhetore.

Grupet punuese kanë përgatitur rekomandime, të cilat janë analizuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku edhe janë hartuar amendamentet, të cilat janë votuar një nga një në komision, e po ashtu është miratuar edhe raporti përfundimtar, duke i rekomanduar Kuvendit që ta miratojë raportin me rekomandime.

Komisioni ka qenë nën presionin e kërkesave buxhetore, të cilat kanë ardhur nga organizatat buxhetore deri në momentin e miratimit të raportit me rekomandime, në mungesë të një rregullative ligjore se deri në çfarë dite pas miratimit në parim të Projektligjit për Buxhetin organizatat buxhetore mund t'i drejtohen Kuvendit me kërkesa buxhetore.

Për të gjitha ndryshimet që i kemi propozuar si amendamente kemi pasur një qëndrim të përbashkët në komision dhe nuk ka pasur kundërshtime. Të gjithë anëtarët e komisionit kanë qenë aktivë në formulimin e amendamenteve dhe në propozimet për plotësim-ndryshim dhe nuk kanë hezituuar për të punuar me orar të zgjatur, për ta përfunduar amendamentimin sipas planit të punës dhe për ta bërë punën më të mirë të mundshme.

Komisioni ka pasur mbështetje teknike dhe profesionale nga Projekti për bashkëpunim gjerman GIZ dhe nga Instituti Nacional Demokratik.

Të nderuar deputetë, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar raportin me rekomandime, andaj kërkoj nga të gjithë ju që t'i miratoni amendamentet e propozuara dhe ta miratoni si tërësi Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Buxhetin për vitin 2012. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'i falënderoj deputetët e Kuvendit të Kosovës, komisionet e Kuvendit, për punën e tyre intensive, profesionale dhe shumë korrekte, që brenda këtij afati të arsyeshëm t'i përgatitin të gjitha amendamentet, ta përmirësojnë ligjin në raport me leximin e parë dhe t'u mundësojnë organizatave buxhetore, komunave dhe organizatave buxhetore të nivelit qendror që të kenë mundësi për të vazhduar me ekzekutimin e buxhetit, me ekzekutimin e projekteve, pasi është me rëndësi jetike për të gjitha organizatat buxhetore.

Unë edhe një herë, duke i falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës, duke pasur për bazë rëndësinë e këtij projektligji dhe rëndësinë e zhvillimit të projekteve në nivel lokal dhe qendror, ju lus që të njëjtin ta votoni. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Kalojmë në votim. Të pranishëm janë 78 deputetë. Të gjitha amendamentet janë të Komisionit Funksional.

Votojmë amendamentin 1. Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 21.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 22.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 23.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 24.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 25.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 26.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 27.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 28.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 29.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 30.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 31.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Të pranishëm janë 84 deputetë. Votojmë projektligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 55 vota për, 27 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Nëse jeni dakord, e caktojmë një pauzë prej 15 minutash.

Pas pauzës, Kuvendi i vazhdoi punimet. Seancën e drejton nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Po vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos nga Shqipëria

Deputeti Emin Gërbeshi dhe grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 44, të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministren Mimoza Kusari-Lila.

Ju njoftoj që në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit, 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8 e Rregullores së Kuvendit, ministrja Mimoza Kusari-Lila paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

E dini që koha për grupet parlamentare është e ndarë:

- PDK-ja ka 50 minuta,
- LDK-ja, 40 minuta,

- “Vetëvendosje”, 18 minuta,
- AAK-ja, 18 minuta,
- Koalicioni Kosova e Re, 11 minuta,
- SLS, 13 minuta,
- Grupi Parlamentar “6+”, 7 minuta dhe
- Deputetët pa grup parlamentar deri në 2 minuta, që bëjnë gjithsej 16 minuta.

Në interpelancat e mëparshme, kryeministri e ka marrë kohën e deputetëve të Partisë Demokratike dhe është e drejtë e tij që minutazhin e Grupit Parlamentar ta shfrytëzojë për sqarime shtesë.

E ftoj deputetin Emin Gërbeshi, nga grupi i deputetëve nënshkrues, ta marrë fjalën lidhur me mocionin.

EMIN GËRBESHI: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Jo rrallë ndodh që vendimet e pamatura të atyre që udhëheqin të detyrojnë të reagosh ashtu siç reagon masa. Kështu ndodhi edhe më 11 qershor 2012, kur Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e nxori një vendim për tui vënë një tarifë prej 35% çimentos që importohet për në Kosovë, sidomos nga Shqipëria.

Kjo masë e ndërmarrë nuk do të ishte aspak interesante sikur të mos merrej në kohën kur kërkesat e tregut ishin maksimale dhe në kohën kur shkëmbimi tregtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë sa vinte e po rritej dhe një vendim i tillë mund t’i acarojë marrëdhëniet tregtare ndërmjet dy vendeve.

Pas një vendimi të tillë, shumë të panatyrshëm, tepër provokues dhe fyes për çdo shqiptar kudo që jeton, vihej vetëm një arsye, se po e mbrojmë prodhimin vendor.

Në të vërtetë, MTI u vu në shërbim të “Sharrcemit”, prodhuesit të vetëm të çimentos në Kosovë, e që menaxhohet nga kompania greke “Titan”, duke i krijuar monopol të padiskutueshëm në tregun e Kosovës, në kundërshtim me ligjet e ekonomisë së tregut të lirë, madje në kundërshtim edhe me programin ekonomik të Koalicionit për Kosovë të Re.

Të kujtojmë se kjo kompani e mori në pronësi “Sharrcemin” në mënyrë të paligjshme, e administron këtë pronë shtetërore të Kosovës edhe sot në mënyrë të paligjshme dhe çuditërisht kjo kompani mbrohet në mënyrë të paligjshme nga ministrja Mimoza Kusari-Lila.

Dihet se kjo fabrikë nuk i përmbush nevojat e tregut kosovar. Kapacitetet prodhuese të “Sharrcemit” janë 535 mijë tonë, kurse kapacitetet e instaluar janë rreth 800 mijë tonë në vit. Këtë sasi ky prodhues nuk e ka arritur asnjëherë, sepse nuk i ka bërë

investimet e premtuara më parë dhe përafërsisht “Sharrcemi” mbulon kërkesat e tregut në Kosovë diku ndërmjet 25 dhe 30%. Kërkesat tjera janë mbuluar nga importet, sidomos nga Serbia dhe Maqedonia, në të kaluarën.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në vend se të kërkojë nga “Titani” që t’i përmbushë premtimet dhe investimet, sidomos rreth ambientit, cilësisë dhe shtimit të kapaciteteve, duke e kuptuar edhe shtimin e numrit të punëtorëve, e vë atë në mesin e të privilegjuarve.

Të kujtojmë se “Sharrcem” ka qenë edhe në të kaluarën një gjigant ekonomik, që vazhdimisht ka sjellë fitime të mëdha si kompani.

Kompania “Titan”, pa bërë investime, ose me investime shumë të vogla, e ka pasur një profit mbi 20 milionë në vit.

E nderuara ministre, sikur ju t’u përmbaheshit fjalëve që keni thënë në fushatën zgjedhore dhe programit ekonomik të Koalicionit për Kosovë të Re, sigurisht do të kërkonit që kjo fabrikë e privatizuar në mënyrë të paligjshme t’i kthehet Kosovës dhe të shkohet në privatizim legal.

Për mua është shumë e qartë se “Titan” ka njerëz të fuqishëm në Qeverinë e Kosovës, përndryshe s’do të mund të besoja se si ka mundësi të merret një vendim i tillë dhe plot një muaj të arsyetohet në mënyrë aq të turpshme, nga një ministre që është me profesion ekonomiste.

Kur keni vendosur për një masë, të paktën është dashur të mendoni se nuk mund të përcaktoni çmimin e këtij malli në treg, sepse ekonomia e lirë i ka ligjet e saj, ofertën dhe kërkesën, prandaj kësaj kompanie i keni siguruar beneficione të papara në historinë e ekonomisë së tregut, në kohën kur ju deklaroheni për zona të lira ekonomike.

Duket qartë se ju s’keni qenë e preokupuar me pasojat që do t’i sjellë një vendim i tillë. Tashmë e keni marrë një vendim që do t’i dyfishojë të ardhurat e kompanisë “Titan”, duke e dëmtuar rëndë konsumatorin e Kosovës.

Vendimi juaj ka prodhuar pasoja ekonomike, e ka ngritur çmimin e çimentos deri në 20% dhe rritja do të vazhdojë deri sa të jetë në fuqi vendimi juaj. E ka eliminuar konkurrencën e lirë në treg, duke krijuar monopol vetëm për një kompani, e ka rritur koston e ndërtimeve, duke krijuar inflacion në sektorin e ndërtimtarisë, ka rrezikuar shumë firma importuese të këtij produkti, duke i çuar drejt falimentimit, ka rrezikuar shumë vende pune në sektorin e ndërtimit dhe në firmat importuese.

Vendimi juaj e ka eliminuar çimenton e Fushë-Krujës, që është më cilësore dhe më e lirë.

Dhe, në fund, e keni çrregulluar furnizimin me këtë lëndë të rëndësishme të ndërtimtarisë, në kohën kur kërkesat për këtë mall janë maksimale.

Ka argumente të mjaftueshme për ta vënë në dyshim edhe vetë kapitalin e “Titanit”, i cili e kontrollon tregun e çimentos në rajon. Ky dyshim u vu në dukje sidomos kur pronarët e “Titanit” u zunë duke kontrabanduar çimento në Doganat e Kosovës. Me muaj të tërë kjo kompani, në emër të lëndës së parë nga Maqedonia, ku e administrojnë fabrikën tjetër, në Kosovë ka futur kontrabandë - çimento të pastër.

Për këtë çështje ka shkruar edhe shtypi i huaj. Unë mund të gaboja, por nuk e besoj se ju në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë nuk keni pasur njohuri.

Ju keni pasur mundësi ta korrigjoni vendimin tuaj të gabuar, kur “Titan” u zu duke kontrabanduar çimento. Ju e dënuat me 10 mijë euro atë që ka fituar miliona. Në vendet tjera, pronarit do t’i mbyllej ose do t’i konfiskohej fabrika.

Kur u mor vendimi, në depot e “Sharrcemit” kishte stoke të mëdha të çimentos, që ishte para skadencës dhe e dyshimtë për kah cilësia. Kjo çimento pothuaj në masë të madhe ishte kontrabandë dhe MTI, në vend se ta ndëshkonte, “Titanit” ia dha monopolin dhe se nëse me mijëra shqiptarë në Prishtinë e Tiranë, sidomos klasa e biznesit, flasin për mundësinë e korrupsionit, në bazë të asaj që unë kam hulumtuar, nuk mund t’i shmangem kësaj fjale që është fjala më e urryer për çdo qytetar të Kosovës.

E nderuara ministre, vendimi juaj e ka prekur sektorin më të rëndësishëm në Kosovë, atë të ndërtimtarisë. Natyrisht, se në aspektin ekonomik vendimet e pamatura prodhojnë kriza dhe inflacione. Kjo tashmë ka ndodhur. Ju i keni krijuar monopol një prodhuesi, i cili po e dikton çmimin e çimentos. Edhe ashtu, me vite të tëra, çmimi i këtij produkti në tregun e Kosovës ka qenë më i larti në rajon.

Por, ky çmim do të vijë duke u rritur vazhdimisht, nëse vendimi juaj do të mbetet në fuqi. Kur “Titan” u rrezikua ta humbë privilegjin në tregun e Kosovës, edhe me cilësi, edhe me çmim, ishit ju që me vetëdije ose pa vetëdije u vutë në shërbim të kësaj kompanie, duke privilegjuar atë dhe duke e shkelur rëndë konsumatorin, apo qytetarin e Kosovës.

Kjo nuk të falet, pa marrë parasysh se a e ke bërë me interes apo pa interes dhe se vetë krijimi i monopolit, në njëfarë mënyre është korrupsion.

Sot, qindra kamionë presin para “Sharrcemit” deri në 24 orë. Me ata që kemi biseduar flasin për ryshfet e forma tjera korruptive brenda fabrikës.

Vendimi juaj bie ndesh me parimet bazë, mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian, ku ne po pretendojmë të shkojmë. Dhe, i falënderohemi BE-së për kundërshtimin e këtij vendimi. Po ky vendim, gjithashtu bie ndesh me CEFTA-n dhe gjithsesi ky vendim bie ndesh edhe me Ligjin për masat mbrojtëse në importe,

sidomos në nenet 2, 3, në nenin 9 po të këtij ligji, e tjerë. Marrë në përgjithësi, vendimi juaj nuk ka asnjë bazë ligjore, sepse “Sharrcemi” nuk mbulon me prodhimin e tij kërkesat e tregut në Kosovë. Çimento e importuar nuk e ka rrezikuar në asnjë mënyrë prodhuesin vendor. Ka qenë më e lirë dhe më cilësore.

Sikur të mos vihej masa ndëshkuese ndaj çimentos së Fushë-Krujës, sepse ne e dimë që çimentoja nga Serbia dhe Maqedonia mund të hyjë në Kosovë edhe në rrugë të tjera, çmimi i çimentos nuk do të kalonte 4,5 euro për 50 kilogramë, kurse sot në treg është 5,5 euro, e diku-diku edhe 6 euro.

Unë do të ju kisha mbështetur pa rezervë, sikur vendimi juaj të ishte në favor të qytetarëve, por tani e kundërshtoj me forcë këtë vendim, për të vetmen arsye, se dëmton interesat e biznesit, të sektorit të ndërtimtarisë dhe të qytetarit.

Ju nuk e keni mbrojtur asnjë prodhim vendor deri më sot. Të kujtojmë se masa mbrojtëse vendosin të gjitha vendet, sidomos për t’i mbrojtur prodhimet bujqësore dhe prodhimet sezonale.

Ne nuk e kemi mbrojtur bujkun as prodhimet, në disa sektorë tjerë të prodhimtarisë, sidomos në sektorin e ndërtimtarisë, të verërave e shumë e shumë prodhime të tjera. Nga Serbia, me qindra kamionë hyjnë në ditë në Kosovë dhe ata bartin me vete mallra të tilla, të cilat prodhohen edhe në Kosovë dhe mbulojnë tregun mbi 60%.

Asnjëherë nuk u ka shkuar ndërmend se duhet ta ndërmerri një masë të tillë për t’i mbrojtur këto prodhime, kurse merrni vetëm ndaj një prodhimi që vjen nga Shqipëria.

Do të kisha shumë dëshirë, që këtu të flisja për vendime të guximshme, në favor të qytetarëve të Kosovës, në favor të kombit tonë, po ju nuk na e keni dhënë këtë mundësi. Vendimi juaj është antishqiptar dhe duhet të hiqet menjëherë.

E di se në praktikat parlamentare, të paktën në Kosovë, nuk ka ndodhur që një deputet ta thërrasë në interpelancë ministren nga partia e tij, por t’u kujtojmë se gjatë fushatës elektorale u kemi premtuar qytetarëve të Kosovës se do t’i mbrojmë interesat e tyre, prandaj po e përmbushim një obligim.

Në të vërtetë, përkrahjen që ua dha partia dëshmoi edhe një herë se interesat tuaja individuale dhe atyre që u përkrahën u vunë mbi interesat e një kombi të tërë.

Ministre e nderuar, ju me një vendim të tillë i keni vrarë ëndrrat tona të kamotshme për një treg të lirë, pa kufij, pa bllokada, ndërmjet shqiptarëve.

Tani, qarkullimi i mallrave në kufij me Shqipërinë u ngjason kohërave të kaluara.

Në shtetet demokratike, kur një ministër e merr një vendim, i cili prodhon efekte negative, në aspektin moral jep dorëheqje. Te ne mund të ndodhë edhe e kundërta.

Të nderuar deputetë,

Sot e kemi një mundësi para vetes që të marrim vendim për shfuqizimin e këtij vendimi absurd që na poshtëron, së pari si shqiptarë. Kam besimin e madh se ju me votën tuaj do të dëshmoni se jeni për ekonomi dhe treg të lirë, për konkurrencë reale në treg, e jo për monopole e barriera tjera, që na ndajnë si komb dhe na ndajnë edhe nga popujt tjerë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre Mimoza Kusari-Lila, e keni fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë nga Kabineti qeverisës,

Të nderuar deputetë,

Së pari, më lejoni të ju falënderoj për shansin e dhënë që sot të debatojmë për vendosjen e taksës për çimenton e importuar në Kosovë, për arsye se kohëve të fundit kjo taksë dhe ky debat ka devijuar nga komentet dhe analizat racionale, deri në atë masë, sa akuzat, konspiracioni, spekulimet, faktet e paqena për vendim e kanë zënë pjesën më të madhe të hapësirës publike, duke i lënë anash argumentet, faktet, zërat konstruktivë, interesin publik dhe forcimin e prodhimit vendor.

Është koha që sot këtu, në këtë seancë, t'i ndajmë faktet nga konspiracioni, argumentet nga spekulimet, interesin publik nga ai personal dhe mbrojtjen e prodhuesit vendor nga euforitë e momentit.

Është theksuar vazhdimisht se vendimi është kundër Shqipërisë. Për më tepër, në titullin e kësaj interpelance thuhet se kjo është thirrur për të informuar Kuvendin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës për vendimin e marrë nga MTI-ja për vendosjen e tarifës prej 35% të çimentos nga Shqipëria.

Ky nuk është vendim kundër Shqipërisë. Vendimi është publik, transparent dhe mund të shihet nga të gjithë. Në asnjë pikë të vendimit nuk thuhet se ky vendim është kundër importit të çimentos nga Shqipëria.

Vendimi për masat e përkohshme mbrojtëse është për gjithë importin e çimentos që hyn në Kosovë, pa marrë parasysh destinacionin.

Ankesa kanë ardhur edhe nga Serbia edhe nga Maqedonia. Kompania "Hollcing" nga Serbia, nëpërmjet një letre drejtuar Ministrisë që unë drejtoj, është ankuar për vendimin e kësaj Ministrie për importin e çimentos. Për më tepër, të gjitha kompanitë për prodhimin e çimentos, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, janë në pronësi të huaj.

Vendimi është rezultat i sasisë së tepruar të çimentos në rajon, që e ka origjinën nga Italia. Për shkak të taksës ekologjike, ku prodhuesit gjobiten me taksë nëse prodhimi i tyre bie nën 50%, Italia ka bartur në tregun e Shqipërisë sasi shumë të mëdha të çimentos me çmime të ulëta.

Kjo ka rezultuar me një ulje drastike edhe të çmimit të çimentos së prodhuar në Shqipëri, në kohën kur kërkesa e çimentos kishte rënë në të gjitha vendet e rajonit, përveç në Kosovë. Në Kosovë ende ka kërkesë në rritje për konsumin e çimentos.

Ngritja drastike e importeve të çimentos në Kosovë në vitet 2011 dhe 2012 është rezultat i çimentos së ardhur nga Italia në tregun rajonal. Mirëpo, mendimi që nga ulja e çmimeve përfiton konsumatori, është vetëm iluzion. Çmimet e tilla të ulëta mbahen vetëm deri atëherë kur shkatërrohen industritë vendore, pastaj çmimi diktohet nga importi.

Kjo ka ndodhur në Kosovë edhe më herët, para disa viteve, në industrinë e vezëve, e kjo mund të ndodhë edhe me çimenton, deri në momentin kur prodhuesi vendor të hiqet nga tregu. Importuesi pastaj e dikton çmimin dhe e kthen në nivelin, ku ai fiton ende më tepër.

Vendimi ka bazë të plotë ligjore. Kjo së fundi është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme. Me një aktvendim të datës 9 korrik 2012, Gjykata Supreme e ka refuzuar kërkesën e dy kompanive, njëra nga Kosova dhe tjetra nga Shqipëria, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me të cilin janë vendosur masat e përkohshme mbrojtëse në çimento.

Në vendimin e Gjykatës Supreme thuhet: “Gjykata e shqyrtoi kërkesën e paditësve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të së paditurës dhe shkresat tjera të lëndës dhe konstatoi se paditësi nuk ka bërë me asgjë të besueshme që ekzekutimi i vendimit të së paditurës do të mund t’u shkaktonte atyre dëm që vështirë se mund të rikuperohet”.

Sidoqoftë, më lejoni edhe një herë në pika të shkurtra të ju rikujtoj çka ka sjellë deri te vendimi.

Aplikacioni i “Sharrcemit” - Aplikacioni nga kjo kompani për masat mbrojtëse lidhur me dëmtimin serioz të tregut të çimentos në Kosovë, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është pranuar për herë të parë më 18 prill 2012 dhe është dërguar për t’u protokolluar, pasi është dorëzuar me shkrim herën e dytë, më 14.5.2012, numri i protokollit 2973. Në këtë ankesë nga “Sharrcemi” është përshkruar dëmtimi serioz i tregut të çimentos nga importi. Këto ndërmarrje në vitin 2009 mbulonin tregun me 3,2%, ndërsa për dy vjet e rritën mbulueshmërinë e tregut në 39%.

Rritja e menjëhershme e importit nga këto vende ka ndikuar në dëmtimin e tregut të çimentos në Kosovë.

Procesi i hetimit - Pas pranimit të kërkesës nga “Sharrcemi”, Departamenti i Tregtisë e ka filluar analizën e tregut të çimentos në Kosovë dhe rajon me qëllim të verifikimit të informatave të dhëna nga “Sharrcemi”.

Si rezultat i analizave është vërtetuar se përkundër faktit që “Sharrcem” është më i shtrenjtë, 90 euro për ton, krahasuar me 57 euro për ton çimentoje nga Fushë-Kruja, në fund çmimi i fundit të konsumatori del me të njëjtin çmim, ose me një dallim prej 10 centësh, sikur edhe Fushë-Kruja, 5,2 euro, përkatësisht 5,5 euro për një thes të çimentos 50-kilogramësh.

Me gjithë faktin që çimento importohet me një çmim më të lirë, konsumatori i Kosovës nuk ka përfituar, përderisa importi rritej në përmasa enorme.

Departamenti i Tregtisë atëherë është munduar të kontaktojë me distributorët e Fushë-Krujës për të parë se ku është problemi, mirëpo gjithmonë Departamenti i Tregtisë ka hasur në veshë të shurdhër.

Pas pamundësisë për të marrë një përgjigje nga distributorët, Komisioni u është kthyer analizave të dhënave që janë ofruar nga Doganat e Kosovës për çmimet importuese. Nga këto të dhëna del se, edhe pse çimentoja e importuar merrej me çmim 3,7 euro, e njëjta sasi shitej në vlerë 5,2 euro dhe 5,5 euro për konsumatorët kosovarë.

Në këtë rast, përfitues të vetëm në këtë proces kanë qenë distributorët, të cilët kanë përfituar në masë të madhe nga çdo thes i shitur.

Pas analizave të bëra në treg, bazuar në Ligjin për masat mbrojtëse në importe, me qëllim të mbrojtjes së tregut të çimentos, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka vendosur një taksë doganore prej 35% për të gjitha vendet - omni erges, bazuar në nenin 23 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë CEFTA, i cili i referohet nenit 19 të Marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë për masat mbrojtëse dhe se këto mundësojnë norma më të larta tarifore se ato të CEFTA-s, të cilat janë 10%, por nuk kanë qenë të mjaftueshme për një treg të lëndueshëm, si ai i Kosovës me deficit enorm tregtar.

U përmend shpeshherë në debatin publik se vendimi nuk ka bazë ligjore. Më lejoni të ju rikujtoj vetëm disa prej ligjeve dhe neneve, në të cilat vendimi është bazuar.

Baza ligjore e këtij vendimi është në Ligjin për masat mbrojtëse, të miratuara nga po ky Kuvend, në qershor të vitit 2011. Neni 4, pika 2 e këtij ligji i përcakton qartë masat mbrojtëse dhe kushtet e zbatimit të tyre. Po citoj: “Masat mbrojtëse në produktet e importuara në territorin e Republikës së Kosovës zbatohen vetëm nëse është e përcaktuar nëpërmjet një hetimi të kryer sipas dispozitave të këtij ligji, që produkti i hetuar është importuar në territorin e Republikës së Kosovës në sasi të mëdha dhe në kushte të tilla, që i shkaktojnë ose kërcënojnë t’u shkaktojnë dëme serioze prodhuesve të mallrave të njëjtë në Kosovë, ose shkakton çrregullim në një sektor të ekonomisë, të cilat do të mund të sillnin përkeqësim të gjendjes ekonomike të këtij sektori në Kosovë”.

Neni 6 i po këtij ligji përcakton konsultimet me prodhuesit vendorë. Konsultimet për masat mbrojtëse nëpërmjet ministrisë dhe prodhuesve mund të bëhen para inicimit të

një hetimi me rastin e një kërkesë me shkrim nga prodhuesi, apo me iniciimin e ministrisë.

Neni 7 i përcakton procedurat për fillimin e hetimeve.

Neni 19, pika 1 dhe 2, e përcakton masën e përkohshme mbrojtëse.

Masat e përkohshme mbrojtëse vendosen me vendimin e Ministrisë, nëse rekomandohet nga Ministria, menjëherë sapo të iniciohet hetimi dhe duhet të zbatohet vetëm në rrethana kritike, kur ka fakte evidente që demonstrojnë se rritja e importeve të produktit të hetuar ka shkaktuar ose ka kërcënuar t'u shkaktojë dëme serioze prodhuesit apo prodhuesve në Kosovë, kur një veprim i tillë i shpejtë kërkohet për parandalim apo kompensim.

Kjo është përgjigjja për gjithë ato dyshime, të cilat janë ngritur pse vendimi është marrë para se të fillojë procedura e konsultimeve, ashtu siç ka ndodhur në rastin konkret.

Ndërkaq, në nenin 15 thuhet se Ministria konstaton dhe merr vendim në bazë të informatave që i ka në dispozicion.

Pra, nenet 4, 6, 7, 15 dhe 19 e përcaktojnë qartë dhe pa asnjë dyshim bazën ligjore të vendimit dhe mosmarrja e një vendimi të përkohshëm deri në një vendim tjetër përfundimtar do të paraqiste shkelje të pastër të Ligjit për masat mbrojtëse.

Pa marrë parasysh bazën ligjore të cekur deri më tani, vendimi është sulmuar në shumë drejtime. Është thënë se kur është marrë ky vendim është thyer një ligj tjetër, Ligji për konkurrencën. Ky është një pohim i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në këtë ligj. Më lejoni ta shpjegoj këtë rast.

Më 22 qershor të këtij viti, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka pranuar një vendim nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili sugjeron që masat mbrojtëse në rastin e çimentos të rishikohen. I rëndësishëm është fakti që vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nuk e quan vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të kundërligjshëm, siç ka pasur tendencë të prezantohet.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka kërkuar menjëherë nga po ky autoritet raportin e plotë për hulumtimin e bërë nga ky organ, në mënyrë që të shihen të dhënat e grumbulluara nga tregu dhe të përdoren këto të dhëna gjatë rishikimit të vendimit. Këto gjetje të Komisionit të Konkurrencës në të njëjtën kohë i kemi krahasuar me studimet e bëra nga Ministria.

Në bazë të të dhënave që disponojmë, rasti i “Sharrcemit” nuk konsiderohet monopol, për arsye se fabrika mbulon 33% të tregut të Kosovës. Ndërsa sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, monopol konsiderohet të jetë çdo ndërmarrje që ka më shumë se 40% të tregut. Neni 10, pika 2 e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës thotë

thjeshtë: “Një ndërmarrje konsiderohet të ketë pozitë dominuese nëse ka pjesëmarrje të madhe se 40% në treg”. Kjo pjesëmarrje nuk konsiderohet pozitë dominuese, në rast se ndërmarrja në fjalë argumenton se është ekspozuar para një konkurrence që nuk ka pozitë superiore në treg, në krahasim me konkurrentët e vet.

Gjatë ditëve të kaluara janë dëgjuar shumë zëra se vendimi për çimenton e shkel Marrëveshjen e CEFTA-s. Të ju them të drejtën, një debat i tillë ka qenë paksa i çuditshëm. Përderisa vite me radhë, i gjithë komuniteti i biznesit, por edhe klasa politike e kanë sulmuar këtë marrëveshje si të dëmshme për Kosovën, tani ajo shfrytëzohet për sulme ndaj vendimeve të institucioneve të Kosovës.

Së pari, vendimi absolutisht nuk është shkelje e Marrëveshjes së CEFTA-s. Në bazë të Marrëveshjes së CEFTA-s, vendimet për masat mbrojtëse nuk janë shkelje e marrëveshjes. Neni 23, paragrafi 1 dhe 2a dhe 2b, përcaktojnë qartë dhe lejojnë masat mbrojtëse në importe për secilin vend të CEFTA-s.

Së dyti, CEFTA është marrëveshje e nënshkruar në vitin 2006, kur për shkak të mungesës së plotë të ndonjë politike ekonomike asaj kohe, Kosova e ka nënshkruar marrëveshjen, duke i larguar të gjitha barrierat për importe. Pra, duke mos e favorizuar prodhimin vendor ndaj atij të huaj. Kjo ishte arsyeja kryesore pse ne sot jemi të detyruar që të marrim vendime për prodhimet vendore.

Gjatë debatit, gjithashtu shpesh është përmendur se Buxheti i Kosovës ka humbur për shkak të rënies së importit të çimentos, pas marrjes së vendimit për masat e përkohshme mbrojtëse. Kjo nuk mund të jetë e vërtetë për të vetmin fakt, se shumica e sasisë së importuar të çimentos në Kosovë vjen nga vendet e CEFTA-s, përjashtoj pjesën që ka ardhur nëpërmjet Shqipërisë nga Italia, prandaj importuesit nuk paguajnë doganë, por vetëm TVSH.

E për ata që nuk e dinë, TVSH-ja paguhet edhe nga prodhuesi vendorë. Për më tepër, këtë dua ta theksoj se sipas Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganave të Kosovës, “Sharrcem” është një nga kontribuuesit më të mëdhenj në Buxhetin e Kosovës, edhe zyrtarisht, tatimpaguesi më i madh për pesë vjetët e fundit, duke kontribuar me 48 milionë euro në Buxhetin e Kosovës. Prej tyre, 32,56 milionë euro janë të hyra të brendshme dhe 15 milionë janë të hyra nga kufiri.

Në anën tjetër, një nga importuesit më të mëdhenj të çimentos në Kosovë, bashkë me bashkëpunëtorë, për 5 vjetët e fundit i ka kontribuar Buxhetit të Kosovës me 5,8 milionë euro, rreth 42 milionë euro më pak se “Sharrcemi”. Për sa i përket numrit të punësuarve, organizata prodhuese ka 500 punëtorë shqiptarë në Han të Elezit dhe e luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e një komune me 10 000 banorë. Ndërsa, importuesi më i madh i çimentos në Kosovë ka të deklaruar 38 punëtorë. Këto janë të dhëna, të cilat mund të konfirmohen lehtë nga secili deputet i Kuvendit të Kosovës në institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kur flasim për numra, duhet të sigurohemi se flasim për shifra zyrtare, e jo për shifra të deklaruara në media. Nuk mund shteti t'i mbrojë interesat e dikujt që nuk e respekton shtetin, pa paguar tatime dhe kontribute. Edhe në të ardhmen, vendimet duhet të merren vetëm në bazë të shifrave zyrtare dhe do të merren në bazë të tyre, e jo nga ato të deklaruara nga bizneset për qëllime të presionit publik. Vendimi është i thjeshtë, a dëshirojmë ta përkrahim ekonominë formale, apo ekonominë joformale?

Dëshiroj të jua rikujtoj kohën kur kam ardhur në krye të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në atë kohë prodhuesit vendorë vazhdimisht ishin duke u ndeshur me probleme të shumta, duke filluar nga pamundësia e transitit dhe eksportit në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë, nga problemet tregtare me Shqipërinë, Maqedoninë, e madje edhe nga mungesa e trajtimit preferencial nga vendet e Bashkimit Evropian.

Politikat tona vazhdimisht, kanë qenë në mbrojtje dhe mbështetje të prodhuesve vendorë. Asnjë vend, asnjëherë nuk është zhvilluar vetëm nga importet. Si shtet nuk kemi arsye ekonomike, tregtare, që ta favorizojmë importin për produkte të cilat i prodhojmë vetë në Kosovë, e të cilat nuk janë aspak më të dobëta për nga cilësia se ato të vendeve të rajonit. Për këtë arsye, politikat strategjike të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, vazhdoja fjalën derisa ta përfundojë.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Jam akuzuar, gjithashtu, se asnjëherë më parë nuk kam bërë mbrojtjen e produkteve vendore.

Vetëm dua të theksoj se rasti i “Sharrcemit” nuk është marrë ad hoc nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ky vendim është pjesë e politikave strategjike të MTI-së për mbrojtjen e prodhuesve vendorë dhe për favorizimin e eksporteve, që prej fundit të shkurtit të vitit 2011. Prej vitit 2008, deri në shtator të vitit të kaluar, Serbia i kishte bllokuar plotësisht produktet me origjinë kosovare dhe institucionet e Kosovës që janë të mandatuara për politika tregtare, as që flisnin në atë kohë për këtë problem.

Para vendosjes së masave të reciprocitetit, prodhuesit tanë vendorë i nënshtroheshin tregut me prodhime serbe, pa e pasur mundësinë e njëjtë që të eksportojnë në tregun e Serbisë. Së dyti, për shkak të kostos së ngritur të transportit, eksportet tona, sidomos eksporti i verërave për në tregjet e Bashkimit Evropian nuk kishte ngritje.

Pas vendimit të reciprocitetit dhe pas pranimit të vulave të Doganave të Kosovës, prodhuesit tanë mund të eksportojnë për në Serbi dhe nëpërmjet Serbisë për në vendet e Bashkimit Evropian. Kostoja e tyre të transportit është ulur ndjeshëm.

Me Shqipërinë, siç e dini, problemet kanë qenë me prodhuesit e qumështit dhe të patates, që nga Kosova i nënshtroheshin një konkurrence jo fer dhe praktike të kundërligjshme në ekonominë e tregut.

Çmimi i qumështit dhe i patates rritej artificialisht nga Doganat, duke pamundësuar konkurrencën lojale në tregun shqiptar. Edhe në atë kohë kemi reaguar menjëherë për eliminimin e çmimeve referente dhe ka ekzistuar marrëveshja për eliminimin e këtyre çmimeve. Megjithatë, më duhet të them se paralelja e çmimeve referente dhe e vendosjes së taksës doganore nuk është një paralele e drejtë, për shkak se nuk kemi të bëjmë me raste të njëjta.

Qeveria e Maqedonisë, në një rast tjetër e kishte bllokuar importin e miellit, jo vetëm për Kosovën, por për të gjitha vendet tjera të rajonit dhe të botës. Ky vendim ishte në kundërshtim me Marrëveshjen e CEFTA-s dhe me parimet e tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian, sepse e bllokonte miellin në aspektin sasior. Pra, nuk lejonte importin e kurrfarë sasie të miellit nga jashtë Maqedonia. E njëjta situatë dhe i njëjti vendim është marrë ditën e djeshme nga Republika e Maqedonisë.

Po ashtu, para pak kohësh, ne patëm marrë informacion se një vend evropian, Sllovenia, eksportonte në Kosovë mishin e pulës me çmim më të ulët se sa në vendin e origjinës. Në Kosovë, ashtu sikur edhe në të gjitha vendet të cilat i aplikojnë parimet e tregtisë së lirë, kjo mund ta deformonte tregun, duke shkelur ligjet, që rregullojnë tregtinë...

KRYESUESI: Ju lus, në temë, jo për rajonin, por për vendimin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: ...më saktësisht Ligjin për antidanping. Kjo përbënte një rast të dampingut, që ndikonte drejtpërdrejtë në sektorin e ekonomisë së mishit të pulës. Edhe këtu kemi reaguar duke e eliminuar procesin e dampingut për prodhuesin vendor. Të gjitha këto vendime janë në mbrojtje të prodhuesve vendorë. Të gjitha vendet e rajonit dhe vendet e BE-së e mbështetin industrinë nëpërmjet subvencioneve të ndryshme. Në Kosovë, industria ka nevojë për investime të reja, në mënyrë që të jetë e gatshme për sfidat e reja ekonomike. Për më shumë, këto vendime janë tregues se në fushën e tregtisë me jashtë, Kosova ka filluar të veprojë si shtet normal. Të gjitha vendet në Evropë i mbrojnë dhe stimulojnë prodhuesit e tyre vendorë. Të gjitha vendet normale kanë ligje për masat mbrojtëse shumë të ngjashme me ligjin tonë, të cilin e zbatojmë vazhdimisht.

Te vendet normale, mbrojtja e prodhuesve vendorë mbështetet nga të gjitha institucionet e vendit dhe me implementimin e ligjeve. Kjo është më se e vërtetë kur kemi të bëjmë me industrinë ndërtimore. Për të gjitha vendet, industria e ndërtimit është një industri strategjike, por edhe intensive sa u përket investimeve kapitale. Prandaj, shtetet jo vetëm që i mbrojnë këto industri, mirëpo edhe i subvencionojnë në fazat e ndryshme të procesit të prodhimit dhe tregtimit, me qëllim që t'u mundësohet kohë e mjaftueshme për realizimin e investimeve. Masat mbrojtëse, të ndërmarra nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, nuk janë për t'u habitur, por janë praktika të zakonshme ndërkombëtare.

Prandaj, industria është strategjike. Dilema është: A mund ta mbajmë këtë industri, apo duhet të përcaktohem që pas dy vjetësh Kosova të importojë 100% të çimentos

së saj. Ekziston edhe një frikë tjetër, se nëse ne nuk i zbatojmë ligjet tona, mesazhi për investitorët e huaj dhe për prodhuesit e tanishëm dhe të ardhshëm vendorë është që institucionet e shtetit nuk janë në mbrojtje të tyre. Ligji për masat mbrojtëse është votuar nga ky Kuvend në vitin e kaluar. Nëse ne tani kërkojmë që të mos respektohet ky ligj, mesazhi që del nga Kuvendi i Kosovës nuk është i mirë as për prodhuesit vendorë, e as për investitorët e mundshëm në Kosovë.

Investimet e paralajmëruara nga vendet mike të Kosovës mund të hamenden nëse ne nuk i zbatojmë ligjet tona, që e rregullojnë fushën e tregtisë dhe industrisë. Nëse prodhuesit vendorë nuk mund të marrin mbështetje nga shteti, por duhet të kenë kujdes nga fushatat e organizuara të grupeve të caktuara që duan të importojnë çdo gjë nga jashtë. Pse atëherë duhet të investojnë në vendin tonë? Në fund, dëshiroj të ju informoj që ministria që drejtoj është në kontakt të vazhdueshëm me Qeverinë shqiptare dhe jemi në fazat e fundit të marrjes së një vendimi që do të jetë në benefit të të dyja vendeve. Për më tepër, nëse Qeveria e Shqipërisë vendos që të marrë masa për ta mbrojtur tregun e vet nga çimentoja e lirë nga Italia, ne do t'i largojmë plotësisht masat mbrojtëse të vendosura nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Të nderuar deputetë,

Dilema e vetme sot para jush është: A është Kosova një shtet që e mbron prodhimin vendor, apo një shtet i cili i favorizon importet dhe merr vendime nën presion? Për hir të fakteve, numrave dhe procesit që unë prezantova sot para jush, shpresoj që vendimi dhe mendimi juaj do të jetë i bazuar në parime të drejta, në interesin e prodhuesit, e jo në interesat grupore, të kujtqo qofshin ato. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare, ose përfaqësuesit. Zoti Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeverisës,

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes të veçantë interpelancën e kërkuar nga grupi i deputetëve dhe konsiderohet e drejtë dhe e nevojshme për të diskutuar dhe për të sqaruar, duke i dhënë hapësirë të nevojshme Qeverisë, përkatësisht ministres që të na informojë në detaje lidhur me masat e marra sa i përket tarifës doganore prej 35% për çimenton e importuar.

Ne e kemi analizuar me kujdes këtë situatë të krijuar dhe natyrisht kemi vlerësuar se duhet të gjendet rrugëdalje dhe të zgjidhet problemi në të mirë të të gjitha palëve, duke krijuar kushte të nevojshme në të ardhmen për importuesit kosovarë. Duhet të jemi të kujdesshëm, që mbi të gjitha të ruhet interesi i përgjithshëm shtetëror dhe qytetar. Ne konsiderojmë se kryeministri i Kosovës, me fuqinë ligjore dhe kushtetuese që ka, do të jetë i gatshëm për ta shqyrtuar dhe tejkaluar këtë situatë, nëse mund të quhet “ngërç” i çimentos. Qeveria dhe ministrja Kusari duhet të jenë të

kujdesshme për vendimet e marra, të cilat duhet të jenë të balancuara ndërmjet interesit publik dhe marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare.

Ne konsiderojmë se Qeveria e Kosovës duhet ta analizojë me prioritet situatën e krijuar, e cila nuk është në favor të relaksimit të tregut, përkundrazi ka krijuar një huti tek importi kosovar. Si e tillë, duhet trajtuar dhe rishikuar. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të sigurojë se të gjitha vendimet e saj do të jenë në harmoni me Kushtetutën e vendit, marrëveshjen e CEFTA-s dhe marrëveshjet e tjera të tregtisë së lirë. Kapitulli i parë në marrëveshjen e CEFTA-s parasheh detyrime të përgjithshme të zbatueshme në tregtinë e të gjitha mallrave. Neni 2 parasheh qartë tarifën doganore bazë. Neni 5, në marrëveshjen e CEFTA-s flet qartë mbi tarifën doganore, mbi importin, duke thënë: “Asnjë tarifë e re doganore mbi importet, detyrim me efekte të njëjta dhe asnjë tarifë importi e një natyre fiskale nuk do të vendoset dhe as ato që zbatohen nuk do të rriten në tregtinë ndërmjet palëve që nga dita para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje”. Qeveria duhet që marrëdhëniet tregtare, të rregulluara nga marrëveshja e CEFTA-s dhe marrëveshjet e tjera, pjesë e së cilës jemi, t’i respektojë dhe t’i zbatojë. Duhet të respektohet deklarata e përbashkët në lidhje me zbatimin e rregullave dhe procedurave të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Tarifat doganore mbi eksportet dhe importet duhet të jenë në harmoni me marrëveshjen e CEFTA-s për tregti të lirë, të garantuar, që duhet zhvilluar ndërmjet shteteve që e kanë pranuar marrëveshjen e CEFTA-s dhe të gjendet garanci që duhet të ruhet edhe prodhimi vendor. Natyrisht, duke mos e cenuar për asnjë moment tregun e lirë dhe konkurrencën e mirëfilltë. Pra, ne jemi që të rishikohet qartë masa për taksën e çimentos dhe të garantohet prodhuesi dhe importuesi vendor, që masat nuk mund të jenë ndryshe, pos në përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjen e CEFTA-s. Pra, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon që në afatin sa më të shkurtër kohor të rishikohet kjo marrëveshje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari i grupit, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryesues!

Po nisem nga kjo që e tha në fund parafolësi, që po e mbron ekonominë e tregut, ndërsa deputetët i ka dërguar në shpi. Po shihet kjo, por ok! Do të vazhdoj ta shpreh qëndrimin e LDK-së.

Të nderuar kolegë deputetë,

Që prej pasluftës, sektori më me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit tonë mbetet ndërtimtaria. Por, kontributin e saj në zhvillimin e vendit Qeveria po e “shpërblen”, duke e ngulfatur me masat që e ngadalësojnë rritjen dhe e shtrenjtojnë koston e produkteve bazë në këtë sektor. Vendosja e kësaj tarife prej 35% në importin e çimentos, nga 12 qershori 2012, dëshmon lidhjen e ngushtë të Qeverisë dhe bizneseve të caktuara, në këtë rast me “Titan Group”, lidhje që e dëmton ekonominë e vendit dhe konsumatorin, por që i krijon profit joligjor kësaj kompanie dhe anëtarëve të presupozuar të Qeverisë.

Vendimi mbi tarifën e çimentos nuk e ka logjikën elementare ekonomike dhe paraqet abuzimin më drastik me ligjin, të bërë ndonjëherë me vendime të tilla qeveritare. Ligji mbi masat mbrojtëse në importe u aprovua që t'u shërbejë bizneseve që rrezikohen, e jo që një biznes me pozitë dominante në treg ta shndërrojë në monopol shtetëror. Në çdo shtet evropian bujqësia është sektori që mbrohet dhe përkrahet më së shumti. Në Kosovë, kërkesat e bujqve dhe të fermerëve për mbrojtjen e tyre kanë eskaluar edhe me protesta, por Qeveria nuk i zgjodhi ata për mbrojtje se, si duket, nuk patën çka t'i ofrojnë Qeverisë, pos djersës së tyre.

I kemi ende të freskëta protestat e vreshtarëve, po e zëmë të Rahovecit, dhe të prodhuesve të qumështit. Disa protestues bile edhe u burgosën, sepse kërkuan mbrojtje nga Qeveria e tyre. Qeveria nuk i zgjodhi që t'i mbrojë as prodhuesit e tullave po e zëmë, por Qeveria zgjodhi ta mbrojë prodhuesin e vetëm të çimentos, se me siguri ai i ofroi edhe diçka tjetër. Po të kishte prioritet në zhvillimin ekonomik dhe në mbrojtjen e konsumatorit, Qeveria do të duhej ta shfrytëzonte të drejtën e saj ligjore dhe të kërkonte nga autoriteti i konkurrencës mbikëqyrje të vazhdueshme të “Sharrcemit”, për shkak të mundësisë së abuzimit me treg. Në BE janë shumë të shpeshta rastet e dënimit të prodhuesve të çimentos për shkak të abuzimit me pozitën e tyre dominuese në treg dhe marrëveshjeve mbi çmimet. Por, Qeveria veproi në të kundërtën. Ajo, për interesat e “Sharrcemit” dhe të individëve i mbylli kufijtë e Kosovës, duke e lënë tregun e ndërtimit në mëshirën e “Titanit”. E se çfarë mëshire ka “Titani” për tregun e ndërtimit, vërtetohet shumë lehtë nëpërmjet çmimeve të larta, nëpërmjet kontrabandës së çimentos, nëpërmjet pritjeve me dhjetëra ora për ta marrë një kamion çimento dhe nëpërmjet ndihmave në komunitet në formë të sadakasë, siç thotë pulli.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të kthehem pak në tregun e çimentos në Kosovë. Vlerësohet se në vendin tonë harxhohen afro 1,1 milion ton çimento në vit. Sipas strategjisë minerare, “Sharrcem” ka kapacitete të instaluar të prodhojë afro 600 000 tonë çimento në vit, përkatësisht të mbulojë rreth 55% të tregut, kurse diferenca patjetër duhet të mbulohet nga importet. Deri në vitin 2009 kanë dominuar importet nga prodhuesi i vetëm i çimentos në Shkup të Maqedonisë, i cili po ashtu është në pronësi të “Titanit”, me afro 30% të tregut. Kurse pjesa tjetër është mbuluar nga prodhuesit e ndryshëm nga Serbia, ku “Titan” po ashtu e ka në pronësi një fabrikë. Kështu, me blerjen e “Sharrcemit”, “Titani” u bë zot i tregut të çimentos në Kosovë, duke mbuluar afro 90% të tregut tonë. Mirëpo, ndërtimi i autostradës së kombit e pati ndikimin e vet ekonomik edhe në tregun e ndërtimtarisë. Ne i gëzohemi rritjes së tregtisë me Shqipërinë dhe politikat tona tregtare duhet të shkojnë në drejtim të lehtësimit sa më të madh të tregtisë ndërmjet dy vendeve tona. Autostradën “Ibrahim Rugova” e konsiderojmë si faktorin kyç për integrimet ekonomike shqiptare dhe portën e bizneseve tona për në tregjet e Bashkimit Evropian.

Ndër produktet shqiptare që pati ekspansion të madh në Kosovë ishte edhe çimentoja, falë çmimit të saj konkurrues dhe që e prishi dominimin total të “Titanit” në Kosovë.

Por, nëse shikohet më thellë, është pikërisht “Titani” ai që e nxiti eksportin e çimentos së Fushë-Krujës në Kosovë. Ambiciet e “Titanit” për dominim total në rajon janë të pashmëtytura. “Titanit” nuk i mjaftoi monopoli në Maqedoni dhe monopoli në Kosovë, por në vitin 2010 e ndërtoi edhe një çimentore të madhe në Fushë-Krujë, të njohur si “Antea Cement”, duke e rrezikuar seriozisht prodhuesin e mëparshëm të Fushë-Krujës “Siment”, që ishte dhe është libanez. Prandaj, rritja e shitjeve të çimentos në Kosovë vjen si pasojë logjike ekonomike e humbjes së tregut vendor për shkak të “Titanit”. Në luftën e konkurrencës çdoherë fitojnë konsumatorët me cilësi më të mirë dhe çmime më të lira, prandaj edhe qeveritë e shteteve e përkrahin zhvillimin e konkurrencës.

Fatkeqësisht, në këtë luftë të konkurrencës u përfshi edhe ministrja e Tregtisë, duke dalë publikisht në mbrojtje të “Titanit” dhe duke abuzuar skajshmërisht me ligjin, ajo e vendosi tarifën prej 35% në të gjitha importet e çimentos, me pretekst të mbrojtjes së prodhimit vendor. Me këtë akt, ministrja e Tregtisë publikisht ua bëri me dije të gjithë prodhuesve tjerë të çimentos në rajon se “Titani” e zotëron tregun e çimentos në Kosovë dhe kushdo që është i interesuar për tregun kosovar duhet të kërkojë leje nga “Titani”. Nëse deri më tash e kemi përdorur shprehjen se çdo ministër e ka një biznes, tash e tutje do të themi se bizneset e caktuara, në këtë rast “Titani”, e kanë së paku nga një ministër, apo një pjesë të Qeverisë së Kosovës, kuptohet.

Vendimi mbi masën mbrojtëse me 35% tarifë në importin e çimentos nuk e mbron prodhuesin vendor, sepse ai nuk ka kapacitet ta mbrojë tregun, por demanton, ose më mirë të thuhet, në një mënyrë të rëndë e dëmton konkurrencën e lirë, tregun e çimentos, tërë sektorin e ndërtimtarisë dhe direkt konsumatorin, duke paguar çimento më të shtrenjtë. Qëllimi i “Titanit” nuk është mbrojtja e “Sharrcemit”, por rritja e fitimit të tij, së pari duke i rritur çmimet dhe pastaj duke e ndaluar tërë importin nga jashtë. “Sharrcem” sivjet i ngriti çmimet dy herë, më 23 shkurt 2012 për 5%, dhe më 9 prill, përkatësisht vetëm dhjetë ditë para parashtrimit të kërkesës në MTI për 11,5%, apo në shprehje absolute për afro 12 euro për ton, e që për sasinë e shitur normale prej 500 000 tonë në vit, fitimi ekstra është afro 6 000 000 euro. Por, kjo për “Titanin” nuk mjaftoi. Kështu, “Titani” e gjeti ministren që ta bllokojë importin e çimentos, por ta lejojë importin e “klinkerit” nga fabrika e tyre në Shkup.

Ministrja dhe “Titani”, “klinkerin” që është çimento e pastër, u munduan të na e deklarojnë si lëndë të parë, por të gjithë në Han të Elezit e dinë se lëndë e parë e çimentos është “llapori” apo “mërgelja”, që nxirret në miniera përballë “Sharrcemit” dhe e cila i nënshtrohet një procesi të gjatë teknologjik për t’u prodhuar “klinkeri”. Por, se sa i pashmëtytur, i paqëndrueshëm dhe jologjik është në biznes “Titani” dëshmon edhe fakti i kontrabandimit të çimentos si “klinker” i bluar, sepse ata e dinë se nuk kanë kapacitete edhe për bluarje që ta mbulojnë tregun tonë. Në këtë rast, duhet të shprehim mirënjohje për Doganat e Kosovës, të cilat e zunë në flagrancë këtë kontrabandë të sofistikuar. Përveç kësaj, “Titani”, duke qenë në lidhje me ministren e Tregtisë, në pritje të vendimit të saj, gjatë muajit maj mbushi me çimento nga Maqedonia, jo vetëm silosët, por edhe oborrin në qendrën e vet distribuese në Lipjan.

Deputetë të nderuar,

Ministrja e Tregtisë, në nguti të sjelljes së vendimit për interesa të caktuara, nuk i përfilli as procedurat elementare që i përcakton ligji. Ia përkujtojmë ministres së nenin 19.3 i Ligjit mbi masat mbrojtëse në importe e përcakton në mënyrë decitive se vendimi për zbatimin e masave të përkohshme, mbrojtëse, nuk do të miratohet para inicimit të hetimit. Ministrja e Tregtisë e ka sjellë vendimin duke e shkelur nenin 9.1, i cili kërkon që kur ministria vendos ta fillojë një hetim duhet formalisht dhe drejtpërdrejt t'i njoftojë me shkrim të gjitha palët e interesuara, dhe nenin 9.2, që kërkon shpalljen publike të hetimit. I gjithë opinionioni është dëshmitar i këtyre shkeljeve. Askush nga palët e interesuara nuk është njoftuar formalisht për iniciimin e hetimit dhe as që është bërë shpallja publike e tij. Këto dy shkelje themelore e bëjnë të pavlefshëm dhe joligjor edhe vendimin e marrë me nguti mbi tarifën mbrojtëse.

Me siguri në presion nga “Titani”, ministrja e Tregtisë e merr vendimin me nguti. Është dashur ta plotësojë pas dy ditësh, pasi edhe Doganat e Kosovës nuk kanë mundur ta zbatojnë. Po t'i hidhni një sy arsyesimit për vendosjen e tarifës në çimento, të përgatitur nga Departamenti i Tregtisë, në kuadër të MTI-së, do ta shihni shumë qartë se deri ku shkon anomalia e këtij vendimi.

Aty shihet se kërkesa e “Sharrcemit” është mbajtur për afro një muaj pa u protokolluar fare. Me siguri, duke bërë pazare paraprake. Aty shihet se vasalët e ministres nuk i dinë as emrat e prodhuesve të çimentos, e të mos flasim për tregun. Aty nuk ka asnjë shenjë, përkatësisht shënim mbi koston e prodhimit të çimentos në Kosovë dhe në rajon. Aty nuk ka asnjë shënim mbi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe dy minuta dhe përfundoje!

ISMET BEQIRI: ...fitimet enorme të “Sharrcemit”. Aty nuk ka asnjë element që dëshmon për përpjekjet e “Sharrcemit” për të konkurruar me çimenton e importuar. Aty thuhet se “Sharrcemi” duhet të përkrahet, sepse do të investojë 35 000 000 euro që i ka obligim nga kontrata e privatizimit, por që nuk përmenden edhe 22 000 000 euro që janë i pranuar “Titanit” nga AKP-ja si investime gjatë komercializimit.

Aty nuk gjendet dëshmia se numri i punëtorëve në “Sharrcem”, ose të “Sharrcemit” tani është për 200 veta më i vogël se në vitin 2000, por duhet të përkrahet dhe të ceket se “Titani” paska dhënë 270 000 euro për komunitetin, kurse ministrja me vendim mbi vendosjen e tarifës ia mundësoi që konsumatori kosovar t'ia paguajë 30-fish këtë “sadak” për popull, që e paska bërë. Këto janë fakte të pamohueshme, të cilat dëshmojnë se vendimi mbi masën tarifore paraqet shkelje të rëndë të ligjit dhe dëmtim të ekonomisë sonë me elemente të shumta të krimit ekonomik. U tha se “Sharrcemi” është tatimpaguesi më i madh. Po, shumë normale që është edhe do të jetë tash edhe më i madh, sepse i ka eliminuar të tjerët.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon që ky Kuvend të vendosë që të shfuqizohet ky vendim i paligjshëm i ministres së Tregtisë dhe Industrisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Që Shqipëria po mbetet pothuaj vendi i vetëm në botë karshi të cilit ne po përpiqemi të sillemi si shtet, e tregon edhe vendimi për caktimin e masës së përkohshme mbrojtëse për importin e çimentos.

U tha që kjo masë nuk është për mbrojtjen e çimentos së importuar nga Shqipëria, por dihet shumë qartë që në përqindje, Serbia në raport me Shqipërinë është pothuajse e papërfillshme, dhe tjetra, kur i trajton në mënyrë të barabartë Shqipërinë dhe Serbinë, vetë ky trajtim përfundon duke e shkelur Shqipërinë. Pra, përveç faktit që për herë të parë po vendoset një masë e tillë dhe kjo masë po vendoset pikërisht ndaj Shqipërisë, tregon që vetëm ky shtet, pra Shqipëria, i ka mbetur vendi ku ajo do të dëshmohej. Ne jemi për masat mbrojtëse, ne jemi që të vendosen këto masa dhe ne jemi që Kosova të jetë shtet, i cili i mbron prodhimet e veta vendore. Kjo do të ishte politika, të cilën do ta zhvillonte shtetin e Kosovës. Por, ne nuk po e shohim në një gjë të tillë aty ku nevojitet. Ne nuk po e shohim atë në fushën e bujqësisë, ku importi i produkteve të subvencionuara nga shtetet rreth e përqark, që na e kanë vërshuar tregun tonë, e bënë të pamundur zhvillimin e bujqësisë te ne, e bënë të paleverdishëm punimin e tokës, e bënë të paleverdishëm prodhimin e qumështit, e bënë të pamundshëm hapjen e vendeve të reja të punës në bujqësi, e bënë të pamundshëm qëndrimin e popullatës në zonat rurale dhe rrjedhimisht e krijojnë një zinxhir të tërë dëmsh në shtetin e Kosovës.

Të mos harrojmë se edhe importi i vezëve nga Greqia, që u përmend, është import i cili e ka dëmtuar jashtëzakonisht rëndë prodhuesin vendor, respektivisht fermat e vezëve. Kur flasim tash për “Sharrcemit”, nuk mund të jemi indiferentë as ndaj pronarit të tij. Pra, të mos harrojmë që pronarë të “Sharrcemit” janë grekë dhe janë të një shteti, i cili nuk e njeh Kosovën. Dhe, në këtë aspekt, nuk mund ta shohim vetëm interesin e ngushtë të Kosovës, por duhet ta kemi një pikëvështrim pak më të gjerë, se Kosova, në fund të fundit, duhet të jetë një shtet, i cili vendoset në shërbim të interesit të kombit. Dhe, në këtë aspekt, ne nuk mund të rrimë indiferentë as ndaj një vendi, i cili, në fakt, ndaj shqiptarëve është sjellë dhe vazhdon të sillet si një shtet fashist. Është një shtet, i cili ende e ka Ligjin e luftës me Shqipërinë dhe është një shtet, i cili i trajton emigrantët shqiptarë po ashtu njëjtë sikur shtetet fashiste kudo në botë.

Prandaj, nuk mund të rrimë indiferentë as ndaj këtyre gjërave, sepse, në fund të fundit, edhe po të mos ishim shqiptarë, nuk mund të jemi thjesht indiferentë ndaj shteteve të tilla. Por, të gjitha këto do të mund të bënin që krejt këto deklaratime tash të konsiderohen subjektive, ndërsa pyetjet do të jenë më shumë të natyrës më konkrete. Përpos bazës ligjore, na intereson cili është kriteri bazë mbi të cilin është vendosur kjo masë? Ta zëmë, nëse puna e “Sharrcemit” dhe aktiviteti i prodhimit të çimentos do të ishte një aktivitet ekonomik strategjik, a ka ndonjë analizë që do të mund ta

konsideronim se prodhimi i çimentos qenka me rëndësi kruciale për Kosovën në aspektin strategjik dhe duhet patjetër të ndërmerret një veprim i tillë.

A janë marrë në konsiderim politikat e jashtme të Kosovës? A merren në përgjithësi në konsiderim efektet politike, apo çka do tjetër?

Te neni 16 i Ligjit për masat antidamping edhe masat kundër-balancuese thuhet se duhet të krijohet një komision vlerësues, i cili duhet ta ketë nga një përfaqësues nga të gjitha institucionet publike. A është themeluar një komision i tillë dhe cili ka qenë vlerësimi karshi kërkesës së “Sharrcemit”? Pse bash 35%? A nuk është kjo një masë tejte e lartë? Pse po lejohet tash “Sharrcemi” të importojë “klinker”? A nuk po i bie kjo që ne po e bllokojmë importin nga Shqipëria, në mënyrë që “Sharrcemi” t’i lejohet të importojë prodhime dhe ato pastaj të na i paketojë e t’i shesë ato, që realisht i bie import. Dhe, tjetra është se tash e dy vjet është duke u diskutuar krijimi i komisioneve të përbashkëta ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë në nivel të shërbyesve civilë dhe ekspertëve për intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik, arsimor, politik etj.

Dhe, pse kjo masë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë vjen pikërisht pak ditë para finalizimit të diskutimit të krijimit të këtyre komisioneve? Pastaj, përse një vendim të jetë aq i ngutshëm, pa asnjë paralajmërim, kur ne e dimë që importuesit mund të kenë pasur marrëveshje të nënshkuara, të cilat mund të kenë pasur edhe afate. Masa e tillë e ngutshme patjetër që do t’ua shkatërrojë atyre edhe mundësitë për të ardhmen që ta vazhdojnë veprimtarinë e tillë. Pra, kjo, përpos në përfundimin e kësaj mase, le të mendohet që është synuar edhe goditja e infrastrukturës për import nga Shqipëria, në këtë rast. Në përgjithësi, ky vendim i Qeverisë mbetet i dyshimtë për nga motivi, njëjtë sikur edhe politika e saj, politikë kjo e cila Kosovën po e çon drejt një vendi të brishtë, sikur që është çimentoja pa armaturë.

KRYESUESI: Faleminderit! Donika Kadaç-Bujupi, e ka fjalën, në emër të AAK-së.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Të nderuar të pranishëm,

Të thuhet se shteti po e mbron një kompani në emër të prodhimit vendor dhe të thuhet se ne si shtet po e mbrojmë një kompani, e cila para një jave zihet duke e vjedhur të njëjtin shtet, kjo flet për faktin ose atë fjalën e urtë që në këtë moment po më kujtohet prej mëngjesit derisa po e dëgjoj ministren që “marrja s’po e mbytka njeriun”, përndryshe ne sot do të ishim në ndonjë funeral në vend të kësaj seance.

Të thuhet që me pasion do të vazhdoj ta mbroj një vendim, i cili sot ka bërë që njerëzit të presin para një kompanie 5 deri në 7 ditë për të marrë çimento, është përsëri marre. Unë para jush do t’i prezantoj disa fakte që janë në kundërshtim me këto që u dhanë nga ministrja dhe që flasin se në rastin “Sharrcem” kemi pasur të bëjmë me të pavërteta të mëdha, të cilat janë plasuar në opinion.

Kohëve të fundit është thënë e stërthënë mjaft shumë për një çështje mjaft të ndjeshme, që falë maturisë së shtetit shqiptar nuk e arriti kulminacionin e një konflikti

ekonomik, tregtar e politik. Vendimi i ndërmarrë lidhur me masat mbrojtëse në import ndaj çimentos shqiptare ishte i paarsyeshëm, në rend të parë në aspektin ekonomik e tregtar. I paarsyeshëm profesionalisht, i paarsyeshëm në aspektin shtetëror. Ishte absolutisht i paarsyeshëm në çdo aspekt. Se ka pasur të pavërteta shumë të mëdha në lidhje me këtë rast flasin të vërtetat, të cilat unë do t'i prezantoj para jush.

E vërteta në këtë proces irracional dhe tejet të dëmshëm, i cili do të kërkojë edhe përgjegjësi për vendimin e marrë, qëndron në atë kur thuhet se “Sharrcem” ka aplikuar për vendosje të masave mbrojtëse në importin e çimentos. E vërtetë është se “Sharrcemi” ka bërë presion thuajse se është vetë shteti në Ministrinë e Tregtisë, që të merret vendimi sa më shpejt, dhe e vërtetë është që vendimi u mor tepër shpejt. Tani na tregoni si dhe kujt ua ka zënë bishtin “Sharrcemi”, që nuk po guxon ta tërhiqni këtë vendim kaq të shpejtë?

E vërtetë tjetër është që detyrimin doganor prej 35% e ka caktuar vetë “Sharrcemi”, prapë në cilësinë e vetë shtetit. Dhe, është e pavërtetë që të njëjtën e ka caktuar ministria, pas një analize profesionale. Shkoni, të nderuar deputetë, dhe pyetni ekspertët e MTI-së se me çfarë metode të përlogaritjes kanë ardhur deri te kjo përqindje. Ata as që kanë ide, asnjëri prej tyre. “Urdhri është urdhër”, thotë një fjalë. Ky urdhër ka ardhur nga Bernard Nikaj, i cili është shef i Kabinetit të zonjës Kusari dhe i ka kërkuar ultimatum Departamentit të Tregtisë, apo ekspertëve të Departamentit që sa më shpejt ta sjellin vendimin për masat mbrojtëse për çimenton ndaj Shqipërisë. Ka apo nuk ka bazë ligjore, kjo s’ka pasur rëndësi. Sepse, interesi ka qëndruar mbi forcën e ligjit në këtë rast.

Ky është një veprim kundërligjor dhe në kundërshtim me nenin 23 të Rregullores nr. 2/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive. Ky është vendim i pastër politik. E pavërtetë absolute është se qenka kryer ndonjë analizë e thellë profesionale, siç është: rëndësia, ndërlikueshmëria, ndjeshmëria, pesha dhe natyra e rastit. Nuk janë kryer as analizat elementare. Pra, është e vërtetë që vendimi i marrë ishte vendim ad hoc, pa i vlerësuar interesat dhe pasojat eventuale për palët e interesit, apo më mirë - është matur dhe kalkuluar financiarisht vetëm profiti i “Sharrcemit” dhe rrjedhimisht i dikujt tjetër që është ulur këtu.

E pavërtetë e madhe është kur opinionin gënjehet dhe mashtrohet në mënyrën më brutale gjoja se paraprakisht janë konsultuar palët e interesit, sidomos prodhuesi nga Fushë-Kruja. Mirë është të pyetet direkt prodhuesi i Fushë-Krujës, a e ka konsultuar ndonjëherë dikush dhe kur? Ndërsa parakusht themelor para vendosjes së masave mbrojtëse për një vendim të tillë është konsultimi paraprak dhe i domosdoshëm me palët e interesit, qoftë sipas standardeve kosovare, neni 9 i Ligjit nr. 4/47 mbi masat mbrojtëse në import, qoftë sipas standardeve ndërkombëtare. Ndërsa, kjo nuk ka ndodhur në asnjë moment, prandaj është thyerje brutale e ligjeve.

E vërtetë tjetër është që opinioni po mashtrohet nga ministrja gjoja se masa mbrojtëse vlen për të gjitha shtetet, sepse praktikisht në terren po atakohet dhe dëmtohet seriozisht vetëm e vetëm prodhuesi shqiptar, duke i ditur specifikat e këtij importi. Apriori, kjo është ditur dhe kalkuluar. Pra, ky është sulm me qëllim që po i drejtohet prodhuesit shqiptar.

E vërtetë tjetër është që “Sharrcemi” vepron si kompani multinacionale me prodhim dhe distribuim në më tepër se 12 shtete botërore. Ky fakt tregon potencialisht edhe gërshetimin e interesave të grupeve të caktuara politike. Është një kompani e fortë në aspektin operativ dhe financiar dhe tani me monopol prodhimi dhe shitjeje në Kosovë. Tani po e njëjta kompani superiore në treg, përpos që është paraparë të mbështetet me pakon fiskale, ku një lëndë e parë për prodhimet parashihet të lirohet nga taksa doganore, paska nevojë, sipas ministres, edhe për proteksionizëm. Kjo është në kundërshtim me shtojcën 8 të Rregullores numër 2/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive.

Ministrja ka vënë proteksionizëm kundrejt prodhuesit shqiptar, kundrejt shtetit shqiptar, kundrejt importuesve dhe prodhuesve kosovarë, kundrejt transportuesve kosovarë. Prapë është një non sens flagrant dhe prapë dikush del e thotë “unë po i mbroj prodhimet vendore”! Dhe prapë ngrihet dyshimi për përfitime dhe interesa financiare në këtë, ta quaj “marifetllëk”. Non sensi pra filloi të ndikojë në sensin personal dhe grupor.

E vërtetë tjetër është që pjesëmarrja e “Sharrcemit” në strukturën e tregut në Kosovë, nga viti 2009 deri në vitin 2011, ka rënë nga 58%, në 47%. Pra, vetëm 11%, e jo siç po mashtrohet opinioni nga MTI-ja se ka rënë në 32%, duke manipuluar me shifra matematikore. Ndërsa, Fushë-Kruja në tregun e Kosovës ka pjesëmarrje vetëm prej 18%. “Sharrcemi”, edhe nëse synon ta mbulojë tërë tregun kosovar, de fakto nuk ka kapacitete vijuese të prodhimit, as kapacitete teorike instaluese, që do ta siguronin këtë pjesëmarrje. E gjithë kjo po shihet që e ka një prapavijë dhe e ka një emër. E këtë emër ia dimë gjithë.

Çfarë të thuhet për çrregullimin e tregut në Kosovë? Pse kjo përkrahje deri në shkallën e monopolit ekstrem?! Ku mbetet arsyeja e ngritjes disa herë të çmimeve të “Sharrcemit” tri herë këtë vit? Si të argumentohen dhe mbulohen zotimet dhe humbjet financiare të kontraktuesve kosovarë? Si t’u bëhet halli ndërtimtarëve të Kosovës dhe punëmarrësve të tyre, të cilët veç kanë kontraktuar çimento gjatë këtij viti në Shqipëri? Çfarë arsyetimi ka për konsumatorin kosovar, edhe ashtu të dërmuar në aspektin social? Ju i keni rrezikuar 1 500 deri në 2 000 punëtorë, ndërkaq thoni 38 punëtorë. Ky është turp! Rrezikohen 150 deri 200 kompani kosovare, shkaktohen humbje ditore prej 200 000 euro dhe para dy javësh, kur kam kërkuar këtu që kjo masë të ndërpritet, kam thënë se nuk po e ndërpritni, sepse po përfitoni. Keni përqindje ditore, prandaj po insistoni me pasion që ky vendim të zgjasë sa më.

Kënaqësia që ofronte Rruga e Kombit në dinamikën e lëvizjes së njerëzve dhe të mallrave shqiptare dhe për të cilën ju folët aq shumë me pasion si Qeveri, ra dhe u tret

në ujë. Kot së koti, Qeveria e Shqipërisë mundohet që të veprojë pozitivisht, kur në Kosovë kemi njerëz si ju, negativë dhe përçarës.

Pra, e vërteta e plasuar në publik se vendimi i marrë është në pajtim me Ligjin mbi masat mbrojtëse në import dhe me standardet ndërkombëtare, është e pavërteta më e madhe. Në mënyrë absolute, kjo është në kundërshtim me ligjin. A ka nevojë, të nderuar deputetë, t'i shtohet më tepër prononcimit të Bashkimit Evropian lidhur me vendimin, deklarimeve të Komisionit për Konkurrencë, vendimeve të Doganave të Kosovës për kontrabandë nga "Sharrceci"? A ka nevojë më shumë të flitet për kompaninë, e cila bën vepër penale nën masa mbrojtëse, të vazhdojë të mbrohet nga shteti?

E vërteta më e madhe në këtë proces që i ka trazuar me arsye edhe shpirtrat, por edhe mendjet, edhe të bizneseve, edhe të deputetëve, edhe të dy qeverive, asaj të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, i ka kërcënuar marrëdhëniet ndërshtetërore të nivelit më të lartë. Duhet të kemi përgjegjësi institucionale. Duhet të jepet përgjegjësi individuale dhe morale nëse ka mbetur pak moral në këtë vend. Dhe, janë instrumentet demokratike për këtë. Ky është vendimi më i dëmshëm ekonomiko-politik dhe më kundërligjor në Kosovë që nga paslufta.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se janë dy alternativa: e para është të shfuqizohet vendimi nga ministrja dhe të ofrohet dorëheqja e ministres menjëherë dhe, alternativa e dytë, të shfuqizohet vendimi nga kryeministri dhe të shkarkohet ministrja menjëherë. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë jo vetëm sot, por edhe gjeneratat e reja do të vazhdojnë të jetojnë dhe të veprojnë në agoninë e një shteti anormal, të cilin e keni bërë anormal me këto veprime, e që quhet Kosovë. Kjo nuk është as pavarësia e ëndërruar, të dashur deputetë, kjo nuk ka të bëjë me demokracinë që e kemi mësuar. Kjo sjellje reflekton mungesën e sundimit të ligjit aq shumë të dëshiruar për ne. Kjo papërgjegjësi nuk është rrugë për askund, as për në Evropë. Ky është një non sens. Ky veprim e ky vendim dhe kjo sjellje kusare tregon bizaritetin e kësaj Qeverie kusare!

Unë do t'i bëj pyetje ministres: Nëse vendimi apo përgjigjja për "Sharrcecin" në kërkesën e tij për taksë në 35% ka qenë pozitive, tha që diku në maj e ka marrë këtë kërkesë, vitin e kaluar ke marrë me qindra kërkesa nga Krusha, nga Rahoveci, dhe nga vendet e tjera nëpër Kosovë, të cilët kanë kërkuar që të vihen masa mbrojtëse gjatë sezonit, si për shembull: për qumështin, për vezët, për patatet, për rrushin. Pse asnjëherë në asnjë moment nuk keni vënë masa mbrojtëse për këto prodhime vendore të bujkut të Kosovës, por keni vendosur të vendosni masa mbrojtëse për çimenton e "Titanit", i cili po kontrabandohet nën hundën e të gjithë neve, dhe për të cilin ju po vazhdoni me pasion të thoni se do ta mbron.

Ju bëftë mirë, por ky është turpi më i madh që ka ndodhur në këtë Qeveri. Nuk është i vetmi, por prej pasluftës e deri më sot ky është vendimi më absurd dhe më i turpshëm, prej të cilit të gjithëve na vjen keq. Në fund të fundit, nuk e di as unë, e as kolegët e mi, se si do të shkojmë sivjet në Shqipëri për pushime, si do t'i shohim në sy ata të

cilët në vitin '99 i kanë hapur dyert e shtëpive të tyre, i kanë hapur zemrat e tyre. Shokët e "Titanit" na kanë vënë taksa gjithkund!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe për deputetët,

Duke e marrë parasysh thirrjen e interpelancës në këtë seancë nga një grup i deputetëve për çështjen e vendimit të MTI-së për masat mbrojtëse të çimentos dhe duke parë prezantimin e ministres, e cila e ka marrë vendimin në bazë të analizave dhe vlerësimeve brenda MTI-së, Koalicioni për Kosovë të Re, në bazë të nenit 44, paragrafi 4, pika "d" të Rregullores së Punës së Kuvendit i rekomandon ministrisë, e është fatbardhësi që ministrja është këtu, edhe ministri i Ekonomisë, apo ministri i Financave, që ky vendim të rishikohet nga kryeministri dhe Kabineti qeveritar në një afat shumë të shkurtër me një vendim më afatgjatë në mbrojtje të qytetarëve të Kosovës.

Nën dy, në Republikën e Kosovës, Qeveria dhe Kuvendi ta sigurojnë një mjedis të favorshëm për investitorin vendor dhe të huaj, në bazë të Kushtetutës, e cila siguron një treg të lirë ekonomik dhe në interes të zhvillimit të sektorit të ndërtimit dhe zhvillimit ekonomik.

Nën tre, insistoј që në Republikën e Kosovës ta promovojmë një treg të lirë dhe konkurrues, të barabartë për të gjitha vendet e rajonit, për të gjithë prodhuesit, eksportuesit dhe importuesit në bazë të ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës.

Nën katër, mallrat e prodhuara në Kosovë duhet të plasohen në të gjitha vendet dhe të mbrohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të ligjeve.

Nën pesë, Qeveria të sigurojë me ligjet e veta që investuesi dhe produktet në treg të kenë konkurrencë të lirë, për arsye se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në marrëveshjen e CEFTA-s definohet mjaft mirë që ne jemi për një ekonomi të lirë të tregut dhe konkurrencë edhe për investitorët vendorë dhe ata të huaj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, kolegë,

Të nderuar deputetë,

Dihet mirëfilli se kapacitetet e "Sharrcemit" janë diku rreth 40-50%, të themi. Nga vjen apo nga furnizohet tregu kosovar në sasinë prej 40 deri në 50%, nevoja të cilat prodhuesi vendor "Sharrcem" nuk mund t'i plotësojë?

Si e keni menduar me këtë masë mbrojtëse që i keni vënë “Sharrcemit” në raport me tregun, ndërtuesin dhe konsumatorin? Apo, mos mendoni ju që kjo çimento është për ata që bëjnë biznes? Jo, zonja ministre. Kjo çimento është edhe për qytetarin e thjeshtë, i cili ka nevojë ta ndërtojë një strehë, por, në fund të fundit, nëse është vetëm për biznes, ju në njërën anë proklamoni se po bëni lehtësira për biznes, e me këtë masë po e demantoni veten. Pse e them këtë? Sepse, zonja ministre, me sa kam marrë vesh, ky çmim i çimentos së “Sharrcemit” nuk është real dhe është shumë i fryrë në raport me çmimet e prodhuesve, për shembull të prodhuesit nga Shqipëria. Prandaj, këtë që ju ia keni mundësuar “Sharrcemit” është kryekëput monopol dhe dihet mirë se çka ndodh kur shteti i krijon dikujt monopol.

Keni marrë vendim në mënyrë arbitrare, pa u konsultuar as me palët e interesit. Po përkrahet një biznes, i cili kontrabandon mall. Nëse vendimi është marrë për ta mbrojtur prodhuesin vendor, ne të përgëzojmë, sepse, siç e dini, neto importi ose deficitit tregtar për vitin 2011 është 2,2 miliardë euro, që është një rritje prej 17,5%, në krahasim me vitin paraprak. Pyetja është: Pse nuk mbrohet bujqësia? Sa produkte bujqësore mund t’i prodhojë Kosova, por i blen, sepse nuk ka kushte ekonomike. Do të thotë, e imponojnë kushtet ekonomike. Zonja ministre, iniciativa për t’u thirrur në interpelancë vjen nga deputeti i partisë suaj, andaj sikur e keni humbur besimin edhe te partia, së cilës i jeni pas bashkangjitur. Madje, edhe te deputetët e koalicionit, të cilët sot nuk janë të pranishëm për ta mbrojtur vendimin tuaj. Andaj, kërkoj që ky vendim të anulohet menjëherë, apo të shfuqizohet, ndërsa kjo që e keni bërë le të mbetet në ndërgjegjen tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë personalisht vazhdoj të çuditem nga një vullnet i madh i shpërfaqur këtyre ditëve për t’i acaruar raportet me shtetin shqiptar.

Ky vullnet mban vulën e ministres së Tregtisë dhe Industrisë, e cila në mënyrë të vazhdueshme mezi pret t’i përgjigjet me masa agresive, që ajo i quan reciproke, çdo problemi që lidhet me masat doganore. Mirëpo, ajo nuk është e vetme. Është e qartë se për këtë aksion anti-Shqipëri e ka mbështetjen e parezervë të shefit të saj që e udhëheq Qeverinë, ndryshe do të kishim dëgjuar ndonjë reagim të këtij të fundit. Është tepër interesante se fjalën “reciprocitet”, kërcënimet për ankesa në CEFTA, i kemi dëgjuar vetëm në raport me Shqipërinë, e kur vjen puna për Serbinë, e cila e dhunon tregun e Kosovës edhe në aspektin ligjor, por mbi të gjitha me kontrabandë, ajo hesht!

A ka dërguar ndonjë ankesë në CEFTA për këtë pikë? Unë besoj dhe së paku deri para pak kohësh kam informacion nga vetë CEFTA se kjo nuk ka ndodhur. E pra, urime zonja ministre për kontributin tuaj për t’i prishur raportet Kosovë-Shqipëri! Na bëtë horë para gjithë botës, siç thuhet këtu në Kosovë dhe, mbi të gjitha, ua bëtë shumë qejfin armiqve të Shqipërisë dhe Kosovës, që për fat të keq janë të shumtë.

Është interesant fakti, sepse kur qeveritarët kanë rënie të reputacionit brenda në Kosovë, shkojnë në takime në Shqipëri te kryeministri për ta ndrequr biografinë. E vërteta është se ka një hatërmbetje, për të mos thënë ndonjë problem ndërmjet dy vendeve. Por, nga informata që kam unë bëhet fjalë për inate dhe interesa personale. Asgjë që ka të bëjë me shtetin dhe parimet shtetërore. Kthehemi në temë. Vendimi i ministres Kusari për ta vendosur një taksë doganore prej 35% për çimenton e importuar është e qartë si drita e diellit se bëhet vetëm e vetëm për ta favorizuar një kompani, që është kompania “Sharrcem”. Është punë parash kjo, punë përfitimesh. Se kush po përfiton, zonja Kusari apo e gjithë Qeveria, kjo do të duhej të ishte pjesë e një hetimi parlamentar dhe ndoshta edhe e organeve kompetente të drejtësisë.

Për faktin se me një arrogancë të paparë, e cila i ka shpërfillur procedurat ligjore, flet për një interes të madh personal në këtë mes. Fakti që ministrja dhe vetë Qeveria u kujtuan të marrin masa mbrojtëse për tregun e Kosovës, për prodhuesit vendorë pas dhjetë vjetësh, kur tregu i Kosovës është i mbushur më shumë se 90% me importime nga vendet e tjera, të cilat ia kanë zënë frymën çdo prodhuesi vendor, ngreh pikëpyetje të mëdha: Si u bë që fermerët në Kosovë për shkak të mungesës së masave mbrojtëse të shtetit nuk kanë leverdi të prodhojnë domate, specat, patate, verë etj? Kjo, sepse tregu i Kosovës bombardohet nga jashtë. Të gjitha këto prodhime vijnë nga jashtë, e gjithë industria e lehtë ushqimore, që do të mund të ishte një nga mënyrat se si do të zhvillohej ekonomia e varfër e Kosovës, importohet. Dhe pyetja legjitime është: Përse asnjëherë nuk u mor asnjë masë mbrojtëse për këto produkte?

Fermerët dhe prodhuesit e tjerë në Kosovë i hedhin në lumë produktet e tyre ose i kalbin nëpër qilarë, sepse importi i ka nxjerrë jashtë loje. Dhe, çfarë ka bërë ministrja e Tregtisë në këtë rast? Asgjë! Atëherë, pse ky nxitim për ta mbrojtur “Sharrcem”?! Apo, sepse një ditë fitimi i kësaj ndërmarrjeje është 200 000 euro dhe sepse kjo kompani brenda muajit fiton miliona. Duke pasur parasysh se kjo ndërmarrje është privatizuar me shumë dallavere, është e pritshme që edhe veprimtaria pasuese të jetë me dallavere.

Kemi ardhur në një fazë kur shteti po kapet nga kompanitë e mëdha. A ju kujton gjë shteti mafioz? Ministria ka deklaruar përpara Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik se këtë vendim e ka marrë pasi këtë ia ka kërkuar Greqia, në mënyrë që ta mbështesë në BERZH. A ka mundësi të na shpjegohet neve si deputetë se pse paska qenë kaq e rëndësishme kjo kërkesë? Aq sa ju t’i prishini raportet me Shqipërinë. Sa para përfiton Kosova nga ky veprim? A paska mbetur Kosova në dorë të Greqisë?

Unë po ju them se ju po e instaloni një praktikë shumë negative, atë të shtetit të shantazhuar. Mbështetja nga vendet e tjera nuk mund të vijë nëpërmjet shantazhimit apo kushtëzimit të shtetit të Kosovës. Ndër të tjera, ky është një dështim i diplomacisë së Kosovës, në rast se kemi ardhur në këtë fazë.

Prandaj, kërkoj që ministria ta bëjë transparencën e plotë të motiveve të vendimit të saj, të na tregojë këtu përfitimet e shtetit të Kosovës për shkak të këtij vendimi të

marrë, si dhe përfitimet e konsumatorëve, si pasojë. E nëse shteti nuk ka përfituar, është mirë t'ia tregojë drejtësisë përfitimet personale.

Me gjithë këto që thashë, megjithatë më duhet t'ia njoh një meritë zonjës Kusari, e ajo është që pikërisht forca e saj bëri që deputetët e Partisë Demokratike t'i nxjerrë jashtë Parlamentit. Duket se është shumë e fortë, sepse kur ishte puna për ta votuar Ligjin për Prizrenin, për shembull, deputetët e Partisë Demokratike nuk patën guxim të dalin jashtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë që keni mbetur këtu!

Ju faleminderit që, megjithatë, po e mundësoni një debat sado kudo, derisa nuk e ka humbur çdo sens.

Unë dëshiroj të flas diçka për argumentimet. Dëshiroj të flas diçka për letrën e "Titanit" që na ka ardhur sot dhe të kontribuoj në këtë debat, që mendoj se është i dobishëm. Është i dobishëm, sepse në shoqërinë tonë kemi nevojë t'i diskutojmë politikat industriale. Asnjëherë, as ky Parlament, por as Qeveria e Kosovës, deri më sot, nuk kanë dhënë argumente mbi politikat industriale. Kosova ka pësuar një dezindustrializim të thellë, prandaj i nevojiten politikat industriale. I nevojiten politikat industriale, që me politika aktive ta ndërtojë një industri konkurrense, e cila do të jetë e aftë të konkurrojë në tregun vendor dhe në atë të jashtëm.

Prandaj, politikat aktive industriale nënkuptojnë edhe një mbështetje të lehtë, nëse duhet edhe me Dogana. Por, nuk nënkuptojnë krijimin e monopoleve. Politikat aktive industriale kërkojnë pikërisht konkurrencën e barabartë, e kurrësi krijimin e monopoleve. Frikohem se këto masa që janë marrë më tepër anojnë kah krijimi i monopoleve se sa kah krijimi i konkurrencës së barabartë. Këtë çështje duhet ta mendojnë thellë Qeveria dhe ministria. A po krijohet konkurrencë e barabartë, apo monopole? Në këtë çështje duhet dhënë përgjigje.

Nën dy, argumentimi që prezantohet për ose kundër është i mangët. Është i mangët për arsye se neve na duhet të shohim se cili është ai lloj çmimi referent botëror i çimentos. Nuk e kemi këtu. Për të thënë për dikë se ka çmim damping, ne duhet të shohim, ta krahasojmë atë me çmimin në vendet tjera, në çmimin botëror, e jo vetëm tregun e Kosovës. Mu për këtë, mendoj se menjëherë duhet të shikohet kjo.

E treta, çfarë është çmimi me shumicë dhe pakicë në Kosovë? A është më i lartë se në Shqipëri, se në Bullgari, se në Serbi e gjetiu. Në qoftë se në Kosovë çmimi i çimentos me shumicë dhe pakicë është më i lartë, kjo do të thotë se ende mungon konkurrenca. Prandaj, në vend që të krijohet monopoli, ne duhet ta stimulojmë konkurrencën. Më falni, unë jam duke folur si ekonomist, para së gjithash.

Nën katër, këto gjëra ne nuk i kemi, as paraqitjen e ministres, as nga kundërshtarët. E, këto janë esenciale. Çështja tjetër është letra e “Titanit”. Ajo është shumë interesante. Sot e morëm. Ajo letër thotë kështu: “Unë e kam blerë fabrikën. Nëse doni të ekzistojë fabrika, ju duhet të më mbron. Unë t’ua shes çimenton me çmim të lartë kosovarëve dhe me ekstra fitimin që e bëj, i bëj investimet që i kam premtuar”. Më lejoni të them që kjo është logjikë e papranueshme. Kjo është logjikë e papranueshme, sepse çmimin nuk mund ta paguajnë prodhuesit kosovarë dhe konsumatorët kosovarë. “Titani”, mirë se ka ardhur! Mua më pengon diskutimi, kur thuhet “Titani” grek. Ai është prodhues në Kosovë dhe ne duhet të ruhem, ju lutem, edhe kolegë deputetë, të ruhem prej atyre gjërave. Ai ka investuar në Kosovë dhe duhet të sillët sipas ligjeve të Kosovës, por nuk duhet të kërkojë që t’i hipë Kosovës në shpinë dhe ta eksploatojë në kushtet e një konkurrence të pabarabartë.

Prandaj, “Titanit” i themi je këtu, do të jesh i mbrojtur me ligjet e Kosovës, duhet t’i respektosh ligjet e Kosovës, në asnjë moment të mos i shkelësh ligjet e Doganës. Unë kam dëgjuar që kjo po verifikohet, por megjithatë sot është në fuqi vendimi i Doganës së Kosovës se ka bërë shkelje doganore. Dhe t’i themi “urdhëro, me konkurrencë bëje një çmim që është i dobishëm për Kosovën, bëje një çmim dhe bëju edhe eksportues, jo vetëm ta eksploatosh blerësin kosovar”. Sepse, “Titani”, edhe çdo prodhues i Kosovës nuk mund të zhvillohet vetëm me tregun e Kosovës. Dhe, në qoftë se e mbrojmë “Titanin” artificialisht me çmime, si do të eksportojë? Ne presim nga “Titani” të eksportojë në Shqipëri e në Itali, e gjithkund. Prandaj, këto janë gjëra që duhet të mendohen shumë seriozisht. Edhe çdo investitori të Kosovës duhet t’i themi se ne do ta mbrojmë derisa kjo është në dobi të Kosovës, në dobi të konsumatorit, në dobi të atij që e shfrytëzon çimenton. Mos harroni, çimentoja është si mielli. Çimentoja është lëndë e parë në një sektor të ndërtimit, që është kryesori sot në ekonominë e Kosovës.

Dhe, në qoftë se atij sektori të ndërtimit, me rritje të çmimit të inputeve, siç është çimentoja, ia keqësojmë kushtet e punës, ne e kemi bërë atë jokonkurrent te “Bechtel & Enka”, e kemi bërë jokonkurrent në ndërtimin e banesave, në ndërtimin e rrugëve dhe deri te ndërtimi i shtëpive, meqë njerëzit shkojnë t’i blejnë nga 10-15 thasë çimento.

Pra, duhet të kemi kujdes, duhet t’i studiojmë gjërat. Prandaj, unë nuk e përjashtoj mundësinë e marrjes së masave, por ato duhet të studiohen mirë. E kam përshtypjen, ndoshta mund të gaboj, se kjo është më tepër një masë incidentale se sa masë mbrojtëse.

Tjetër? Të ju them të drejtën, mua po më pengon pak kjo situatë. Mendoj se të gjithë ne deputetët që jemi këtu kemi përgjegjësi që ta rritim autoritetin e këtij Parlamenti, ta rritim përgjegjësinë e këtij Parlamenti për të debatuar dhe për të marrë vendime, e jo me ftesa të ndryshme për t’i pamundësuar vendimet e këtij Parlamenti.

Mendoj për mënyrën si të vijmë deri te një mundësi e diskutimit të mirë dhe e vendimeve të mira, pa e denigruar askënd, as ministren. Duhet ta ruajmë autoritetin e

gjithkujt. Ndoshta ministrja ka menduar se kjo është mirë. Ne duhet ta bindim sot se nuk është mirë. Por, jo ta denigrojmë askënd pa pasur argumente dhe në këtë drejtim mendoj se mënyra e krijimit të krizave artificiale, të sillet Kuvendi në gjendje që të mos mund të marrë vendime është e rrezikshme për autoritetin e këtij Kuvendi, për stabilitetin e Kosovës dhe për demokracinë në Kosovë.

Prandaj, kërkoj prej pozitës dhe opozitës, por sidomos prej pozitës, që të jetë serioze në punën e këtij Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Se vendimi është i menduar mirë dhe i arsyetuar, e pamë nga reagimi i zëvendëskryeministres. Baza ligjore që ajo e ka gjetur, sepse një ministër i Kabinetit në detyrë ekzekutive punon shumë për ta arsyetuar vendimin, se është serioz. Në këtë rast po flasim për një ministër serioz dhe këtu nuk kemi të bëjmë me vendime aksidentale, as me vendime tjera.

E dyta se është serioze është që tash një vit, kjo ministre i ka rekomanduar kryeministrit që në Kabinetin qeveritar ta sjellë një vendim, duke zbatuar parimin e reciprocitetit dhe bazën ligjore e ka marrë në marrëveshjen që sot e përmendi, por në kuptim tjetër dhe që për herë të parë në skenën politike e ka shkaktuar një solidaritet dhe mbështetje politike të të gjithë faktorit këtu.

Masa e reciprocitetit edhe me polici, me njësitë speciale të policisë u detyruan për aq kohë sa u detyruan të mbahen, por e toleroi. Unë pres që brezi i tolerancës, me gjithë masat tjera, do të ndodhë edhe tash, por pse ka qenë e nevojshme të bëhet diçka e tillë, duke krijuar rrethana të betonimit të monopoleve, dhe e ka betonuar legalisht monopolin në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Ne mund të thirrëmi në parimin kombëtar dhe në tregun e lirë kombëtar, por ne po flasim për dy pronarë që vijnë nga dy shtete, që në Kosovë njihen si “not recognizers”. Prodhimi vendor i Kosovës e ka pronar grekun, prodhimi vendor i Shqipërisë e ka pronar spanjollin. Po dua të tregoj se këtu po flasim për ligj, e jo për pronarë dhe për miniera, sepse pronarët nga të dyja vendet janë pronarë të huaj, të cilët po tregojnë se duke luftuar për monopol në tregun shqiptar, që biznesi i tyre të përfitojë. Fundja, ata njerëz janë inteligjentë, meqë kanë krijuar biznese aq të mëdha në regjionin tonë. Ata dinë të eksploatojnë edhe më mirë se ç’mendojmë ne dhe realisht po më intereson pse të bëhemi argatë për të krijuar monopole. Lejo që qytetari të blejë 10 ose 5 centë më lirë, sepse ajo është e drejtë e tyre, sepse ata ndërtojnë për çdo ditë.

Unë e kam filluar ta ndërtoj një shtëpi para tre vjetësh. Kur e kam filluar, një vendim indirekt i Qeverisë e ka rritur çmimin e hekurit dhe gjatë kohës së ndërtimit më është dashur ta blej hekurin më shtrenjtë. Në fund del se duhet ta blej çimenton me çmim të

shtrenjtë, sepse sezoni veror i ndërtimit me vendime të tilla ndikon drejtpërdrejt te qytetari. Ju nuk mund ta mohoni në asnjë mënyrë që jeni bartëse e monopolit dhe e krijimit të kushteve të tilla. Dikush tha që “Titani” është zënë duke sjellë çimento të gatshme. Edhe kjo e ka anën e mirë, sepse i ruan kushtet ambientale në Kosovë, sepse “Sharrcemi” është njëri nga ndotësitë më të mëdhenj, pas “Ferronikelit”.

Paralelisht me vendimin tënd, sikur të kishte masa tjera adekuate, të cilat krijojnë rrethana tjera, do t’i kisha besuar. Nga një vendim që tash një vit, sot në javë bëhet një vit, ke garantuar diçka tjetër, ke rrëshqitur në pozita ku absolutisht ke betonuar monopol për kompani që, më lejoni të ju them edhe një herë, për pronar e kanë tjetërkënd, e punëtorë jemi ne. Edhe ne jemi ata që e marrim ajrin e ndotur në këtyre pronarëve, edhe jemi ata që e blejmë mallin e këtyre pronarëve. Ti vazhdo të sjellësh pronarë tjerë, sepse Kosova ka nevojë për punë. Natyrisht ne kemi nevojë t’ua rritim rrogën atyre punëtorëve dhe sikur të kishte qenë rritje e rrogave të punëtorëve të “Sharrcemit” për 35%, të kisha aplauduar, por kjo nuk ka ndodhur.

CEFTA e vitit 2006, që u përmend se favorizon apo disfavorizon diçka, më lejoni t’ju them që ne CEFTA-n 2006 e kemi pranuar, e kemi nënshkruar pa negociuar shumë, sepse Kosova e ka bërë CEFTA-n në interes të vetin, duke dashur ta përfitojë statusin politik. Por, ajo Qeveri në atë kohë nuk ka pranuar t’i japë territore Maqedonisë për status politik. Çfarë ka ndodhur me 1 200 km², kompensim si kusht. Nuk ka pranuar që me Serbinë ta ndërrojë terminologjinë edhe të bëjë masa të tilla dhe, në fund, nuk ka pranuar që të vijë “Titani” për ta zëvendësuar një kompani zvicerane pas 10 vjetëve, ta blejë me çmimin që ka dashur ta blejë dhe të krijojë ambient, çfarë po vazhdon ta krijojë, që nuk njihet ndryshe, pos monopol.

Dhe, ky është njëri prej monopoleve që po legalizohet, po formalizohet në Kosovë, sepse unë pres që shumë shpejt edhe në sektorë tjerë të vendoset monopoli. Por, e mira e krejt këtij angazhimi është që, të bëhemi të sigurtë dhe të themi që zona e ndërtimit do të përfundojë edhe nja dy muaj, e deri atëherë s’kemi qare pa e kaluar kështu duke blerë kohë. Por, gjithçka që është joligjore, është shkelje e ligjit dhe për shkelje të ligjit duhet të ketë sanksione. Dhe, kryeministri e ka bërë një veprim të mirë, ka filluar t’i lirojë disa njerëz nga detyra. Është mirë të mendohet që të gjithë ata që e shkelin ligjin të lirohen nga detyra, sepse vërtet jeta po rëndohet. Edhe ashtu e kemi jetën e rëndë, por monopoli ka filluar të bëhet i rëndë për ata që së paku e mbajnë shpresën e punës në Kosovë, e punëdhënies në Kosovë, sepse blerësit i çojnë duart dhe thonë: “Nuk blejmë hiç!”. Fillojnë ta bojkotojnë dhe logjika e bojkotit vjen si vokacion. Mos harroni!

Problemi është që ne po i mbajmë shpresat për t’i rritur vendet e punës për njerëz, e nëse fillojmë të humbim vende të punës për shkak monopolit të “Titanit”, apo për shkak të monopolit grekëve, spanjollëve në hapësirat shqiptare, besoj që e kemi gabim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Haxhiu e ka fjalën. Më duhet të ju paralajmëroj se i keni 6 minuta. Është edhe Ardiani i paraqitur, në qoftë se doni ta ndani kohën, ta kini parasysh.

TEUTË HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Së pari po ju paralajmëroj se jo vetëm si një vendim skandaloz që ka ndodhur prej ministres Kusari-Lila, por edhe kjo çfarë bëri sot kryeministri, duke i ftuar të gjithë deputetët e radhëve të veta, por edhe të pakicave, që këtu i pashë me sytë e mi, por edhe deputetin iniciues të kësaj çështjeje, nuk e di për çka, por kjo tregon që është një mbështetje e plotë e këtij vendimi.

Fatkeqësisht, Kosova sot pas më shumë se një dekade nga çlirimi po vazhdon të vuajë çrregullime të vazhdueshme të një disbalance ekonomike enorme.

Treguesit ekonomikë edhe këtë vit nuk japin shenja shprese për një rimëkëmbje ekonomike. Në këtë kuptim, zhvillimet e ditëve të fundit në vend, si procesi i privatizimit të Distributimit të KEK-ut, PTK-së dhe vendimi për taksën e çimentos së importuar, në të vërtetë janë të papranueshme dhe si të tilla shumë shqetësuese. Në kuadër të kësaj, vendimi i Ministrisë së Tregtisë për taksën në çimenton e importuar, ose është naiv, ose me prapavijë. Është pjesë e këtyre çrregullimeve. Si i tillë doli të jetë një vendim tekanjor i radhës, absolutisht i pakuptimtë, shumë tendencioz dhe jashtëzakonisht i dëmshëm për Kosovën.

Zonja Kusari me këtë rast e zgjodhi Greqinë në vend të shtetit shqiptar! Çfarë fataliteti! Si mund t'i kuptojmë ne këto standarde të dyfishta, kur në njërin anë thuhet se po i mbrojmë prodhimet vendore, e në anën tjetër mbi 60% e importit vjen nga Serbia dhe Maqedonia.

Si ta kuptojmë faktin tjetër se kur kërkohej reciprocitet me Serbinë, ministrja Kusari-Lila e shtroi me aq pompozitet, me vizionin e saj të zhvillimit ekonomik, duke dalë shpeshherë edhe qesharake me deklaratat e çakorduara. A nuk është kjo ironi e llojit të vet?!

Si mund që ministrja e Tregtisë ta favorizojë një evazionist të dënuar si “Sharrcepi”, si cili përpiqet ta mashtrojë Qeverinë e vendit? Si mund të shpjegohet me këtë rast indiferenca dhe heshtja e Qeverisë së Kosovës?

Vendimi doli të jetë i dëmshëm, sepse krijoi monopol, duke larguar nga tregu rreth 200 firma tregtare e me mijëra qytetarë të punësuar në këtë sektor. Ne e shprehim shqetësimin e qindra pronarëve vendorë, të cilët për më shumë se një dekadë kanë importuar çimento nga Shqipëria, ndërsa humbjet e tyre gjatë këtyre ditëve janë me shifra marramendëse. Kush do t'i kompensojë këto humbje?

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sahatqija, e keni fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje kolegë deputetë të opozitës,

Përshëndetje katër kolegë deputetë të PDK-së,

Edhe përshëndetje për tre kolegë deputetë të AKR-së, që me shtatë deputetë e përfaqësojnë koalicionin qeveritar.

Desha ta pyes kryeministrin, edhe pse nuk është i ulur aty, ai me siguri na ndjek. Ku i ke deputetët, ku i ke burrat, ku i ke gratë, o kryeministër? Pse e le Mimozen, pse e le ministren tonë vetëm, meqë nuk e ka bërë asnjë punë pa të pyetur ty? Pse e le vetëm, pa u ballafaquar? Pse nuk i ke njerëzit tu këtu për ta mbrojtur vendimin? Se këtë vendim nuk e ka marrë ajo vetë. E ke marrë ti, bashkë me tutë, bashkë me Qeverinë tonë. Pse nuk je këtu ta mbrosh atë vendim? Pse po ikën prej betejës? Rri këtu dhe mbroje në qoftë se është i mirë. Bindna se është i mirë, të votojmë edhe ne. E, në qoftë se është i keq, rri këtu dhe dëgjoje, dhe tento ta mbrosh ose bashkoju, por mos e lë vetëm ministren tonë dhe Qeverinë tonë, e ta shikosh nëpërmjet televizorit.

Kosova ka nevojë për investitorë të huaj, edhe për kompani vendore prodhuese. Kosova ka nevojë për krijimin e vendeve të punës, edhe për pagesa të tatimeve. Ka nevojë për mbushje të buxhetit, ka nevojë për stimulim të prodhimit vendor, për përmbushjen e nevojave të vendit, e ndoshta edhe për eksport, në qoftë se tepron. Ka nevojë të tregojë se investimet e huaja nuk janë të sigurta e të vlefshme për ne si krijues të vendeve të punës, në mbushje të buxhetit, e këtë askush nuk e kundërshton.

Por, Kosova ka nevojë të tregojë se duke e mbrojtur një degë të ekonomisë, nuk e dëmton degën tjetër. Ka nevojë të veprojë ashtu që stimulimi i një dege të mos e destimulojë një degë tjetër të ekonomisë.

Ka nevojë të tregojë veprime serioze afatgjate, me të cilat i mbron investimet dhe investorët e Kosovës, e jo veprime të shkurtra, të cilat diku ndihmojnë, e diku dëmtojnë.

Vendimi për taksën e çimentos është ndër vendimet të cilat bënë bujë të madhe për një kohë të gjatë, deri në protesta. Pati reagime të ndryshme, duke nisur prej ankesave të “Sharrcemit” dhe punëtorëve të tij për t’i mbrojtur kompanitë që kanë investuar në Kosovë. Arriti deri te reagimet e importuesve, përsëri me protesta.

Kompanitë ndërtimore vazhdojnë me reagim të deputetëve, të ekspertëve të ndryshëm, reagime të mediave, të Odës Ekonomike, të letrës së Ministrisë ndaj Odës Ekonomike, që është një veprim eklatant dhe i papranueshëm.

Emëruesi i përbashkët i të gjithave është ankesa në shumë nivele, e cila jep të kuptohet se kjo masë dikë e ka lënduar, që një pjesë të biznesit e ka lënë pa punë. Lë përshtypjen se ky veprim nuk ka pasur një planifikim afatgjatë të menduar mirë, një planifikim, ku pas një analize të mirëfilltë, do të identifikoheshin problemet dhe do të ndikoheshin, jo vetëm në shërimin e simptomave, se ky është shërim i simptomave, jo shërim i sëmundjes së mungesës së zhvillimit ekonomik. Veprime, të cilat nuk e kishin prishur njërin anë, duke dashur ta ndreqin një anë tjetër.

Edhe ky veprim po tregon se po vazhdon politika e “PowerPoint” prezantimeve të tipit “Banjsko” me veprime sipërfaqësore, por jo me një strategji të mirëfilltë zhvillimore e me masa, të cilat do ta krijojnë një ambient të përshtatshëm për biznes dhe krijimin e kushteve të mirëfillta të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe krijimin e vendeve të qëndrueshme të punës, e jo të krijohet iluzioni i mbrojtjes së kompanive dhe iluzioni i mbrojtjes së vendeve të punës.

Nuk mbrohen investitorët e biznesit vendor me veprime të përkohshme, të cilat e ndihmojnë njërin palë dhe e dëmtojnë tjetrën, por mbrohen duke krijuar kushte të favorshme që ato kompani të jenë konkurrencte dhe të afta të përballen me konkurrencën e lirë. Kjo duhet të jetë detyra e Qeverisë, kjo duhet të jetë detyra e Ministrisë.

Në anën tjetër, mendon se Qeveria trumbeton me të madhe për krijimin e një tregu të përbashkët regjional, me theks të posaçëm në krijimin e tregut të përbashkët dhe kompatibil me Shqipërinë. Ne deri tash e kemi parë vetëm një disonancë të vërtetë të veprimeve. Kemi parë pengesa në eksportin e patateve kosovare në Shqipëri, pengesën e importit të çimentos, kemi parë mungesën e vullnetit të koordinimit për krijimin e një sistemi të përbashkët energjetik. Bile edhe Abetarja e përbashkët, e trumbetuar si diçka shumë e rëndësishme që integron, në fakt, si edhe shumë veprime tjera, treguan mungesën e dhimbshme të vizionit të planifikimit të mungesës së menaxhimit të këtyre projekteve.

Në fakt, shumë gjëra përfunduan me fjalime boshe, me fotografime me zyrtarë të Shqipërisë, me “PowerPoint” prezantime me shumë ngjyra në veprime, por jo edhe me shpresë të vërtetë se po veprohet me dije e me plan për t’i ndihmuar bizneset dhe prodhimet tona.

Unë edhe në Komision e pata pyetur ministren se çka kanë ndërmarrë si Ministri dhe si Qeveri për ta krijuar një ambient të përshtatshëm për tregun e lirë dhe të konkurrencës, por afatgjatë, me prioritet strategjike, jo me veprime të shkurtra, të cilat dëmtojnë. Si i keni stimuluar bizneset, në këtë rast “Sharrcemin”, që të jetë konkurrent në treg dhe t’i ketë jo 500, por 1 000 punëtorë? Cilat ishin masat në aspektin ndërkombëtar, në qoftë se nga Italia vjen rreziku dhe ky destabilizim, çka keni ndërmarrë në aspektin ndërkombëtar? A keni bërë ankesa, a keni bërë vërejtje, a keni bërë veprime, të cilat do ta kishin penguar prishjen e tregut. Mirë se erdhët kryeministër!

Në mënyrë që investimet dhe kompanitë vendore ta dinë që kanë mbrojtje e stimulim të biznesit në një periudhë afatgjate, por jo kjo masë të shndërrohet në masë të krijimit të monopolit, në masë të stimulimit të një kompanie, që ndoshta nuk është e aftë të veprojë në treg, duke u ndihmuar nga Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në fakt deputetë të partive që nuk janë në pozitë,

Nuk është kjo hera e parë që koalicioni qeverisës, përkatësisht deputetët e koalicionit qeverisës e lëshojnë Kuvendin. Është hera e dytë, në fakt, në këtë legjislaturë, ndoshta ka pasur edhe herë tjera dhe zakonisht ndodh që ta bojkotojnë sallën atëherë kur e shohin që ose do ta humbin votën, e pra e lëshojnë sallën për ta pamundësuar kuorumin, ose që të mos e bëjnë gabimin që e kanë bërë më 7 dhjetor, kur e kanë humbur votën vërtet në mocionin për reciprocitet, për të cilin pastaj u desh t'u merret fytyra edhe këtyre, ta sjellin një mocion tjetër, e me njëqindmijë shkelje të procedurave, të ndryshohet ai. Tash kanë vendosur në njëfarë mënyre shumë më perfide dhe më të pastër, të mos e mundësojnë kuorumin hiç. Pra, edhe këta po e pranojnë që vendimi është shumë i keq.

Unë kisha dashur ta shtroj këtë çështje, edhe pse e kemi numrin e kufizuar të minutave dhe nuk do të kem shumë kohë për ta shtjelluar deri në fund atë që dua të them, po do ta shtroj në dy rrafshje. Për shkak se këtu po diskutojmë në dy rrafshje, u përmendën të dyja në disa raste.

Është ky rrafshi kombëtar, për të cilën nuk kam shumë të shtoj, meqë disa thanë që nuk është i rëndësishëm, disa tjerë thanë se meqenëse është edhe prodhuesi atje në pronësi të një kompanie spanjolle, apo disa herë kanë thënë libaneze, atëherë nuk qenka mbrojtje e kombit, e kështu me radhë, mirëpo atëherë në këtë drejtim çfarë kuptimi ka të mbrohet prodhuesi i Kosovës. Pra, prodhuesin e kujt po e mbrojmë ne? Po që se nuk e mbrojmë një treg kombëtar dhe zhvillimin e dyanshëm, atëherë të mos e mbrojmë askënd.

E dyta, sa i përket rrafshit ekonomik, cila është ideja e kësaj mbrojtjeje, e kësaj mase të mbrojtjes? Asnjëherë nuk na u tha se cila është ideja dhe qëllimi i Qeverisë për këtë masë mbrojtëse. Pra, a është ideja vetëm ta mbrojmë "Sharrcemin" në mënyrë që ai të realizojë profit, atë profit që e paska kalkuluar para se të vijë dhe ta blejë "Sharrcemin", apo është ideja e zhvillimit të një sektori industrial, në të cilin ne e kemi një plan konkret strategjik afatgjatë, që duam ta zhvillojmë. Pra, kjo është përgjigjja. Po që se masa mbrojtëse vërtet do ta zhvillojë sektorin e prodhimit të çimentos në Kosovë, meqë paska potencial të madh të rritjes së punësimit dhe të industrializimit të vendit, atëherë a është kjo masë mbrojtëse me atë qëllim? Nëse është, pse nuk po thuhet? Por, nuk u tha që është me atë qëllim. U tha vetëm që ta mbrojmë "Sharrcemin" në këtë moment të caktuar dhe t'i mbajmë, siç e tha ministrja, ata 500 punëtorë të "Sharrcemit" në vendet e tyre të punës. Pra, ky është dimension i tjetër, dimension i ekonomik, por edhe social. Dhe, në këtë drejtim, unë kisha dashur t'ia shtroj ministres një pyetje të thjeshtë. U përmend edhe nga zoti Beqiri, në fjalën e tij, "Sharrcemi" i ka pasur 700 punëtorë më parë në punë, tash i ka 500, ndërkaq e dimë se një pjesë e këtyre punëtorëve janë përjashtuar nga vendet e punës në momentin kur kompania është privatizuar, ashtu siç është privatizuar, dhe e dimë të gjithë si ka qenë ky privatizim. Pyetja ime shumë e thjeshtë është: Pse nuk i mbrojtët punëtorët atëherë? Pse nuk i mbrojtët punëtorët e "Sharrcemit" kur protestonin për

vendet e tyre të punës? Por, përgjigjja që u vinte nga Qeveria atëherë ishte policia, njësitë speciale që i arrestonin. E tash po i mbron punëtorët! Kjo dëshmon që në fakt nuk po mbrohet punëtori i Kosovës fare, por po mbrohet pronari i “Sharrcemit” dhe profiti i tij.

Çështja tjetër që ka të bëjë po ashtu me ekonominë dhe ajo që u tha nga ministrja se masa mbrojtëse është për ta mbrojtur tregun dhe prodhuesin e Kosovës, që është më me rëndësi, e në të njëjtën kohë e përmendi se si kjo Qeveri e paska një historik të mbrojtjes dhe të përmirësimit të marrëdhënieve tregtare të Kosovës me vende tjera.

Në këtë drejtim, pyetja ime ka të bëjë me diçka që ka thënë më herët ministrja, në një interpelancë tjetër, që e përmenda, më 7 dhjetor, kur në kritikën tonë se hapja e tregut ndaj Serbisë po e dëmton prodhimin vendor, kjo pati thënë që në fakt tash kemi masa reciprociteti me Serbinë dhe tha, po e citoj, ‘mos pritni që ne do t’i numërojmë kamionët, maunat, sa po shkojnë në Serbi e sa po vijnë prej Serbisë’. Ndërkohë që tash, me këtë vendim, në fakt, a po i numërojnë maunat? Po thonë po na vijnë më shumë prej Shqipërisë, se sa mund të dërgojmë ne në Shqipëri, prandaj po i ndërpresim ato që po vijnë prej Shqipërisë. Prandaj, a ka ndryshuar logjika qeverisëse, apo thjesht ministrja ka harruar çfarë ka thënë.

Një çështje tjetër që nuk kam mundur të mos e përmend është nga fjala e ministres, por edhe nga ajo që e ka raportuar në Komisionin Parlamentar FunkSIONAL. Shihet se ato të dhëna që na i paraqiti Qeveria, si të dhëna që i paska gjetur kjo nga hulumtimi, janë në fakt të dhëna që i ka lëshuar “Sharrcemi”.

Në letërën, e cila është botuar sot në “Koha Ditore”, e shihni që të njëjtat argumente i ka sjellë menaxheri i “Sharrcemit”, përveç kërcënimeve që i kishte sjellë ai për deputetët e Kuvendit, se kinse po që se ne e votojmë tash këtë heqje të kushtëzimit, atëherë Kosova do të kolapsojë ekonomikisht për shkak se “Sharrcemi” do të kolapsojë ekonomikisht. Të tjerat janë ato që i ka thënë “Sharrcemi”. Pra, në një farë mënyre, ministrja ka bërë keq që u shndërrua për një moment në zëdhënës të “Sharrcemit” brenda institucionit të Kuvendit të Kosovës.

Dhe, çështja e fundit që kisha dashur ta shtroj lidhet me pozitën dominuese. Për shkak se është interesante qysh ministrja e tha që autoriteti për mbrojtjen e konkurrencës ia ka dërguar vetëm një letër Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me të cilën kërkohet që të rishikohet kjo masë për shkak se sigurisht aty thuhet që ka mundësi që kjo e shkel konkurrencën, meqenëse nuk ishte kërkuar rishikimi pa e shkelur konkurrencën. Dhe, ministrja na tha që konkurrenca nuk shkelet për shkak se Ligji për konkurrencë e definonte pozitën dominuese 40% të pjesëmarrjes në treg. Pra, nëse është kështu, e unë po pajtohem që është, atëherë çfarë synimi ka kjo masë mbrojtëse? A e ka synimin që ta rrisë përqindjen e tregut për “Sharrcemin”? Nëse aktualisht është 33%, ta zëmë që është 33%, se ashtu po thotë edhe “Sharrcemi”, edhe ministrja, atëherë nëse rritet kjo masë, a do ta arrijmë masën 40, 45, 50%? Pra, a po ia mundëson Qeveria “Sharrcemit” që ta marrë këtë pozitë dominuese në tregun e Kosovës? E nëse nuk është ky qëllimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ymeri! Zoti Gjini e ka fjalën. 4 minuta i ke.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit Adem, që m'i ke falur 3 minuta prej kohës.

Mendoj që është e paanashkaluar çështja e parë, e cila duhet të shtrohet. Unë dua ta shtroj pak më ndryshe, ndoshta edhe nuk e ka vendin, por është shumë interesante.

Një çështje filozofike më ka bërë përshtypje shumë të madhe gjatë Kampionatit Evropian të Futbollit. Një lojë futbollit aq shumë është sofistikuar me gjyqtarë, me teknologji, me seriozitet, sa është shndërruar në institucion. Një lojë është shndërruar në institucion serioz botëror. Po dua ta krahasoj me shtetin. Nëse shteti, që duhet të jetë institucion serioz, shumë serioz, e nuk merret seriozisht, shndërrohet në lojë. Do të thotë, më keq se në lojë, edhe mund veç ta merrni me mend çfarë janë pasojat. Nuk mund të jetë salla e zbrazët! Unë kam menduar se do të na e mbushni mendjen sot se vendimi është i mirë, e jo të priset kuorumi.

Sidoqoftë, kjo ishte ajo që më intrigoi të flas, se nuk e kisha në plan të flas, meqë deputetët tjerë kanë thënë shumë. Gjithmonë kur e shohim një vendim të Qeverisë, të gjithëve na shkon mendja se kush fiton, kush përfiton, kujt i del mirë, kujt del keq. Edhe unë e kam pasur problem ta kuptoj, përpos "Sharrcemi", ajo është tepër e qartë. "Sharrcemi" i del mirë, por kam provuar ta marr vesh kujt tjetër mund t'i dalë mirë. Mendoj se një përgjigje e kam marrë sot, por nuk e kam në plan të jua them. Jua them ndonjëherë tjetër.

Gjuha e fjalës së ministres, por gjuha e vërtetë, gjuha origjinale e fjalimit, ma dha një përgjigje. Çfarë po ndodh në Kosovë? Po mbrohet "Sharrcemi". Krejt në rregull. Unë jam deputet i Kosovës, jo deputet i kombit, sinjerisht po ju them, por jam shqiptar, në të njëjtën kohë. Edhe nëse me paratë e mia dikush duhet të përfitojë, me vullnetin më të madh kisha pasur dëshirë të përfitojë Shqipëria, e jo një vend tjetër. Mirëpo, me qenë se jam deputet i Kosovës, për mua më me interes janë qytetarët e Kosovës. Qytetarët e Kosovës të fitojnë më së shumti. Dhe, tani, me këtë vendim, sipas mendimit tim dhe të shumëkujt tjetër, po priset konkurrenca për shkak se u tha këtu që çmimi i prodhimit në Shqipëri është shumë më i ulët. Llogariteni transportin, çmimi i çimentos po del në treg i njëjtë, sikur i importit, sikur prodhimi vendor.

Si mund të ulët çmimi? Nëse "Sharrcemi" dëshiron të shesë më shumë, duhet ta ulë çmimin, ose duhet ta rrisë kualitetin. Mënyra e vetme në ekonominë e tregut për ta rritur tregun është ose të ulët çmimi, ose të rritet kualiteti, por "Sharrcemi" nuk do ta bëjë asnjërën, as nuk do ta ulë çmimin, as nuk do ta rrisë kualitetin, por po e gjen Qeverinë e Kosovës të vendosë tarifë doganore, të drejtë ose të padrejtë. Ka pasur nevojë këtu të diskutohet që nëpërmjet tarifës doganore të ruhet çmimi, në mënyrë që të mos ketë mundësi eventualisht dikush të fusë çimento më të lirë. Tash çfarë po

ndodh? Kosova ka hyrë në luftë ndërmjet Italisë dhe Greqisë, apo Spanjës. Ata po bëjnë luftë për treg, e ne duhet të garantojmë si na del më mirë, por unë atë përgjigje e mora.

Mendoj se Ligji anti-damping nuk ka punë këtu, nuk kemi të bëjmë me damping, absolutisht hiç. Damping është nëse dikush e lëshon çmimin nën vlerën e kostos së prodhimit për të na i rrëzuar neve fabrikat dhe, në fund të fundit, ta marrë krejt tregun. Nuk kemi të bëjmë me damping, kemi të bëjmë me krijim të monopolit. Mirëpo, kjo është paketuar kinse po mbrohet njëfarë sistemi, një farë kuazi-dampingu.

Tani, një çështje tjetër, u përmend dorëheqja. Nuk dua të flas shumë për dorëheqje, por dua ta përmend një rast dorëheqjes morale, i cili në kohët e fundit nuk është përmendur. Nuk mendoj se ka bërë mirë zëvendëskryeministri Kuçi që ka dhënë dorëheqje. Mirë ka bërë që është kthyer, sinqerisht. Mirëpo, dorëheqje morale ka pas dhënë Fatmir Rexhepi, i cili ka qenë ministër kur janë vrarë dy djem, dy martirë. Edhe pse as nuk ka dhënë urdhër, as nuk e ka pyetur kush çka do të bëhet, ai ka dhënë dorëheqje se ka qenë në të njëjtin vend ku ka ndodhur ai krim.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e mora fjalën për t'i adresuar disa shqetësime dhe shqetësimet që janë adresuar dhe përsëritur në vazhdimësi në këtë Kuvend kanë marrë përgjigje negative prej Qeverisë dhe prej përfaqësuesve të saj.

Është adresuar shqetësimi se në Kosovë po dëmtohen prodhuesit vendorë nga mungesa e masave proteksioniste ose mbrojtëse nga prodhuesit e Maqedonisë dhe prodhuesit e Serbisë. Dhe, këtu është thënë që Kosova është ekonomi e tregut të lirë dhe nëse nuk e besoni, kanë thënë, këqyreni Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më duket neni 10, thotë se ekonomia e Kosovës është ekonomi e tregut të lirë. E sot na thuhet që po marrim masa mbrojtëse, sepse po e mbrojmë prapë ekonominë e Kosovës. Dhe, tash lind një problem këtu. Cili është interesi primar i mbrojtjes së ekonomisë së Kosovës dhe interesi i qytetarit të Kosovës? A është interes primar për mbrojtjen e ekonomisë dhe interesave të qytetarëve të Kosovës të mbrohen produktet bujqësore? Është interes absolut, sepse shtrirja të qytetarët e Kosovës është mbi 50% e popullsisë që jeton në fshatra dhe ata merren me produkte bujqësore. Këtu nuk ka asnjë masë mbrojtëse për produktet bujqësore, as për produktet e qumështit, e as për produktet tjera. Dhe, u tha se kjo nuk po bëhet, sepse duhet t'i lihet ekonomisë së tregut të lirë.

Themi se po besojmë në ekonominë e tregut të lirë. Dhe, unë besoj në ekonominë e tregut të lirë, sepse edhe në programin politik të partisë sime është ekonomia e tregut të lirë.

Dalim te kjo çfarë ndodhi këto ditët e fundit dhe çfarë po ndodh me masat kuazi-mbrojtëse, sepse po thuhet masa mbrojtëse për “Sharrcemin” dhe për produktet e çimentos në Kosovë. Realisht, kjo nuk është masë mbrojtëse. Është masë për të garantuar pozitë të privilegjuar për një prodhues të çimentos në Kosovë, prodhues vendor, në këtë rast. Unë e kam vullnetin e mirë që ta konsideroj si prodhues vendor, mirëpo masa e ndërmarrë nuk është masë në interes të qytetarëve të Kosovës. Pse? Ju e dini se kjo do të ketë ndikim direkt në kualitetin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Pse? Sepse do të ndikojë në çmimin e banimit, do të ndikojë në çmimin e ndërtimit, do të ketë efekt zinxhiror, do ta ketë atë që quhet efekti i multimplikatorit, deri te bankat. Në fund, do të ndikojë në gjithë zinxhirin, duke filluar nga aspekti social i banimit, nga aspekti publik i investimeve në rrugë dhe investimet tjera publike, duke vazhduar nga aspekti privat i shtëpive individuale të banimit dhe duke vazhduar nga aspekti kolektiv i banesave kolektive të banimit. Krejt këto ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe krejt këtë çmim do ta paguajnë qytetarët e Kosovës, sepse ju e dini se çmimi i çimentos në Kosovë është rritur, për pasojë edhe çmimi i betonit, e për pasojë do të rritet edhe çmimi i banimit, dhe për pasojë do të rritet edhe kamata e bankave, dhe për pasojë do të rritet edhe vështirësia për kthimin e këtyre kamatave nëpër banka. Ky është efekti i multimplikatorit që e jep ky veprim i papërgjegjshëm i ministres. Papërgjegjshmëria e tillë shkakton efekt zinxhiror edhe në ekonominë e Kosovës, efekt zinxhiror edhe në aspektin e kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës. Këto janë dëme të vazhdueshme që u shkaktohen qytetarëve të Kosovës, dhe kjo është një sjellje e dëmshme për interesat e qytetarëve të Kosovës dhe besoj në kundërshtim me parimin kushtetues të ekonomisë së tregut të lirë. Ne jemi të zotuar për ekonomi të tregut të lirë dhe partia të cilën unë e përfaqësoj këtu e ka pjesë programore ekonominë e tregut të lirë. Kjo nuk është ekonomi e tregut të lirë, kjo është ekonomi e monopoleve, e monopolit individual për përfitim material. Kjo është ekonomi e dëmtimit të interesave të qytetarëve të Kosovës, kjo është ekonomi që nuk jep predispozita për zhvillim të qëndrueshëm, kjo është ekonomi që ka efekt zinxhiror negativ në tërë sistemin e tij, siç e thashë edhe më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën!

IMRI AHMETI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse shumë çështje u thanë, unë do të përpiqem të jem i shkurtër, duke përmbledhur nga ajo që kam dashur të them.

Në këtë vendim të ministres, që mendoj se është edhe politik, edhe komercial, mund të gesh edhe elemente hakmarrëse.

Deklaratat e ministres në mars të këtij viti kanë qenë paralajmëruese për një vendim të tillë. Në mars të këtij viti, ministrja Mimoza Kusari-Lila i ka paralajmëruar Maqedoninë dhe Shqipërinë se Qeveria e Kosovës nuk do të qëndrojë duarkryq. Po citoj: Me politikën, të cilën janë duke e udhëhequr Maqedonia dhe Shqipëria po na shtyjnë që edhe ne t'i aplikojmë masat adekuate edhe ndaj prodhuesve të tyre, ka deklaruar ministrja Kusari-Lila.

Kështu, pra, siç duket, është parapërgatitur terreni për ta ndërmarrë një masë të tillë dhe vetëm është pritur momenti dhe është gjetur rasti për t'u për përkthyer dhe shfrytëzuar kjo situatë në favor të interesave të caktuara.

Rrjedhimisht, kjo deklaratë e ministres i hedh poshtë të gjitha orvatjet, edhe të sotme, edhe të tjera të mëhershme, për ta justifikuar këtë vendim, sepse është bërë me paramendim dhe është parapërgatitur qysh nga marsi i këtij viti. Mbase mund të jetë edhe derivat i pazareve të mëhershme.

Sot e dëgjuam argumentin kryesor të të nderuarës ministre se po e mbron prodhimin vendor, se kjo është bërë pas aplikimit të kompanisë, prandaj pyetja shtrohet vetvetiu: Pse është pritur nëse është dashur të mbrohet prodhimi vendor? Pse është pritur atëherë kërkesa e “Sharrcemit” për ta aplikuar këtë masë mbrojtëse?

Prandaj, po fovarizohet një kompani, siç u tha edhe më parë, në raport me kompanitë tjera dhe po krijohet një monopol, pavarësisht çmimit, pavarësisht kualitetit, pavarësisht asaj se sa kjo është në të mirën e qytetarëve dhe sa është kjo në interes të vendit tonë.

Mendoj se politika tregtare nuk duhet të orientohet për të vënë pengesa dhe barriera për qarkullimin e lirë të mallrave. Përkundrazi, politika shtetërore duhet të orientohet për t'i zbutur ato pengesa dhe barriera nëse ekzistojnë, ose për t'i eliminuar dhe hequr në tërësi.

Këtu u dhanë disa shifra, për të cilat unë nuk dua të lëshohem në analizë, por parametrat e vitit 2009, në raport me treguesit e vitit 2012, nuk duhet marrë, sepse importet e vitit 2009, në krahasim me importet e këtij viti, normalisht që kanë rritje nga Shqipëria, sepse tani është Rruga e Kombit ajo që mundëson të kemi më shumë importe nga Shqipëria se sa kemi pasur në vitin 2009. Prandaj, është shumë i pasinqertë krahasimi i importit të vitit 2009 me importin e këtij viti, apo të vitit 2011.

Ky vendim, edhe unë mendoj që qëllimisht, e çuditërisht e thëllon keqësimin e raporteve tregtare në tregun kombëtar. Këtë nuk e meritojnë qytetarët e të dyja vendeve. Ky nuk është besoj shumë as vullneti, as vizioni i qytetarëve të vendit tonë. Pra, vendimi i tillë është imponues për tregun e Kosovës, pavarësisht cilësisë dhe çmimit, vetëm pse kështu e ka kërkuar “Sharrcemi”, vetëm pse kështu dëshiron ministrja Kusari-Lila, vetëm pse kështu i leverdisë ministres, vetëm se kështu i leverdisë “Sharrcemit”.

Përfundimisht, ky veprim dhe ky vendim është shembulli më i keq i ndërtimit të raporteve në tregun kombëtar, sepse asnjë argument logjik që deri tash u tha, dhe është thënë edhe në debate të deritanishme, nuk shkon në favor të një vendimit të tillë dhe ky vendim duhet të shfuqizohet sa më parë.

Dhe, krejt në fund, i nderuar nënkryetar, Unë e di kur e kam kërkuar fjalën, sepse këto aparaturo na e tregojnë njëfarë numri. Ose rregulloni aparaturat, ose na jepni telefonin mobil që të gjithë ta kërkojmë fjalën me mobilin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Mendoj se e ke gabim. E kam parë që ke qenë në rend, por ose ke dalë, ose të ka rënë emri. Ja ku është edhe sekretari, por sidoqoftë kryetarët e grupeve parlamentare shumë herë në debate e bëjnë radhitjen e deputetëve me prioritet kush duhet të diskutojë. Fjalën e ka zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryesues i Parlamentit, I nderuari kryeministër, E nderuara ministre Kusari, Të nderuar deputetë dhe deputete, Është shumë e qartë se çka do të thotë mbrojtja e prodhimit vendor dhe në cilat rrethana e definon edhe ligji, por kur është në pyetje rasti i çimentos, përkatësisht vendimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për mbrojtjen e çimentos me prejardhje vendore, ligji është përdorur edhe për qëllime të tjera.

Vendimi që çimentoja e importuar të ngarkohet me taksën 35% e ka efektin vetëm për ta mbrojtur pozicionin e prodhuesit të vetëm në vendin tonë, “Sharrcemi”. Ndërkaq nuk është në funksion të mbrojtjes së tregut dhe të konsumatorit.

Unë dua të ju citoj vetëm tri argumente për të ju bindur se është kështu:

E para, pronari i “Sharrcemit” i Hanit të Elezit ka monopol në rajon, ka fabrika në Shqipëri, në Greqi, në Serbi, mirëpo me kapacitetet prodhuese që i ka në Kosovë nuk arrin as për së afërmi t’i mbulojë kërkesat e tregut. Vendimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë tash i krijon mundësi ta bartë çimenton prej një vendi në vendin tjetër. E dimë shumë mirë se me vendimin e Qeverisë, apo shkurt të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ia ka pamundësuar që t’i përmbushë nevojat e konsumit vendor, që ta importojë në mënyrë ilegale si lëndë të parë, në vend të klinkerit. Kështu është zënë dhe është dënuar nga Dogana e Kosovës për dallaveret, apo manipulimet që i ka bërë. Ministria ka pasur mundësi atë ditë, apo në ato ditë, kur Dogana e ka publikuar se “Sharrcemi” ka importuar në mënyrë ilegale, ta anulojë këtë vendim, por këtë ministria apo ministria Mimoza Kusari nuk e ka bërë.

E dyta, arsyetimi kryesor për aplikimin e taksës merret kostoja e lartë e prodhimit të çimentos në Han të Elezit, e cila shkaktohet për shkak të vjetërsisë së stabilimenteve. Në fakt, tash del se MTI-ja e ka marrë në mbrojtje paaftësinë konkurruese të këtij prodhuesi, meqenëse blerësi në momentin kur ka vendosur për blerjen e kësaj fabrike,

e ka pasur të qartë se cila është gjendja e stabilimenteve të saj dhe me çfarë konkurrence do të përballlet në këtë treg. Mirëpo, duket se paska llogaritur në përkrahjen institucionale, me qëllim që ta bllokojë konkurrencën, e cila i vjen nga importi.

E treta, vendimi merret pikërisht në kohën kur sezoni i ndërtimit është në vllugun më të madh dhe kur rritet kërkesa për çimenton. Kohëzgjatja prej 90 ditësh e vendimit përputhet plotësisht me sezonin në vllugun e ndërtimit. “Sharrcem” tash ka hapësirë që vetë të operojë në treg, pa u brengosur fort se mund të shkaktojë mungesë të këtij artikulli, apo se kjo mund të ndikojë edhe në shtrenjtimin e çimentos.

MTI-ja garanton se nuk do të ketë ngritje të çmimit, por sikur harron se është ligji i ekonomisë, harron se çmimi del nga raporti ndërmjet kërkesës dhe ofertës.

Këtu duhet pasur parasysh edhe vlerësimin e para disa javësh të autoritetit të konkurrencës, i cili doli me deklaratën e vendimit të MTI-së, se MTI-ja e ka çrregulluar tregun e çimentos. Po ashtu, se është i mundshëm shtrenjtimi i çimentos dhe ngritja e kostos së ndërtimit tregon edhe fakti se MTI-ja nuk ka kapacitete njerëzore që ta mbajë nën kontroll tregun e çimentos dhe të ndërhyjë në mënyrë efikase.

Se këtu nuk është gjithçka në rregull tregojnë edhe disa gjëra që mund të duken të parëndësishme, por ato e tregojnë thelbin e problemit. Është joreal krahasimi i sasisë së importuar të çimentos nga Shqipëria në vitin 2009. Këtë e thanë edhe disa deputetë para meje, meqenëse në atë kohë nuk ka qenë rruga e kombit “Ibrahim Rugova”, por ka qenë një rrugë, për të cilën janë dashur 12 orë deri në Prishtinë. Për këtë ka qenë një krahasim shumë i dëmshëm nga ministrja, e cila thotë se është rritur importi në Kosovë në vitin 2011, apo 2012.

Dhe, dua të përkujtoj se edhe kryeministri gjatë takimit të tij në Tiranë ka paralajmëruar se ky vendim do të harrohet. Dhe, kërkoj nga kryeministri, sepse e lejon mundësia dhe e ka fuqinë ligjore, që këtë vendim ta anulojë. Për këtë vendim, reagimin më të madh e ka nxitur në Shqipëri, meqenëse nga atje vinte sasia më e madhe e çimentos së importuar. Por, është indikativ fakti pse nuk ka reagime të ngjashme edhe nga Maqedonia, apo nga Serbia. Shifrat tregojnë se ato janë shumë të interesuara për tregun kosovar, por duket se vendimi nuk i ka trembur, meqenëse kanë llogaritur në mundësinë për import nëpërmjet rrugëve të dyshimta.

Data kur MTI-ja e ka marrë këtë vendim ndërlidhet edhe me disa zhvillime paraprahe në “Sharrcem”. Ky prodhues paraprakisht ka bërë ngritjen e çmimit të çimentos, e më pastaj është marrë vendimi për mbrojtjen e prodhimit vendor.

Këto zhvillime vetvetiu lënë për të dyshuar se ka pasur veprime të koordinuara ndërmjet prodhuesit dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Më në fund, më duhet të them se një vendim i keq i kësaj ministrie nuk duhet ta zmbarsë atë nga vendimet e tjera për mbrojtjen e prodhimeve vendore.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Limaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Lutfi Haziri nuk qenka këtu. Pak më herët tha që kur ka nisur ta ndërtojë shtëpinë i është shtrenjtuar hekuri, pastaj tash ku është në ndërtim e sipër çimentoja. Unë desha t'i them që sigurisht në shtator tjegullat do të shtrenjtohen, kur të vijë puna te kulmi.

Mendoj që sot e këto ditë, në Kosovë është duke u zhvilluar një debat, pavarësisht sa është i drejtë, i padrejtë, me palë të ndryshme kundërthënëse, dikush për, dikush kundër, varësisht prej argumenteve, por esenca, për mendimin tim, është duke u zhvilluar një debat përmbajtjesor, sepse bëhet fjalë për çështjet esenciale. Çështje, të cilat kanë të bëjnë, reflektojnë dhe prekin interesat e njerëzve, të qytetarëve të Republikës, grupeve të ndryshme biznesore, të cilat praktikisht, deshëm apo jo, janë shtyllat dhe bartësit kryesorë për motorët kryesorë të zhvillimit të këtij vendi.

Me vetë faktin që ne po debatojmë, pavarësisht këtij shkakut, për çështje të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të këtij vendi, tregon që tema të tilla në Kuvendin e Kosovës duhet të kemi sa më tepër, sa më shpesh, por që fatkeqësisht nuk janë të shpeshta.

Besoj që këtu, një pjesë e madhe e deputetëve e thanë shumë qartë, mesazhi nga Parlamenti i Kosovës do të shkojë në drejtimin e duhur, se Kosova më shumë se çdokush, ose sikur çdo vend tjetër, ka shumë nevojë për investitorët e huaj. Investitorët të cilët sot vijnë e investojnë në Kosovë, qoftë nëpërmjet privatizimit, qoftë nëpërmjet investimeve direkte, praktikisht bëhen investitorë të këtij vendi dhe trajtohen me ligje të këtij vendi dhe janë sikur investitorët vendorë dhe ne, si Kuvend dhe si Kosovë, duhet t'i mbështetim. Jo vetëm që duhet t'i mbështetim, por duhet të kërkojmë forma dhe mënyra që sa më shumë të thithim investime në vendin tonë.

Prandaj, ky mesazh në pjesën më të madhe sot doli edhe nga Kuvendi, që tregon se "Sharrcemi" është kompani e Kosovës, pavarësisht se kush është pronari.

Por, nëse themi "Sharrcemi" është kompani e Kosovës, nuk do të thotë se "Titani" është kompani e Kosovës. "Titani" nuk është kompani e Kosovës, ose kompanitë tjera, që merren me këtë veprimtari ekonomike.

Prandaj, këto dy gjëra mendoj që duhet t'i ndajmë qartë. Dhe, mendoj që ndërmarrja "Sharrcem" ka hapësirë të mjaftueshme, ka treg në Kosovë, siç u tha këtu nga profesionistët, që pak a shumë janë të fokusuar në këtë lëmi, se tregu është më se i sigurt, prandaj çfarë ka këtu që ne duhet bërë për ta mbrojtur këtë kompani. Cili është rreziku për "Sharrcemin"?

U tha qartë se problemi kryesor është monopoli. Unë mendoj, për të mos ia shtuar asnjë fjalë asaj që e thanë nga deputetët, është e qartë që këtu tendenca ose qëllimi krejt i kësaj pune, që është më se normale, është kërkesë legjitime e ndërmarrjes, që të krijojë sa më shumë hapësira për veten e saj. Mirëpo, ne jemi këtu për të mbrojtur ose për të krijuar kushtet e një konkurrence të lirë për të gjithë të tjerët.

Do të doja shumë që të bisedohet sa më shpesh këtu për mbrojtjen e prodhimeve vendore, të mbrohen interesat e këtij vendi dhe të prodhuesve vendorë.

Shpresoj që shumë shpejt, në një seancë të ardhshme të Kuvendit të Kosovës të flasim për prodhimet e prodhuesve vendorë, të cilët janë një gjendje jashtëzakonisht të rëndë. Siç u tha këtu, fermerët, qofshin ata të pemëve e perimeve, të kultivimit, të qumështit dhe produkteve të qumështit, janë në një gjendje jashtëzakonisht të rëndë dhe ky Kuvend dhe Qeveria e Kosovës duhet të krijojnë kushte të favorshme e stimulative për prodhimet vendore.

Ajo që unë dua të them është: Nga krejt kjo që pamë deri tani, nga diskutimi, del se këtu nuk është problemi i “Sharrcemit”. Këtu është problemi i një kompanie të fuqishme, e cila, siç u tha nga njerëzit që e përcjellin, pothuaj ka krijuar monopol në tregun rajonal. Është një luftë e këtij monopoli në tregun rajonal për këtë biznes dhe normalisht nëpërmjet “Sharrcemit”, nëpërmjet mbrojtjes së prodhimit vendor dëshiron ta krijojë tregun monopol edhe në Kosovë. Është fjala për “Titanin”, luftën që është duke e bërë në Shqipëri, në Maqedoni, në Serbi, e ku ta di unë ku, që dikush e nxori edhe kështu betejë rajonale ndërmjet kompanive të vendeve të ndryshme, disa prej të cilave janë shumë thellë dhe nuk do të futemi në të.

Përfundimisht, besoj që debati ishte i mjaftueshëm për të ardhur deri aty ku është paralajmëruar, se ky vendim ka qenë i ngutshëm, jo i studiuar mirë, vendim i cili i ka prekur drejtpërdrejt interesat e importuesve, të punëtorëve, pastaj kjo shkarazi po i plotëson ose po i afekton dhe tash nga interpretimi i lirë po del si konflikt ndërmjet dy shteteve, për të cilën unë nuk besoj që ekziston, por si do që të jetë, kjo është e mjaftueshme, e besoj që Qeveria, në këtë rast kryeministri i Republikës, ta marrë një vendim jo për rishikim, por për anulimin e këtij vendimi, i cili po shihet qartë që nuk është studiuar mirë deri në fund dhe po shihet qartë që qëllimi për të cilin është marrë nuk besoj se i plotëson kushtet për ta mbrojtur, sepse nuk po shohim që kjo ndërmarrje është e rrezikuar, ky prodhim vendor ose punëtorët e kësaj ndërmarrjeje janë të rrezikuar, që nesër mbeten pa punë. Përkundrazi, ka treg të mjaftueshëm për të gjithë. Shpresoj që Qeveria e Kosovës do ta marrë vendimin e duhur dhe kështu të fillojmë të merremi me gjëra më esenciale. Më esenciale janë ato që vërtet po prodhohen në Kosovë, nga prodhuesit e Kosovës dhe, mbi të gjitha, t’i japim një dorë, një shtyrje, një stimulim agrobiznesit, për të cilin dihet që baza kryesore e zhvillimit të këtij vendit do të jetë bujqësia e Kosovës, stimulimi i bujqësisë dhe i prodhimeve të bujqësisë së Kosovës.

Unë besoj që pa e politizuar shumë këtë çështje, shpresoj që Qeveria e Kosovës, në këtë rast edhe kryeministri, do ta marrë vendimin e duhur dhe gjërat të kthehen në

rrjedhën e duhur. Të lejohet ajo konkurrencë e lirë. Normalisht, ne do ta mbështetim dhe duhet të ndihmohet, sepse ligjet i mbrojnë të gjitha kompanitë vendore. Duke përfunduar, po ashtu duke thënë që edhe kjo kompani duhet të cilësohet dhe këtu u vlerësua sot si kompani vendore dhe të gjithë janë të interesuar për ta mbrojtur prodhimin vendor.

Politikat ekonomike në këtë vend duhet të rishikohen mirë. Ka shumë e shumë gjëra që duhen bërë, por besoj se kjo ka filluar. Le ta marrim këtë si fillim të një ndryshimi dhe perceptimi tjetër drejt qasjes serioze, ama vërtet serioze të mbrojtjes së prodhuesit vendor. Deri më tani nuk kemi parë asnjë qasje serioze të stimulimit dhe të mbrojtjes së prodhimeve vendore. Shikoni, vetëm prodhimi bujqësor, për shembull domatet, i përmendi dikush, specat, shikoni çka ndodh nga Maqedonia në Kosovë dhe çka ndodh me prodhimet tona vendore. Anadrinia, për shembull, në çfarë gjendje është. Krejt ai rajon mbahet nga këto prodhime bujqësore.

Nuk kam parë që dikush ka përdorur masa stimulative brenda Kosovës, ose masa mbrojtëse në kufij. Ne e dimë se prodhimi i qumështit bëhet shumë më lirë me subvencione, me kushtet që i kanë Kroacia e Sllovenia, ndërsa në Kosovë i konkurrohet qumështi kosovar. Domethënë, besoj që ka shumë e shumë gjëra tema, për të cilat ne mund të kontribuojmë, mund të ndihmojmë në prodhimet vendore. Nuk besoj që krejt Kosova duhet të orientohet dhe të bëhet temë qendrore çështja e çimentos. Nuk besoj që është aq domethënëse, aq temë qendrore, sa të gjithë të mobilizohemi dhe të merremi me të, të shpenzojmë kohë të panevojshme për këtë, e cila, për mendimin tim, dhe u tha dhe po shihet qartë, që ka qenë një vendim krejt i pamatur, i pastudiuar mirë dhe shpresoj që Qeveria do ta anulojë këtë vendim dhe gjërat do të kthehen në vijën e duhur.

Mos harroni, pajtohem me atë që u tha më herët. S'ka analiza të shkëmbimeve tregtare Shqipëri-Kosovë që mund të krahasohen para rrugës dhe pas ndërtimit të saj. Ato çojnë në statistika shumë të gabuara dhe nuk guxon të bëhen krahasime të tilla.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani e ka fjalën i fundit.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje Kabinetit,

Kolegë të nderuar,

Unë pajtohem me atë dhe e kam nënshkruar me vetëdije kërkesën për interpelancë, pikërisht për çështjen e atyre që u thanë, si dhe monopolit.

Ne e kemi pasur ministren në takime në Komision dhe shumë herë kemi kërkuar nga ajo ta nxjerrë një vendim të tillë për mbrojtjen e produkteve bujqësore pikërisht për t'i mbrojtur bujqit, por Ministria nuk ka qenë e gatshme ta mbështesë këtë për arsye të marrëveshjes së CEFTA-s, tregtia e lirë, e tjera e tjera.

Nëse ka qenë tregtia e lirë dhe Marrëveshja e CEFTA-s, cila ka qenë arsyeja që të vendoset një vendim i tillë pikërisht për "Sharrcemin", ose për tjerat?

Unë nuk do të ndalem vetëm këtu. Shkeljet janë shumë të rënda dhe këto shkelje nuk ka mundësi të mbulohen, ose të arsyetohen.

Unë mendoj që nga kjo çështje duhet të dilet edhe me një vendim të tillë. Kërkoj që kryeministri, meqë është këtu, duke e falënderuar për angazhimin e tij, ta nxjerrë një vendim për mbrojtjen e produkteve bujqësore. Është kjo e vetmja mundësi që ne t'i mbrojmë bujqit.

Vendimi i tillë nuk është në kundërshtim me asnjë marrëveshje, pikërisht është vendim që lidhet me Marrëveshjen e CEFTA-s për mbrojtjen e produkteve vendore. Prandaj, ne duhet t'i stimulojmë me subvencione dhe grande bujqit tanë, fermerët tanë dhe si vend bujqësor kërkojmë që t'i mbrojmë ata. Nëse kemi të drejtë me një vendim, duhet të kemi të drejtë edhe në vendime tjera.

Si komision e kontrollojmë ose e monitorojmë edhe çështjen e ambientit dhe ne kemi pasur takime në "Sharrcem", ku kemi kërkuar që të vendosen masat e mbrojtjes së ajrit dhe atje kanë vendosur sistem shumë të mirëfilltë. Ka vendosur edhe KEK-u, ka vendosur edhe "Ferronikeli", kështu që ajrin e kemi pastruar bukur shumë nëpër këto vende të kompanive, ndërsa në qytetin e Prishtinës e kemi ndotur më së shumti.

Këtu i kemi dy veprime të cilat lidhen njëra me tjetrën, njërën nga Ministria e Financave, dhe tjetrën nga Ministria e Tregtisë.

Ministria e Financave, lejinin e makinave më të vjetra se 20 a 30 vjet, të cilat e djejin atë karburant, dhe Ministria e Tregtisë që lejon importin apo furnizimin e Kosovës me naftë me sasi të mëdha së sulfurit, diku për shembull në standardet e Evropës është me 10 PPM, ndërsa në Kosovë e shfrytëzojmë atë me sulfur deri në 1144 PPM.

Me këtë ne kemi shkaktuar dhe shkaktojmë sëmundje të ndryshme te qytetarët e Kosovës, sidomos te banorët, të cilët jetojnë nëpër qytete të ndotura. Prandaj, kërkoj që ministria, përveç këtyre të "Sharrcemit", ta ketë në kontroll dhe ta liberalizojë kontrollin e derivateve të naftës, përndryshe sëmundjet e kancerit janë rritur tej mase pikërisht nga kjo.

Edhe një herë kërkoj që kryeministri ta nxjerrë një vendim në emër të Qeverisë në mbrojtjen e produkteve bujqësore dhe ta anulojë këtë të "Sharrcemit", apo të vendosen masa shtesë.

Unë mendoj, edhe një herë po them, që çështja e naftës duhet të jetë problematike dhe urgjente për ne...

KRYESUESI: Nait, të lutem, mos u zgjero, qëndro në temë!

NAIT HASANI: Unë nuk po zgjerohem, por Komisioni ynë është mjaft i gjerë, sepse e ka fushën e bujqësisë dhe është për 10 mijë kilometra katror, i nderuar nënkryetar,

dhe nuk mund ta kapërcejmë shumë shkurt këtë sipërfaqe. Unë e falënderoj edhe kryeministrin, prandaj kërkoj që kryeministri të nxjerrë vendim: anulimin e këtij vendimi, apo vendosjen e masave shtesë, nëse nuk janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Nëse nuk nxirret një vendim për mbrojtjen e produkteve bujqësore, si Komision jemi të detyruar të bëjmë ankesë në organet më të larta të shtetit të Kosovës, në Gjykatën Kushtetuese, që ajo të nxjerrë vendime të mirëfillta pastaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është për ministren, zonja Mimoza Kusari-Lila. Besoj se i keni dëgjuar fjalët e deputetëve dhe keni hapësirë kohore për t'i sqaruar, edhe deputetët, edhe opinionin. Faleminderit!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues! Natyrisht, me shumë kujdes e përcolla debatin. Dëshiroj të ju falënderoj për të gjitha rekomandimet dhe konkluzionet.

Gjithashtu, konsideroj se ndoshta në hapje disa gjëra u anashkaluan, si informacione që japin bazë edhe për vendimin, për legjitimitetin e vendimit, por edhe për arsyet ose mosarsyet e marrjes së masave mbrojtëse në produktet tjera.

Më lejoni të filloj te çështja e reciprocitetit, për arsye se u përfol në disa instanca që reciprociteti është marrë nga kjo Qeveri, është nënshkruar nga unë si ministre, ka marrë mbështetjen e plotë dhe të fuqishme në Kabinetin e Republikës së Kosovës dhe natyrisht i ka shërbyer qëllimit të saj dhe qëllimi i masës së reciprocitetit me Serbinë ka qenë njohja e ndërsjellë e vulave doganore, gjë që është arritur.

Si e dyta, u tha që kam bërë shkelje ligjore të ndryshme. U ftua edhe Prokuroria, e u bënë edhe disa akuza të tjera, se unë edhe kam përfitime, e kështu me radhë. Unë gjithsesi që i inkurajoj gjithë ata që kanë fakte e argumente, që me të vërtetë, përveç shfrytëzimit të kësaj foltoreje për t'i prezantuar këto akuza ndaj meje, të shkojnë edhe në Prokurori. Është shumë e dobishme që edhe Prokuroria ex officio të ndërmarrë iniciativë, por edhe të tjerët që posedojnë fakte për keqpërdorime. Se me të vërtetë, nëse ka, është mirë që ekzistojnë sanksionet ligjore.

Sa i përket vendimit, e përmenda edhe më herët që dy palë, përkatësisht dy kompani e kanë paditur Ministrinë që e drejtoj unë në Gjykatën Supreme dhe vendimi është negativ, dhe daton më 9 korrik, meqë Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur fakte të mjaftueshme se i janë shkaktuar dëme të parikuperueshme kompanisë prodhuese në Fushë-Krujë dhe kompanisë importuese në Kosovë.

Së treti, shumë fjalë e shumë shtiza u gjuajtën drejt “Sharrcemit”, që në të vërtetë, në asnjë mënyrë, nuk e kam qëllimin t'i shërbej avokat, por më duhet ta sqaroj një gjë.

U tha se faktet e mia, përkatësisht të Ministrisë dhe të “Sharrcemit” janë të njëjta. Po, për një arsye të vetme, që burimin e kemi, Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore. Për arsye se informacionet, të cilat Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i ka

prezantuar burojnë nga Doganat e Kosovës. Unë e thashë këtë në hyrje. Për arsye se ka pasur tentime të vazhdueshme të kontaktohet me prodhuesit në Fushë-Krujë dhe ka pasur në njëfarë forme refuzim nga ata deri në momentin e marrjes së vendimit.

Dhe, gjithashtu, u tha se kemi të bëjmë me një shkelës të ligjit dhe me një evazion të madh dhe shkelës të buxhetit.

Unë e përmenda se Buxheti i Kosovës ka përfituar nga kjo kompani 48 milionë euro, ndërkaq 5 milionë është vlera totale e të gjithë importuesve që janë paraqitur te ne. Ne e kemi pasur fazën e konsultimeve publike, tani është në përmbyllje, e kam prezantuar edhe dokumentacionin, por edhe informacionet për punëtorët. Gjithsesi nga kjo foltore i inkurajoj të gjitha kompanitë që formalisht t'i regjistrojnë punëtorët e tyre, të paguajnë tatime për ta, por natyrisht t'i kryejnë edhe obligimet ndaj shtetit, sepse ne do të veprojmë me shifra dhe me statistikë që na ofrojnë Doganat e Kosovës.

U tha pse nuk i kam mbrojtur, ose pse nuk kam reaguar në produkte bujqësore. Në fjalim, gjithashtu, e përmenda që vitin e kaluar është bërë heqja e çmimit referent në Shqipëri, sepse ka qenë një ngritje në Doganat e Shqipërisë për litër të qumështit të freskët që ka shkuar prej Kosovës në Shqipëri. Jemi takuar me autoritetet e Shqipërisë, nga niveli i kryeministrit dhe ministri i Financave, dhe kjo është hequr. Verën e kaluar, nëse e mbani në mend, mund t'i pyetni prodhuesit e qumështit, nuk ka pasur krizë apo mbetje të qumështit në Kosovë për shkak se është eksportuar në Shqipëri pa problem.

Kemi reaguar njëkohësisht për patatet. Por, një fakt u prezantua, e kam thënë në media, por më duhet ta them edhe nga kjo foltore.

Zëvendësministri i Financave i Republikës së Shqipërisë dhe drejtori i Doganave të Republikës së Shqipërisë, në dhjetor të vitit të kaluar, kanë ardhur dhe më janë lutur që politikisht të mos bëjmë zhurmë për shkak se do të ketë ngritje të çmimit referent për patatet dhe arsyetimi i tyre ka qenë se kjo do të zgjasë vetëm një muaj. U kemi thënë se nuk mund ta marrim një vendim të tillë pa biseduar me fermerët e Kosovës. Është thënë se çmimi i ngritur në kufij do të jetë vetëm 4 centë për patatën e Kosovës, d.m.th. nga 14 në 18 centë.

Kemi biseduar me fermerët, kanë thënë në rregull është, për 4 centë nuk do të bëjmë zhurmë. Nuk ka kaluar shumë kohë dhe çmimi është ngritur në 24 centë dhe çmimi referent ka mbetur në fuqi për 4 muaj. Po them edhe një herë, kjo është bërë me dëshirën për dialogim dhe për bashkëpunim ndërqeveritar dhe ndërinstitucional me Shqipërinë.

U tha, pse s'po mbrohen verërat? Në takim me Shoqatën e Vreshtarëve dhe të Prodhuesve të Verës, 2-3 javë më herët, bashkë me ministrin Stavileci kemi ofruar po të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju lutem, vazhdojani fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Edhe kjo mund të verifikohet lehtë. Kemi thënë se ekziston një masë mbrojtëse që mund të aplikohet edhe për prodhimin e verës. Cila është arsyeja e vetme? Për arsye se prodhuesit e verës në Kosovë së bashku bëjnë 50% të tregut dhe këta janë hapat fillestarë për inicimin e masës mbrojtëse. Një prodhues duhet ta arrijë prodhimin deri në 25%, apo një grup prodhuesish deri në 50%.

Përgjigjja e Shoqatës së Vreshtarëve dhe Prodhuesve të Verës ka qenë se nuk na mjafton për arsye se ne synojmë tregun e Bashkimit Evropian, i cili ka kuotë për verën. Italia dhe Franca janë shtete që mbajnë kuotë për verën. Prandaj, edhe kjo është provuar dhe gjithashtu, mu për shkak të informalitetit në bujqësi, kemi problem në marrjen e statistikave të sakta për prodhime bujqësore, në mënyrë që t'i mbrojmë, por në asnjë mënyrë dhe në asnjë instancë nuk mungon vullneti dhe nuk mungon dëshira për të punuar me të gjitha shoqatat e fermerëve për ta vënë masën mbrojtëse edhe për produktet bujqësore.

Për informimin tuaj, Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe 2012, i ka dhënë 40 milionë euro subvencione për sektorin e bujqësisë. Edhe kjo është një informatë që duhet ta dini, se po thuhet shpesh se nuk ka subvencione. Ka subvencione dhe do të punohet.

Dhe, së fundi, duke ju falënderuar të gjithëve për komentet dhe për konstruktivitetin gjatë këtij debati, më duhet të them se ky vendim do të ndryshohet. E kam thënë publikisht se ky vendim do të ndryshohet dhe ideja që është duke u shqyrtuar, ky vendim, brenda pak ditësh të ndryshohet në këtë formë.

(Reagim nga salla)

Unë po ju tregoj faktet të cilat janë duke u realizuar. Konsultimi i fundit ka mbetur me Republikën e Shqipërisë. Të shihet se a do të vendosë Republika e Shqipërisë masë mbrojtëse në Itali, apo jo.

Dhe, në varësi nga ky konsultim, do të vendoset masa në kuotim, përkatësisht në sasi, e cila nuk do të ketë doganë, natyrisht siç nuk ka pasur deri më tani, dhe në pjesën tjetër, e cila mund të ketë tarifë.

Ju falënderoj shumë për kontributin dhe konstruktivitetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Radha është e propozuesit të interpelancës. I keni pesë minuta.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

Tash po filloj nga një çështje tjetër. Fatkeqësisht! Kështu si funksionon demokracia në Kosovë, kështu merren edhe ligjet, kështu sundohet vendi, kështu mendohet të ecet përpara, kur pozita del jashtë, nuk qëndron në sallë, me të njëjtin qëllim, me të vetmin qëllim që të mos ketë kuorum. Kjo është e jashtëzakonshme, por le të mbetet ndërgjegjshëm e atyre që e udhëheqin vendin. Ata duhet ta ndiejnë veten përgjegjës para këtij populli dhe para këtij vendi dhe në asnjë mënyrë nuk duhet t'i frikohen votës në Parlament. Nëse e kanë frikën e votës, atëherë s'kemi çka flasim për demokraci, s'kemi çka flasim për shtet dhe s'kemi çka flasim për pushtet.

Të nderuar deputetë,
Ju falënderoj për diskutimet shumë konstruktive,
E nderuar ministre,

Asnjë nga ato që thatë ju nuk janë argumente dhe nuk qëndrojnë. Ju plotësisht më keni bindur sot se i qëndroni prapa një klani të organizuar kriminal dhe unë publikisht kërkoj shkarkimin tuaj nga Qeveria, sepse dëshiroj që vendi im dhe populli im të ketë Qeveri të popullit, që u shërben interesave të popullit dhe të vendit. Për këtë arsye.

Deputetë të nderuar,
Ne kemi hequr dorë nga pikat tjera të mocionit dhe Parlamentit i propozojmë votimin e një pike të mocionit, dhe kjo është: Shfuqizimi i vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë lidhur me takën prej 35% ndaj çimentos së importuar. Nuk do të heqim dorë nga votimi i kësaj pike të mocionit dhe do të insistojmë në momentin që të ketë kuorum në këtë Parlament që të votohet. Nëse nuk do të ketë, atëherë do të shkojmë në pushim pa pasur kuorum Parlament.

U përmend çështja se kryeministri e pati një bisedë me mua. Është shumë e vërtetë. Kryeministri më kërkoi që të dalim me një pikë të mocionit për rishikimin e vendimit. Unë nuk munda ta pranoj këtë për arsye se me kohë kishin marrë vendim dhe qëndrim për shfuqizimin e vendimit. Prandaj, njerëzit e ndershëm, ata që mendojnë se duhet t'i shërbejnë popullit dhe vendit, asnjëherë dhe për asnjë moment nuk i ndryshojnë qëndrimet e tyre.

Unë mendoj se ai që i ndryshon mendimet nuk mund t'i shërbejë atdheut të tij. 20 deputetë të Partisë Demokratike më kanë premtuar se do të jetë vota e tyre për shfuqizimin e vendimit. Ata nuk janë në sallë sot. Është çudi shumë e madhe. Më vjen keq që ndodhi kjo kështu, por realiteti është ky. Faleminderit edhe një herë dhe po pres derisa Parlamenti ta ketë kuorumin për ta votuar këtë pikë të mocionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se nuk kemi kuorum. Në sallë janë të pranishëm 56 deputetë.

(Reagime)

I kemi edhe disa pika të rendit të ditës...

(Reagime)

Bëjmë pushim dreke, ose po e vazhdojmë. Çfarë të bëjmë?

(Reagime)

Eja mor burrë, eja udhëhiqe ti!

(Reagime)

Unë nuk jam bari i askujt këtu! Në sallë nuk ka deputetë. Nuk është gabimi im hiç. Ne debatua, diskutua. Nesër, në orën 10:00, vazhdon seanca. Faleminderit! Kush do, mund të vijë! Nëse nuk vini, s'do të ketë kuorum. Do të shkojmë në shtëpi.

Vazhdimi i seancës më 13 korrik, në orën 10:15

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E vazhdojmë seancën. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: I nderuari zoti kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Me singëritetin më të madh po e them, me përjashtim të zotit Limaj, se kjo që po ndodh në këtë Kuvend është një papërgjegjësi, është një nonsens, të cilin rrallëkund, ose të mos them askund s'e gjejmë. Nuk e kam të qartë, ose e kemi të qartë që sot deputetët e PDK-së, me ndonjë përjashtim të rrallë, ose janë duke ngarkuar e duke shkarkuar çimento, ose janë kryer pazare tjera. Ajo që vërtet na shqetëson është se deputetët e pozitës e bojkotojnë, e sabotojnë këtë Kuvend, i sabotojnë qytetarët, votat e të cilëve i kanë për të qenë Kuvend, e ju fare mirë e dini se në kohën kur këtu votohej, në fillim të vitit të kaluar, për presidentin, kemi pasur edhe akuza se si nuk është demokratike. Kushtetuta e ndalon lëshimin e seancës. Unë e kuptoj të drejtën e deputetëve për të mos marrë pjesë, por të organizohet sabotim dhe bojkotim i tillë i punës së Kuvendit për çështje të rëndësishme, këtë e bën vetëm një garniturë, një grup i deputetëve, të cilët edhe Zoti e di se si kanë ardhur në Kuvend. Me vota të popullit, ishalla siç thuhet, por po shihet kjo papërgjegjësi.

Prandaj, zoti kryetar, ne si Grup Parlamentar i LDK-së, edhe herët e kaluara jemi munduar dhe vazhdimisht kemi bërë përpjekje të jemi konstruktivë për çështje të interesit të vendit, edhe pse tash po ka interpretime, sikur ne s'po i mbrojmë interesat e vendit, por interesat partiake. Do ta shohin ata të cilët e thonë këtë se kush nuk i mbron interesat e vendit. Janë ata që nuk janë në Kuvend, e jo ata që janë në Kuvend. Dhe, po ashtu, ne nuk do t'ua bëjmë më kuorumin, edhe nëse veç janë 20 a 30% të deputetëve të PDK-së, të koalicionit qeverisës. Këtu shihet që janë disa deputetë të koalicionit qeverisës, por për Lidhjen Demokratike të Kosovës në asnjë rrethanë më nuk do të jemi ata të cilët do t'ua bëjmë kuorumin, për arsyen e thjeshtë, sepse ky Kuvend nuk meriton të menaxhohet, jo me fajin tuaj, nga Qeveria e Kosovës, sepse

realisht po ka përpjekje, punën tuaj si kryetar i Parlamentit, punën tonë, të na e nëpërkëmbin këta njerëz të papërgjegjshëm.

Prandaj, për Lidhjen Demokratike të Kosovës, sigurisht për Grupin tonë Parlamentar, sot nuk mund të ketë seancë. Duhet të vihet këtu dhe të votohet për atë që është kërkuar dhe, ose të votojnë për ta mbajtur 35% e tarifës. PDK-ja, nëse e ka guximin, ta arsyetojë para qytetarëve, por jo në këtë mënyrë. Dhe, unë lus edhe mjetet e informimit, sepse edhe informimi i djeshëm ka qenë jokorrekt në disa mjete të informimit. Është thënë “nuk ka pasur kuorum”. Duhet thënë të qartë “PDK-ja e ka sabotuar, Grupi Parlamentar i tyre e ka lëshuar seancën”, e jo të thuhet kështu. Duhet ta keni guximin ta thoni këtë. Mos keni frikë prej tyre, se këta janë sot, nesër mund të mos jenë në pushtet. Duhet ta thoni troç se PDK-ja është ajo që e saboton Kuvendin, e jo të tjerët, sepse kështu ka ndodhur dhe.

Andaj, zoti kryetar, sigurisht ju jeni kompetent që do ta përmbyllni këtë seancë, por unë e bëra deklarinë në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe uroj që ata sa më shumë të zbrazin e të ngarkojnë çimento dhe t'i kryejnë punët e veta të ndyra, që disa po i bëjnë. Faleminderit!

KRYETARI: Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Kjo që po ndodh sot, si vazhdimësi e asaj që ndodhi dhe, edhe një herë po e dëshmon atë që e kemi paralajmëruar tani sa kohë se ka tendencë tepër të qartë që këtij Kuvendi t'i ulët vlera para qytetarëve të Kosovës, para opinionit publik dhe kjo përfundimisht shkon në kundërshtim me atë që do të duhej ta ndërtonim ne së bashku, sistemin demokratik dhe vlerën ose përgjegjësinë e institucioneve të veçanta për secilin veç e veç.

Ne nuk e kemi vetëm një gjë të qartë, që duhet t'u thuhet qytetarëve të Kosovës. Kujt dhe kush po frikësohet prej votimit në Kuvend? Pse njerëzit e partisë qendrore ose të partisë kryesore në Kosovë e lëshojnë sallën e Kuvendit për të mos mundësuar votimin për një çështje, që deri më tash nuk ka qenë tepër e madhe, por tash po shihet se definitivisht ka interesa të përbashkëta prej shumë anëve.

Ajo që është e dhimbshme për qytetarët e Kosovës është se koalicioni qeverisës e prish kuorumin dhe këto raste ndodhin tepër rrallë. Ka ndodhur në këtë Kuvend gjatë kësaj periudhe me këtë qeverisje një herë më herët dhe po ndodh përsëri.

Ajo që dua ta them me shaka është se Kuvendi po duket shumë mirë pa PDK-në, por votat e qytetarëve definitivisht besoj se vërtet nuk do t'i lënë më të vijnë në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Ta dini se debat nuk kemi, por në emër të grupeve parlamentare keni të drejtë të flisni. Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pra, kjo që po vazhdon sot, e që nisi dje, është një tregues i qartë, jo vetëm për përgjegjësinë që këta deputetë e mbajnë karshi qytetarëve, tek e fundit, edhe karshi institucioneve ku janë, por është edhe një tregues i qartë i një interesi goxha të thellë në këtë çështje, të cilën e ka ngrehur mocioni dhe interpelanca e djeshme. Për shkak se po shihet që ky grup parlamentar, natyrisht me këto përjashtime që po i shohim në sallë, është një grup parlamentar, i cili ose rrezikon, për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme, që të përçahet këtu në sallë dhe nuk po guxojnë të vijnë, ose e kanë një interes goxha të thellë të Qeverisë, por edhe të vetin personal, që nuk po duan ta votojnë këtë mocion. Nuk po duan ta votojnë as për shkak se kjo do të ishte një fiasko, mendoj unë, publike për ta, por nuk po duan të votojnë as kundër, për shkak se kjo do të ishte një fiasko financiare për ta, kujtoj unë. Dhe, rrjedhimisht, kanë ardhur në këso pozite, kur po duhet ta bojkotojnë Kuvendin, për rendin e ditës të të cilit janë pajtuar të gjithë, edhe në Kryesi, edhe dje. Madje, kemi parë edhe shumë shtesa të pikave të rendit të ditës nga po i njëjti grup parlamentar, të cilat është dashur të diskutohen, e sot e nuk kanë ardhur në sallë për t'i diskutuar. Pra, kjo tregon që interesi që lidhet me këtë çështje, të cilën e kemi diskutuar dje dhe për të cilën është dashur të votojmë sot, është më i madh se çfarëdo interesi për publik që mund ta ketë ky grup parlamentar dhe kjo Qeveri që po thirret se është Qeveri e Kosovës.

Unë nuk mendoj që ka ndonjë rast në botë, ndoshta ka, dhe është në kundërshtim me logjikën parlamentare, që grupi më i madh parlamentar, koalicioni qeverisës, ta bojkotojë seancën. Natyrisht, opozita e bojkoton seancën për ta prishur kuorumin, për shkak se nuk pajtohet për një çështje të caktuar, mirëpo ata që thirren që i kanë numrat, e veçanërisht ky koalicion qeverisës që na ka lodhur që një vit e gjysmë duke na thënë se i kanë numrat, tash nuk po e ka guximin të vijë t'i përdorë ata numra në Kuvend.

Rrjedhimisht, unë mendoj që kjo është një fiasko politike e këtij grupi, për aq sa këta kanë qenë grup politik, edhe pse unë nuk mendoj se kanë qenë ndonjëherë grup politik.

Prandaj, edhe ne pajtohemi me atë që e propozoi Lidhja Demokratike e Kosovës, që në këto kushte nuk mund të ketë vazhdim të seancës, mirëpo po e them edhe një gjë: Ne jemi absolutisht kundër vazhdimit të çfarëdo seance pa u votuar së pari ky mocion.

Pas votimit të mocionit, seancën mund ta vazhdojmë me pika tjera. Mirëpo, pa u votuar ky mocion nuk ka vazhdim të seancës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Flas si deputet i Parlamentit,

Unë mendoj që ato fjalë që i keni ndërmend t'i thoni për grupet parlamentare të pozitës është mirë t'i ruani kur të jenë ata këtu, do ta keni rastin t'i thoni. Ky është një

shembull për të treguar e për t'u thënë edhe juve që të mos ndiheni shumë mirë dhe krenarë si deputetë të opozitës. Kjo është gjendja e Parlamentit të Kosovës. Ky është rezultat edhe juaji. Jo sot, por që një vit e gjysmë, Parlamenti i Kosovës është në këtë gjendje. Është turp! Secili prej nesh duhet të turpërohet që kemi qenë deputetë të këtij Parlamenti që një vit e gjysmë. Kjo është gjëja më e vogël që ka ndodhur sot, çfarë ka ndodhur për një vit e gjysmë në këtë vend, çfarë ka kaluar nëpër këto dyer.

Ju sot flitni për mocionin. Për cilin mocion jeni duke bërë llafë? Një mocion që e ka ngrehur deputeti i pozitës. Zoti Emin Gërbeshi e ka ngrehur mocionin. Ku jeni ju opozita? Në vend që të dalë nga ju, ka dalë nga deputeti i pozitës. Kështu që nuk keni shumë mundësi dhe hapësirë për ta kritikuar dikë tjetër. Secili le ta luajë rolin e vet ashtu si duhet.

Unë jam i shqetësuar për gjendjen në institucionet e këtij vendi. Pavarësisht, pozitë a opozitë, pavarësisht cili grup është i madh e i vogël, mua po më shqetëson gjendja në cilin është vendi ynë, institucionet tona. Institucionet e këtij vendi jemi duke i devalvuar në tërësi. Shumë më fuqi, kridibilitet e dinjitet kanë pasur institucionet e Kosovës më 1999, me zotin Kushner, se sa sot në Kosovën e pavarur, në vitin 2012. Kështu që ideja që ne jemi, ju, mediet, ne jemi më mirë, këta janë më keq... Besoni këtu nuk ka kush të lëvdohet, as ta ngrejë kokën përpjetë, por gati të gjithë këtu jemi të turpëruar që një vit e gjysmë, e duhet ta shohim këtë ne që jemi deputetë të këtij Kuvendi. Dhe, as 0,1% nuk e kemi realizuar mandatin që na e kanë dhënë qytetarët e Kosovës. Kështu që nuk besoj që kemi punuar për ta pasur kokën lart. Kjo është veç një pjesë e atij filmi që është zhvilluar për një vit e gjysmë në këtë vend.

KRYETARI: Jo nuk është nevoja për replikë. Në emër të Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar i Kuvendit, faleminderit që po na e jep fjalën dhe që megjithatë që po e mban këtë debat, sepse është mirë që po e bëjmë këtë debat.

Unë për vete nuk po ndihem mirë që PDK-ja nuk është këtu dhe mendoj që Parlamenti nuk po duket mirë pa PDK-në, sepse besoj që në PDK ka forca që duhet ta vlerësojnë se kjo është shumë keq. Prandaj, kjo është nën nivelin e çfarëdo lufte parlamentare e politike, sepse çdo gjë e ka një kufi dhe mendoj se ne po rrezikojmë t'i tejkalojmë disa kufij, pas të cilëve me të vërtetë autoriteti në institucionet tona do të bjerë në rrezik.

Unë apeloj te PDK-ja dhe te të gjithë të tjerët që ne të kthjellemi, ta shohim çfarë roli kem si deputetë, ta mbrojmë autoritetin e Kuvendit dhe të bëjmë gjithçka.

Unë, në mbledhjen e parë të grupit parlamentar do ta shtroj çështjen se çka po ndodh me ne kështu dhe nëse nuk përmirësohen gjërat, kështu më nuk mund të shkojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo që po shihemi në këtë formë sot, është me të vërtetë përfundim i shenjave të mëhershme, por tash po bëhet fakt.

Kjo që ka ndodhur me tërheqjen e mazhorancës nga Kuvendi është një gjë e paprecedentë në gjithë historinë çfarë unë njoh në parlamentarizëm. Bajagi njoh, por nuk më ka rënë të shoh që një mazhorancë tërhiqet nga Parlamenti.

Tash nuk është puna ta atakojmë as mazhorancën, as të fluturojë opozita, sepse Fatmir Limaj, pak a shumë, me një revoltë të arsyeshme, e ktheu disi të folurit të opozita. S'ka kush të krekoset, sepse nëse ka rezultate, të gjithë mund t'i kenë flatrat e lëshuara, nëse s'ka kurrkush s'mund të krekoset dhe kjo logjikë përfundon për mua.

Çështja është që as në këtë Parlament nuk jemi njësoj, sepse është Parlament popullor dhe ju e dini mirë, është votë popullore dhe kandiduese dhe vjen këtu, po e them, pa të keq, pa cilësim të kualitetit, po karakterizim, edhe bariu, edhe filozofi. Kështu që, realisht, nuk janë të njëjtë, nuk kanë kulturë të njëjtë të së kaluarës, të punës, e tjera. Sepse është parlament popullor. Ndaj, nuk ndiej nevojë të them që ky është më i vlefshëm, ose ai më i vlefshëm, sepse të gjithë njësoj janë përfaqësues.

Problemi është i fenomenit. Dhe, këtë dola ta them, zoti kryetar, sot këtu. Këtu, unë i shoh dy shenja, që janë shumë të rrezikshme për këtë vend. Është njëra, që është tendencë qeveritare për atentat ndaj Parlamentit. Flas me terma politike, dhe këtë, meqë normalisht Qeveria s'mund ta bëjë nëpërmjet opozitës, se s'e synon, e bën nëpërmjet shumicës së vet në Parlament, që i bie se kjo shumicë në Parlament tash vërtet bën vetëvrasje parlamentare.

Që të dyja variantet janë shumë të këqija për një shtet parlamentar, kushdo qoftë ta ketë shumicën ose pakicën. Kjo në të vërtetë e ka një konsekuencë të padëklaruar. Që nga dje, për mua, politikisht, kjo shumicë nuk është shumicë. Sepse, Qeveria ka demonstruar me gjeste, me veprime që nuk e ka shumicën. Dhe, le të dalë, nesër a pasnesër, kur të dojë, është e detyruar ta provojë nëse e ka shumicën parlamentare. Ju lutem shumë! Nëse e ka, le ta provojë. Por, se nuk e ka shumicën e ka demonstruar vetë. Sepse, e tha Limaj - një mocion që e bën vetë shumica, nuk është në gjendje ta çojë deri në fund, qoftë edhe me votë. Domethënë, këtu nuk ekziston shumicë qeveritare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Xhavit Haliti e ka fjalën.

XHAVIT HALITI: Të nderuar kolegë,

Ne dje e zhvilluam debatin, e në fund nuk kishte kuorum, prandaj u detyrova ta mbyll seancën, me qëllim që ta vazhdojmë sot, jo vetëm për atë pikë, por edhe për pikat tjera të rendit të ditës dhe mendoj që kjo ka qenë detyra ime dhe këto kanë qenë

mundësitë e mia për të shkuar më tutje. Nuk e kam bërë personalisht, por kështu e thotë Rregullorja, kështu e thotë ligji.

Unë dola i shqetësuar nga një çështje krejt tjetër, që ndoshta është pak edhe personale, por është edhe e të gjithë neve, sepse segmente të caktuara, individë të caktuar përpiqen që të akuzojnë për ngjarje, të cilat kanë ndodhur në të kaluarën, për veprime të cilat janë bërë në të kaluarën, dhe përmendin emra, e mbi të gjitha i shqetëson pse Xhavit Haliti ka miqësi me Sabri Hamitin ose me Ismet Beqirin, ose me dikë tjetër këtu, ose me opozitën, ose pse e drejton seancën mirë, ose keq.

Për drejtim të seancës keq, ne e kemi një Rregullore dhe mendoj se mund të bëjmë penallti. Mund të bëjmë mocion ndaj drejtuesit të seancës dhe mund ta shkarkojmë edhe nga nënkryetari, ose anëtar i Kryesisë së Kuvendit, e nuk ka diçka të keqe.

Për çështjen tjetër, dua të ju them sot, pasi nuk kam folur kurrë për këto çështje. Ju e dini, ndoshta ka edhe këtu njerëz të tillë që kanë filluar të më akuzojnë menjëherë pas luftës se e kam vrarë Ahmet Krasniqin, se e kam vrarë Ilir Konushevcin, se e kam vrarë Ali Ukën, se e kam vrarë Tahir Zemajn, se e kam vrarë, s'di e s'di kë. Bile, në fund, edhe se unë, ose Azem Sylja, paskemi folur me telefon dhe pasojat e telefonatave tona...

(Ndërhyrje - Reagim)

Mbylle! Është vrarë Mujë Krasniqi.

(Reagime)

Unë jam i shqetësuar që sot...

(Reagime)

Po as ato që u thanë, nuk ishin në rend dite. Dua të ju them se ata që i kanë bërë këto do të dalin, do të gjenden. Por, unë dola me dy qëllime: Një, që asnjëherë, po ju them shqip, kurrë s'do të ma lëkundë kush mendimin tim politik për ish-presidentin Ibrahim Rugova dhe s'do ta prishë miqësinë time me familjen e zotit Ibrahim Rugova. Le të përpiqen si të donë!

Kurrë s'do ta ndalim debatin me Sabri Hamitin dhe kurrë s'do të prishem personalisht me Sabri Hamitin pse debatojmë.

(Ndërhyrje)

Dhe, në të njëjtën kohë, dua që nga foltorja e Parlamentit t'i bëj thirrje Prokurorisë së Shqipërisë që ta hetojë rastin e vrasjeve që kanë ndodhur në Shqipëri të Ahmet Krasniqit, Ilir Konushevcit dhe të Ali Ukës, të cilat janë të ndriçuara nga organet e drejtësisë në Shqipëri, ashtu siç kërkoj që këto çështje të ndriçohen nga Prokuroria e EULEX-it dhe Prokuroria e Kosovës.

Janë çështje për të cilat unë kam të drejtë të flas, sepse jam i akuzuar personalisht dhe mos u shqetësoni, të nderuar, të nderuar akuzues në zyra të ndryshme dhe në mediume të ndryshme, të nderuar që nuk e dini çka po flas dhe po bërtitni kot.

Unë di më shumë, unë di më shumë dhe unë e di pse po flas. Unë nuk kam dalë ta mbrojmë vetveten. Po kërkoj që të marrë masa drejtësia, po kërkoj që të mos e pengojë dikë miqësia ose kafeja që e ndërrojmë me njëri-tjetrin. Po kërkoj që ndaj personit të përmendur, të akuzuar natën e ditën, në gazeta e në oda, në kafene, që vërtet të veprojnë hetuesia, qoftë parlamentare, qoftë e Prokurorisë. Kjo parlamentare është llafe, por le të veprojnë Prokuroria.

Unë dua të ju them se në qoftë se vërtet, vërtet, sikur vetëm në një rast të isha i përzier në këto raste, unë nuk do të rrija këtu asnjë sekondë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Është e vërtetë se institucionet tona shtetërore janë degraduar shumë, mirëpo përgjegjësinë për degradimin e institucioneve më së shumti dhe mbi të gjitha e kanë ata që udhëheqin me institucionet politike të shtetit të Kosovës.

Opozita e ka përgjegjësinë ta ndihmojë prodhimin e ligjeve dhe t'i bëjë institucionet më të mira. T'i përmirësojë ligjet aty ku është e mundshme. Por, atëherë, kur vazhdimisht ka pasur përpjekje nga deputetët e opozitës që ligjet të jenë më të mira, ky proces gjithmonë është sabotuar dhe është bojkotuar nga deputetët me mentalitet partiak, që i kanë degraduar institucionet e Republikës së Kosovës.

Institucionet e Republikës së Kosovës i kanë degraduar ata që e sollën Kodin e turpshëm Penal. Ata që paturpësisht e anuluan reciprocitetin me Serbinë. Ata që shkuan në negociata me Serbinë, pa e pyetur këtë Kuvend. Këta njerëz i kanë degraduar institucionet e Kosovës. Ata që në mënyrë kriminale po e shesin Distribucionin dhe Furnizimin e KEK-ut për 26 milionë euro. Ata që po i shesin pasuritë publike të Kosovës. Këta njerëz po i degradojnë institucionet e Republikës së Kosovës.

Të thuash që të gjithë në këtë vend e kanë të njëjtën përgjegjësi për atë që po ndodh, do të thotë t'i amnistosh ata që kanë marrë vendime të gabuara për këtë vend, e kjo nuk është e ndershme.

Është e vërtetë që në këtë vend përnjëmend askush nuk mund ta mbajë kokën lart. Mirëpo, disa nuk mund ta mbajnë kokën lart për shkak se kanë marrë vendime të turpshme, e disa nuk mund ta mbajnë ende kokën lart për shkak se nuk e kanë ndryshuar situatën. Mirëpo, kjo nuk është e njëjtë.

Kështu që, ne jemi sot këtu në këtë sallë 58 veta - 58 deputetë, ose 57. Ju bëjmë thirrje publike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës: Nëse ka mbetur ende ndonjë deputet i përgjegjshëm përpara popullit dhe përpara votuesve që të na bashkëngjitet, në mënyrë që ta vazhdojmë seancën e rregullt për të cilën jemi pajtuar në mbledhjen e Kryesisë. Pra, na duhen edhe 3-4 deputetë që të vijnë dhe ta votojmë mocionin për shfuqizimin e një vendimi shumë të dëmshëm që e ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës. Për ata që kanë zemër e ndërgjegje, për ata që e dëgjojnë zërin e qytetarëve dhe zërin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, le të vijnë këtu ku është vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju e dini që debati për këtë çështje është kryer dhe. Megjithatë, unë ua dhashë mundësinë të gjitha grupeve parlamentare të deklarohen për këtë moment që është krijuar në Kuvendin e Kosovës dhe ju po e shihni që edhe opozita i ka diku rreth 53 deputetë, e nuk i ka të gjithë këtu.

(Reagim)

Po, shikoni! Megjithatë, nga pozita këtu i kemi 8 deputetë.

(Ndërhyrje)

Ju lutem! Janë pra 9. Ju lutem, unë nuk po e akuzoj askënd. A po merr vesh shqip?!

(Ndërhyrje)

Ju lutem, dua ta mbyll seancën, uluni dhe dëgjoni.

(Ndërhyrje)

Atëherë, në mungesë të kuorumit po e mbylлим seancën, e me këtë edhe këtë sesion, për të vazhduar në shtator. Mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë